

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



Fakulteti i Drejtësisë
Правен факултет
Faculty of Law

Studime postdiplomike- cikli i dytë

Teza:

**“Pengesat martesore sipas legjislacionit familjar të
Republikës së Maqedonisë dhe sipas të drejtës Islame”**

Kandidati:

Feride Sejdiu-Reshidi

Mentor:

Prof.Dr. Emine Zendeli

Tetovë, 2019

Përmbatja:

Hyrja	4
-------------	---

Kapitulli I

1. Martesa si institucion juridik dhe shoqëror.....	7
1.1. Natyra juridike e martesës.....	7
1.2. Përkufizimi i martesës.....	8
1.3. Qëllimet e martesës.....	10
a) Qëllimi i jetesës së përbashkët dhe krijimi i familjes	10
b) Qëllimi i ndihmës bashkëshortore	11
c) Qëllimi shoqëror.....	11
2. Martesa sipas të drejtës islame	12
2.1. Rëndësia e martesës	13

Kapitulli II

1. Kushtet për lidhjen e martesës sipas legjislacionit familjar të Republikës së Maqedonisë..	15
1.1 Kushtet materiale për lidhjen e marrtesës	15
a) Gjinia.....	16
b) Deklarimi i vullnetit të lirë të bashkëshortëve përpara organit kompetent.....	18
c) Forma e lidhjes së martesës	20
2. Kushtet martesore sipas të drejtës Islame	22
a) Pëlqimi i ndërsjelltë mes dy bashkëshortëve	22
b) Velu	24
c) Dëshmitarët	24
d) Mehri.....	25

Kapitulli III

1. Pengesat martesore sipas legjislacionit familjar të Republikës së Maqedonisë	26
1.1 Historiku i pengesave martesore	26
1.2 Kuptimi dhe llojet e pengesave martesore	28
a) Pengesat martesore të evitueshme dhe të paevitueshme	29
b) Pengesat martesore të përhershme dhe të përkohshme	29
c) Pengesat martesore absolute dhe relative.....	29
1.3 Klasifikimi i pengesave martesore sipas legjislacionit familjar të Republikës së Maqedonisë	30
1. Mituria	30
2. Martesa ekzistuese	33

3. Sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar	34
4. Gjinia	37
a) Gjinia e gjakut	38
b) Gjinia e krushqisë.....	40
c) Gjinia e adoptimit.....	41
5. Mungesa e vullnetit	42
a) Dhuna.....	43
b) Kanosja.....	46
c) Lajthimi.....	47
a) Lajthimi për personin fizik.....	47
b) Lajthimi për personin qytetar	48
c) Lajthimi për cilësitë thelbësore të personit	49
d) Mashtrimi.....	51
2. Pengesat martesore sipas të drejtës Islame	52
2.1 Llojet e pengesave martesore.....	53
a) Pengesat martesore të përhershme	53
1) Pengesat martesore në lidhje gjaku.....	54
2) Pengesat martesore në lidhje krushqie	55
3) Pengesat martesore në lidhje nga qumështi	57
b) Pengesat martesore të përkohshme	58
1) Gratë e ndaluara përkohësisht për martesë	59
2) Martesat tjera të ndaluara	61
a) Martesa mut'ah	61
b) Martesa tahlil.....	62
c) Martesa shigar	62
d) Martesa me qëllim shkurorëzimi	63

e) Martesa me jomuslimane.....	63
--------------------------------	----

Kapitulli IV

1. Anulimi i martesës	65
1.1 Anulimi absolut i martesës.....	67
a) Martesa ekzistuese.....	68
b) Sëmundjet psikike dhe paaftësia për të vepruar	69
c) Dallimi i sekseve	70
d) Gjinia.....	71
e) Lidhja e martesës para moshës 16 vjeçe.....	72
f) Mos-respektimi i procedurës për lidhjen e martesës	72
g) Shmangia nga qëllimi i martesës.....	73
1.2 Anulimi relative i martesës	74
a) Mungesa e vullnetit për të lidhur martesa	74
b) Lidhja e martesës nën moshën 18 vjet	75
1.3 Pasojat e anulimit të martesës	76
1.4 Porcedura për anulimin e martesës	77
2. Anulimi i martesës në të drejtën islame	79
3. Kuptimi i anulimit në të drejtën islame	79
4. Shkaqet dhe llojet e anulimit në të drejtën islame.....	80
Përfundimi.....	86
Bibliografia	94

Hyrje

Kur flitet për martesë, të gjithë e dimë që martesa përbën një ngjarje shumë të rëndësishme në jetën e njeriut në aspektin social dhe atë juridik. Vendorsja e individit në qendër të shoqërisë duke i dhënë një rëndësi të madhe nevojave e dëshirave të tij ka përcaktuar në njëfarë mënyre edhe përcaktimin në tërësi për martesën, ku individ i zgjedh vetë personin me të cilin do të martohet. Martesa është një institucion i vjetër dhe shumë i rëndësishëm, që paraqitet si bazë për familjen, ndërsa familja është celulë themelore e shoqërisë. Duke pasur parasysh se martesa është institucion shumë i rëndësishëm shoqëror, shteti, shoqëria, por edhe religjioni ka përcaktuar kushtet për lidhjen e saj, si dhe pengesat martesore, të cilat nuk duhet të egzistojnë në mënyrë që martesa të jetë e vlefshme dhe e plotëfuqishme.

Në këtë punim shkencor do të hulumtohen pengesat martesore sipas legjislacionit familjar të Republikës së Maqedonisë dhe sipas të drejtës Islame. Pengesat martesore zanafillën e kanë që nga ekzistenca e martesës, kjo pasiqë janë fakte dhe rrethana, ekzistenca e të cilave pengon lidhjen e martesës së vlefshme. Me kalimin e kohës rrethi i pengesave martesore është ngushtuar dhe disa kanë ndryshuar, ashtu siç ka ndryshuar martesa. Mirëpo, cila është rrjedha, si kanë ndodhur këto ndryshime? Cili është botëkuptimi i shoqërisë sonë mbi pengesat martesore, a duhet të rritet apo zvogëlohet numri i pengesave martesore? Cilat pengesa martesore i praktikon shoqëria jonë, ato të parashikuara me ligj, apo ato të parashikuara me Kur'an?

Martesa është një bashkësi jetësore mes një burri dhe një gruaje, në të cilës realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Për lidhjen e një martese të tillë duhet të plotësohen kushte të caktuara, prandaj do të flitet për kushtet për lidhjen e martesës që përcakton legjislacioni ynë dhe për ato që përcakton e drejta Islame, dallimi mes kushteve, edhe pse ato janë mjaft identike mes dy legjislacioneve, përsëri ekzistojnë disa dallime. Do të trajtohen pengesat martesore, si i përkufizon legjislacioni i Republikës së Maqedonisë dhe si e drejta Islame, kuptimi i tyre, klasifikimi i tyre, ndarjet dhe nëndarjet e tyre, cila e drejtë ka numër më të madh të pengesave? Disa klasifikime të pengesave martesore janë mjaft identike, ndërsa disa aspak nuk ekzistojnë në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë. E drejta Islame

parasheh disa ndalesa të përkohshme, që ndalojnë lidhjen e martesës me gratë kurorëshkelëse, idhujtare dhe kufizimi i lidhjes së martesës sipas gjinisë të qumështit, mirëpo pse këto pengesat nuk i parasheh legjislacioni ynë? A është i mjaftueshëm numri i pengesave martesore të parapara në legjislacionin tonë, apo duhet plotësuar? Vërtetimi i ekzistencës së pengesave martesore dhe mos plotësimi i kushteve për lidhjen e martesës, janë shkaqe për anulimin e martesës, rregull që e parasheh legjislacioni ynë dhe legjislacioni Islam. Cilat pengesa martesore shkaktojnë pavlefshmërinë absolute dhe relative të martesës? A mund të riparohen ato? Cilët janë palët e ligjësuar që kundërshtojnë lidhjen e martesës dhe për cilat arsye mund të kundërshtohet? Kush ka të drejtë në padi dhe pse?

Qëllim ynë gjatë këtij hulumtimi është që të nxjerrim në pah qëndrimin e legjislacionit familjare të Republikës së Maqedonisë dhe të drejtës Islame rreth çështjes së martesës, pengesave martesore dhe anulimit të saj, pasi shoqëria jonë, posaçërisht personat me përkatësi fetare islame, mundohen që të zbatojnë ligjin e shtetit ku jetojnë dhe fesë që besojnë pra Islamit. Pasi personat me përkatësi fetare Islame lidhin martesë sipas formës së paraparë me ligj dhe sipas formës së paraparë në të drejtën Islame, të dyja së bashku, ku për secilën martesë duhet ti plotësojnë kushtet e parapara të secilës formë të martesës, dhe duhet ti shmangen pengesave martesore të secilit legjislacion. Si e zbaton shoqëria ynë këtë gërshetim, me lehtësi apo vështirësi?

Duke analizuar të gjitha këto do të arrijmë në konkludim se kategoria e njerëzve që martesën e kanë si, qëllimin themelor jetësor, është kategoria e njerëzve më të arsyeshëm dhe që suksesi në jetën martesore është më i pritshmi. Martesat e tilla, planifikohen mirë, dyanshëm, si nga burri ashtu edhe nga gruaja. Ata, jetën martesore e ndërtojnë në dashuri të ndërsjellë, në besim të plotë mesvete. Përpos harmonisë të të martuarëve, këta ndërtojnë në vazhdimësi marrëdhënie e respekt edhe me rrethin e ngushtë e të gjerë familjar. Lindjen e trashëgimtarëve e presin me gëzim e dashuri. Gjasat për suksesin e plotë në jetën martesore te kjo kategori e njerëzve janë më të mëdha, sepse ata martesën e kuptojnë si vlerë të veçantë dhe si qëllim themelor jetësor.

Shpresoj se ky punim hulumtues në të ardhmen do ti shërbejë shoqërisë, studentëve dhe gjitha institucioneve rreth çështjes së pengesave martesore, pasi shoqëria jonë mjaft pak është e informuar rreth kësaj çështje, posaçërisht banuesit e vendeve rurale, ku ende zbatojnë zakonet e vjetra, lidhin martesa mes të miturve, pa vullnetin e tyre dhe me plot lajthime, ndërsa institucionet nuk janë aspak të informuara dhe nuk kanë parandaluar mjaftueshëm. Nëpërmjet këtij punimi dua, të vetëdijësohet shoqëria jonë për të drejtat e tyre, institucionet të jenë më efikas, më korrekte dhe më informative rreth këtij fenomeni, pasi pengesat martesore janë prezente çdo ditë e më shumë.

KAPITULLI I

1. Martesa si institucion juridik dhe shoqëror

Martesa është ndër institucionet më të lashta dhe gjithësesi më të rëndësishme shoqëror dhe juridik.¹ Martesa, si një bashkësi ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje.² Ajo është një bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë.³ Sipas të drejtës tonë familjare martesa është bashkim vullnetar, i përjetshëm, midis një burri dhe një gruaje ku promovohet monogamia si një parim me vlerë themelore për të drejtën tonë familjare dhe martesore, respektimi i të cilit është i detyrueshëm.⁴

1.1 Natyra juridike e martesës

Në teorinë juridike familjare dhe në legjislacionin familjar bashkëkohor koncepti për natyrën juridike të martesës ka evoluar mjaft shumë, kështu që më shumë fakte shkojnë në favor të konceptit se martesa është një institucion juridik. Lidhja e martesës para organit kompetent shtetëror, me deklarimin e vullnetit të lirë dhe pëlqim të ndërsjellë të bashkëshortëve të ardhshëm, përjashton çdo mundësi për ta cilësuar martesën si kontratë civile, aq më tepër që shteti e vë nën përkujdesje shoqërore dhe mbrojtje shtetërore, si një institucion i rëndësishëm juridik dhe shoqëror. Kryesisht, dallimet e përkufizimit të martesës janë të natyrës konceptuale. Kështu, përfaqësuesit e konceptit se martesa është një kontratë juridike civile, martesën e cilësojnë si jetesë të përbashkët të një burri dhe një gruaje me qëllim që t'i ndihmojnë njëri-tjetrit. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e konceptit se martesa është një institucion juridik, martesën e cilësojnë si jetesë të përbashkët të një burri dhe një gruaje, të sanksionuar me ligj dhe që s'mund të zgjidhet vetë. Në literaturën juridike ka edhe mendime të tjera për natyrën juridike të martesës. Natyra juridike e martesës është mixte: ajo është një

¹ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 67

² Mandro-Balili Arta ; E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 78

³ Neni 6, Ligji për familje, (Gazeta zyrtare e RM'së), 2016

⁴ Mandro-Balili Arta ; E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 83

mirëkuptim dhe një dëshirë, pa të cilat nuk mund të ekzistojë, sepse që nga momenti i lidhjes së martesës bashkëshortët i nënshtrohen një statusi legal imperativ.⁵

1.2 Përkufizimi i martesës

Martesa është një institucion i lindur dhe zhvilluar në formacione të ndryshme shoqërore ekonomike. Ndryshimet në shkallën e zhvillimit ekonomik dhe kalimi nga një formacion shoqëror në tjetrin janë reflektuar edhe në pikëpamjet dhe botëkuptimet për martesën. Këto kanë rezultuar edhe në përkufizime të ndryshme të martesës në teorinë e së drejtës familjare.⁶ Si një ndër përkufizimet më të vjetëra përmendet ai i Modestinit sipas të cilit “Martesa është një lidhje e një burri dhe një gruaje, bashkim për gjithë jetën dhe bashkësi e së drejtës hyjnore dhe njerëzore” (*Nuptiae sunt coniunctio maris et feminea consortium omnis vitae, divini et humani iuris comunicati*). Është një shprehje që transmeton gjithë esencën dhe dimensionin e institutit, ku plekset hyjnorja dhe njerëzorja në përjetësi, midis dy personave me sekse të ndryshme.⁷ Martesa dhe lidhja e saj është e “shenjtë” për të gjithë, jo vetëm në ditët e sotme, por që nga koha e antikës, mesjetës, kapitalizmit, para dhe pas luftërave botërore dhe deri në ditët e sotme.⁸

Martesa nënkupton një bashkim të lirë dhe vullnetar. Lidhja në martesë bëhet me vullnetin e lirë të palëve. Ajo nënkupton që palët kanë zotësi të plotë për të vepruar dhe janë të lira që të shprehin vullnetin e tyre pro bashkimit në martesë. Martesa është një e drejtë dhe jo një detyrë. Si e tillë martesa realizohet vetëm kur vullneti i individit është lirisht i ndërgjegjshëm në realizimin e kësaj të drejte.⁹ Martesa si bashkësi morale, shpirtërore e materiale që lidhet me pëlqimin e lirë të bashkëshortëve, mbështetet në barazinë morale bashkëshortore, mbështetet në barazinë juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë , respektit dhe mirëkuptimit reciprok të bashkëshortëve.¹⁰

⁵ Mandro-Balili Arta ; E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq.68

⁶ Aliu Abdulla & Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 85

⁷ Mandro-Balili Arta ; E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 79

⁸ Haliti Burim, Hyseni Flamur , Natyra juridike e lidhjes së martesës, pro et contra lidhjes së martesës mes sekseve të njëjta, publikim, Prishtinë, 2012

⁹ Mandro-Balili Arta ; E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 86

¹⁰ Po aty, fq. 87

Në Digestet e Justinianit jepej ky përkufizim (*Matrimonium est viri et mulieris coniunctio individuum consuetudinem vitae continens*) “Martesa është lidhja ndërmjet një burri dhe një gruaje që përmban një jetesë të përbashkët të pazgjidhshme”. Sipas ligjit për familje të RM’së: Martesa është bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve themelohen në bazë të vendimit të lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesën, në bazë të barazisë së tyre, respektit reciprok dhe ndihmës së ndërsjelltë.¹¹ Në Kanunin e Lekë Dukagjinit¹² nënkuptojmë se femra konsiderohet një lloj robëreshe, e cila nuk ka të drejtë të vendosë për shumë çështje që kanë të bëjnë me jetën personale të saj. Fati i vajzës sipas Kanunit është edhe më e vështirë, ngase asaj i merret çdo e drejtë për martesën e saj, pa marrë parasysh se, a i ka apo nuk i ka prindërit të gjallë. Fati i saj nuk bie në dorën e saj por në dorën e vëllezërve dhe kushërinjve të saj, etj. Ku sipas Ligjit të maleve shqiptare vajzat i vajtonin pasi ato të mjerat shiteshin si kafshë që në djep nga prindërit e tyre¹³ dhe me një dorë para ajo bëhet pronë e familjes që e ka blerë, dhe kështu edhe po ti vdesë burri ajo nuk mund të rimartohet dhe as të rikthehet në shtëpinë e prindërve të saj pa e lëshuar njerëzit e familjes së burrit të vdekur, përndryshe do të shkaktoheshin vrasje e gjakmarrje të tmerrshme.¹⁴ Për të luftuar zakonet e vjetër që lejonte lidhjen e martesës kundër vullnetit të lirë të bashkëshortëve të ardhshëm, në legjislacionin penal u parashikuan si krime dhe dënoheshin prindërit, të afërmit ose kujdestarët që lejonin një të mitur nën 16 vjeç ose e shtynin ose shtrëngonin këtë të fejohej ose të martohej edhe sikur të kishte arritur moshën madhore.¹⁵ Fejesa, martesa si dhe marrëdhëniet familjare të shqiptarët gjerë më vitin 1929, kur hyri në fuqi kodi civil i shtetit shqiptar të Zogut, nuk trajtoheshin me ndonjë kod civil të veçantë, por sipas përkatësive fetare të palëve, traditave të vendit, etj. Klerikët katolikë kanë përdorur format më të ndryshme, sidomos Kanunin, kundër personave të përkatësive fetare katolike që i martonin vajzat e tyre me muslimanë. Me urdhrin e kishës, kush martonte ndonjë vajzë për musliman, lëçitej nga

¹¹ Neni 6, Ligji për familje, (Gazeta zyrtare e RM së), nr:80\1992

¹² “Me u martue sipas kanunit do me thanë me u ba shpi, me ia shtue shpis një rob ma tepër sa për krah të punëve e sa për t’i shtu fmit.” Neni 28, Gecovi Shtjefën, Kanunit të Lek Dukagjinit, Libri I tretë, Martesa, Shkodër, 1993

¹³ Valentini At Giuseppe (Zef), Ligji i maleve shqiptare, Plejad, 2007, fq. 34

¹⁴ Po aty, fq. 42

¹⁵ Mandro-Balili Arta ; E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq.74

shoqëria dhe nuk i lejohej kujt që as për gezim e as për dëshpërim të hyjë në shtëpinë e tij. Po ashtu, këtyre iu privohej çdo e drejtë në ceremonitë fetare. Dënimi më ekstrem sipas kanunit të tyre, ishte që të largohet nga shtëpia, t'i digjet ajo, t'i priten pemët dhe t'i konfiskohet pasuria.

¹⁶ Megjithatë, format e martesës në trevat shqiptare ndryshonin sipas krahinave, traditave dhe besimeve.

1.3. Qëllimet e martesës

Martesa është një bashkësi specifike, nga përmbajtja e së cilës dalin edhe qëllimet e saj. Siç është theksuar më lartë martesa, është bashkësi jetese e një burri dhe një gruaje me qëllim të jetës së përbashkët dhe krijimit të familjes. Nga kjo rezultojnë edhe qëllimet e martesës. Si qëllime kryesore të martesës janë: a) qëllimi i jetës së përbashkët dhe krijimit të familjes; b) qëllimi i ndihmës bashkëshortore; c) qëllimi shoqëror.¹⁷

a) Qëllimi i jetës së përbashkët të bashkëshortëve dhe krijimit të familjes

Qëllimi i martesës në fakt është plotësimi i nevojave intime për bashkëshortët, por edhe krijimi i familjes, përkatësisht lindja e fëmijëve, që do të varet nga dëshira e bashkëshortëve se a dëshirojnë apo jo të kenë fëmijë. Lindja e fëmijëve mundëson ripërtëritjen e shoqërisë njerëzore. Ndonëse burri dhe graja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime, ata kanë detyrimin reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës.¹⁸ Megjithatë duhet thënë se lindja e fëmijëve nuk është kusht i domosdoshëm i martesës. Bashkëshortët mund të jetojnë në bashkësi martesore pa pasur fëmijë. Por, martesa zakonisht e ka edhe qëllimin e lindjes së fëmijëve. Ky qëllim është realizuar çdoherë në martesa, vetëm në raste të ralla kur për shkaqe të ndonjë sëmundje të pashërueshme bashkëshortët nuk kanë mundur ta realizojnë këtë qëllim. Bashkëshortët vendosin lirshëm për të jetuar bashkërisht dhe me qëllim të krijimit të familjes. Jeta e përbashkët e bashkëshortëve është një komponent themelore e martesës.¹⁹

¹⁶ Valentini At Giuseppe(Zef), Ligji i maleve shqiptare, Plejad, 2007, fq. 30

¹⁷ Aliu Abdulla & Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 87

¹⁸ Mandro-Balili Arta ; E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 91

¹⁹ Aliu Abdulla & Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 88

Martesa me fëmijë të lindur është më e qëndrueshme se ajo pa fëmijë, sepse kohezioni i dashurisë prindërore ndaj fëmijëve e forcon edhe vetë martesën.²⁰

b) Qëllimi i ndihmës bashkëshortore

Në martesë bashkëshortët kanë për detyrë ta ndihmojnë njëri-tjetërin në nevojë, ta mirëkuptojnë e ta mbrojnë, të kujdesen dhe ta shërojnë në raste të sëmundjes, t'i japin përkrahje morale dhe materiale në çaste të vështira. Me këtë kuptojmë detyrën që kanë bashkëshortët për t'i qëndruar besnik njëri-tjetrit, për ta respektuar dhe për të zhvilluar marrëdhënie të hareshme martesore dhe familjare, të bazuara në dashuri të ndërsjelltë.²¹ Kjo ndihmë është e natyrshme në martesë por edhe detyrim ligjor i bashkëshortëve. Në të kundërtën mos dhënia e ndihmës bashkëshortit dhe sjellja inferiore ndërmjet bashkëshortëve ka si pasoj çrregullimin e marrëdhënieve bashkëshortore të cilat janë shkak për zgjedhjen e martesës.²²

c) Qëllimi shoqëror

Qëllimi shoqëror qëndron në faktin se martesa është bazë e familjes dhe familja është bazë e shoqërisë. Martesa përveç që është interes i bashkëshortëve, njëkohësisht është edhe interes i shoqërisë. Në martesë dhe familje zhvillohet shumë procese si; riprodhimi i shoqërisë, edukimi, etj. Prandaj, martesa është vendosur nën përkujdesjen e shoqërisë, sepse në martesë përveç interesave personale të bashkëshortëve realizohen edhe interesat shoqëror. Kështu që martesa është e rregulluar me norma të detyrueshme kushtetuese dhe ligjore. Megjithatë, interesat shoqërore nuk duhet vendosur mbi interesat e bashkëshortëve. Bashkësia martesore duhet të zhvillohet si një bashkësi e lirë dhe pa imponime. Martesa duhet të jetë vetëm nën përkujdesjen e shoqërisë, ngase ngritje e interesave të shoqërisë mbi interesat dhe vullnetin e lirë të bashkëshortëve mund të ketë si pasojë keqpërdorimin e interesit shoqëror në dëm të

²⁰ Aliu Abdulla & Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 88

²¹ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 70

²² Aliu Abdulla & Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 88

interesave të bashkëshortëve. Interesat personale të bashkëshortëve dhe interesat e shoqërisë çdoherë duhet të jenë në harmoni duke e ndihmuar realizimin e qëllimit të martesës.²³

2. Martesa sipas të drejtës Islame

Familja është celulë themelore e shoqërisë në përgjithësi, dhe si e tillë në të drejtën Islame i është kushtuar një vend i rëndësishëm, për këtë arsye edhe në burimin kryesor të së drejtës Islame, Kur'anin, në shumë ajete flitet për rëndësinë e familjes, gruas, fejesës, martesës, trashëgimisë duke marrë parasysh që edhe një kaptinë e tërë mban emrin *Nisa* që do të thotë gratë.²⁴ Gjithashtu edhe në burimin sekondar të së drejtës Islame, hadithin, rregullohen marrëdhëniet familjare, martesën, raportet farefisnore, etj. Juristët Islam në bazë të burimit primar të së drejtës Islame, Kur'anit, si dhe burimit sekondar të së drejtës Islame kanë përpiluar rregullat për institucionin e martesës e cila është bazament i krijimit, zhvillimit, harmonisë, mbijetesës, ruajtjes dhe forcimit të familjes si faktor themelor për ruajtjen dhe zhvillimin e një shoqërie të shëndoshë.²⁵

Martesa është synet i Profetëve. Profeti Muhamed ka thënë: "O ju të rinj! Kush ka mundësi le të martohet, sepse martesa të largon më shumë nga shikimi haram dhe të ruan më tepër nga imoraliteti. Dhe kush nuk ka mundësi, le të agjëroj, sepse agjërimi është mbrojtje për të". Gjithashtu ka thënë: "Femra martohet për katër gjëra: Për pasurinë e saj, për prejardhjen e saj, për bukurinë e saj dhe për fenë e saj, martohu me atë që është fetare, të jesh i lumtur".²⁶ Në periudhën arabe paralislamike haseshin disa lloje të martesës:

- a) *Nikah*: Sipas këtij lloji të martesës, djali e kërkon vajzën nga babai ose tutori i saj, i jep asaj një lloj të dhuratës për martesë (mehr) dhe martohet me të .

²³ Aliu Abdulla & Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 88

²⁴ Sureja Nisa, kjo kaptinë është e mbushur plot me ligje e dispozita të sheriatit, të cilat rregullojnë çështjet e brendshme e të jashtme të jetës së muslimanëve. Si çështje më me rëndësi parashtrihen ato që kanë të bëjnë me gruan, me shtëpinë, me familjen, me shoqërinë e gjërë, por pjesën më të madhe ia kushton dispozitave rreth pozitës së gruas, andaj edhe e merr emri " Suretun Nisai" – Kaptina e grave. Parashtron rregulla mbi të drejtat e grave, e posaçërisht të atyre jetimeve që janë në strehimin e kujdestarëve, mbi dispozitat e trashëgimit, mbi femrat me të cilat nuk mund të lidhet kurorë për shkak të afërsisë së gjakut, gjirit e të miqësisë, mbi marrëdhëniet bashkëshortore, mbi obligimet e burrit ndaj gruas dhe gruas ndaj burrit. E zbritur në Medine pas sures Mumtehine, përmban 176 ajete dhe është kaptina me numër katër.

Nahi, I Hasan, Kur'ani i madhërishtëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe, Tiranë, 2010, fq. 108

²⁵ Miftari Faik, Martesa sipas drejtës Islame, publikim, 2014

²⁶ Es Sadij Abdurrahman b. Nasir, Martesa Islame, publikim, 2017

- b) *Martesa me ndërrim*: Dy persona i ndërronin mes vete vajzat ose femrat që i kishin nën tutorinë e tyre dhe martoheshin pa dhënë dhuratë martesore. (Nikahu'sh-shigar). Islami e ka ndaluar këtë me hadith.
- c) *Martesa me njerken*: Gratë e veja të ngelura pas vdekjes së babait janë martuar pa dhuratë martesore nga djali më i madh ose janë martuar me dikë tjetër nga ana e djalit të madh, ose nuk u është lejuar që të martohen dhe u është marrur trashëgimia që u takonte. (Nikahu'l-Makt). Islami e ka ndaluar edhe këtë lloj të martesës.
- d) *Martesa me dy motra përnjëherë dhe poligamia pa kufi*: Islami të parën e ka ndaluar ndërsa të dytën e ka lidhur për kushte të caktuara.²⁷

Martesa sipas drejtës Islame definohet sipas tri kategorive të përcaktuara:

- a) *Martesa është vaxhib (obligative)* personave që kanë kushte materiale, strehë banimi (shtëpi apo banesë), të ardhura të mjaftueshme financiare për të mbajtur veten, gruan dhe fëmijët, dhe se nuk mund të përmbahen nga amoraliteti, pasi që martesa e mbron nga amoraliteti i mundshëm.
- b) *Martesa është mustehab (e preferuar)* atyre personave që kanë mundësi materiale për të mirëmbajtur gruan dhe fëmijët, dhe se janë të sigurt se mund të përmbahen nga marrëdhëniet jashtëmartesore.
- c) *Martesa është mekruh (jo e pëlqyer)* për të gjithë ata persona të cilët nuk kanë mundësi materiale për të përmbushur nevojat e gruas dhe të familjes, si dhe neglizhojnë detyrimet martesore që lindin me aktin e martesës, por që mund të përmbahen nga amoraliteti.²⁸

2.1. Rëndësia e martesës

Martesa urdhërohet në burimin kryesor të së drejtës Islame, në Kur'an në suren e katërt Nisa (Gratë) në ajetin e tretë : "martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër; e nëse frikësohuni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë

²⁷ Historia e të drejtës islame (Hajreddin Karaman), Ankara, 1975, fq.34, Përktheu: Izeti Metin

²⁸ Miftari Faik, Martesa sipas drejtës Islame, publikim, 2014, fq. 2

mjaftohuni me një grua ”.²⁹ Juristët islam e definojnë martesën si kontratë martesore të arritur në mes burrit dhe gruas me ç’rast fitojnë të drejtën ligjore të jetojnë në marrëdhënie intime. Martesën e ka preferuar dhe udhëzuar edhe pejgamberi Muhamedi në hadithin e tij: ”Kush martohet, i ka të ruajtura dy të tretat e fesë së tij”. Nga kjo mund të konkludojmë se sa e rëndësishme është martesë dhe si i tillë përveç ruajtjes së fesë, ka edhe vlera tjera të shumta, pikësëpari nëpërmjet martesës bëhet reprodukimi i shoqërisë njerëzore, krijohet harmonia familjare, jep kurajo shtesë për të punuar, krijuar më shumë, pasi që nga kjo lindin edhe obligimet shtesë. Martesa si e tillë është mbrojtëse e moralit, shëndetit të familjes dhe shoqërisë në përgjithësi.³⁰

Ajo që është e detyrueshme sipas Islamit, pavarësisht nga lloji i dispozitës së martesës, është fakti se kontrata e martesës mes dy palëve, për të qenë e shëndoshë, e vlefshme është kusht që të mos ekzistojë ndonjë pengesë juridike që pengon lidhjen e kontratës së martesës. Pengesat e martesës sipas jurisprudencës islame mund të jenë të përkohshme të cilat mund të evitohen në momente të caktuara , dhe pas evitimit të lejohet kontrata e martesës mes dy palëve dhe të përhershme që nënkupton se me ekzistimin e këtyre pengesave, apo njëres prej tyre, kontrata e martesës është e ndaluar përgjithmonë mes këtyre dy palëve. Pra pengesat e përhershme janë, gjinia e gjakut, gjinia e krushqisë dhe gjinia e qumështit.³¹

²⁹ Sureja Nisa, Ajeti 3, Nahi I. Hasani, Kur’ani i madhërishtëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe, Tiranë, 2010, fq.77

³⁰ Miftari Faik, Martesa sipas drejtës Islame, publikim, 2014, fq. 1

³¹ Zimeri Jusuf, Martesa me të afërmen-min, nxitje e panevojshme, publikim, 2017, fq. 1

Kapitulli II

1.Kushtet për lidhjen e martesës sipas Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë

Martesa është një institucion i cili themelohet nën kushtet e paraparë me ligj. Jo vetëm në të drejtën tonë pozitive por edhe në shumicën e legjislacioneve për lidhjen e martesës kërkohen të plotësohen kushtet e caktuara me ligj. Legjislacioni pozitiv në RM i ka paraparë kushtet të cilat duhet të plotësohen për lidhjen e martesës së vlefshme. Kushtet të cilat përfshihen në të drejtën pozitive kanë për qëllim respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen adekuate të martesës.³² Kushtet për lidhjen e martesës ndahen:

- a) Kushtet materiale (themelore)
- b) Kushtet formale (procedurale)

1.1 Kushtet materiale për lidhjen e martesës

Kushtet materiale janë fakte dhe rrethana pa plotësimin e të cilave nuk mund të lidhet martesa ose mungesa e tyre shkaktojë pavlefshmërinë e martesës. Pra, kushtet janë të përgjithshme, ndërsa pengesat janë konkrete. Ato lidhen me një person të caktuar në një rast konkret, me një individ konkret, si pasojë e mospërmbyshjes së të parave dhe të ekzistencës së të dytave janë të njëjta, sjellin pavlefshmërinë e martesës.³³ Regjimi i kushteve dhe ndalesave për martesën ka rëndësi të veçantë sepse përmes tyre;

- përcaktohet (pa)vlefshmëria e martesës. Kjo ndodh sepse lidhja e saj është bërë bazë e një akti të vesuar (të mangët) ose jo,
- përcaktohen personat e legjitimuar për të kundërshtuar lidhjen e martesës.
- përcaktohen motivet e kundërshtimit ose të pavlefshmërisë absolute. Këto lidhen ngusht vetëm me kushtet dhe ndalesat për martesa të cilat janë të përcaktuara rigorozisht.³⁴

³² Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 91

³³ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 94

³⁴ Po aty, fq. 92

Sipas Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë, martesë mund të lidhin dy persona, me gjini të kundërt me deklaratë të lirë të vullnetit përpara organit kompetent në mënyrë të caktuar me ligj.³⁵ Përveç kësaj për lidhjen e martesës nuk duhet të ekzistojnë pengesa martesore të parapara me ligj. Së këndejmi si kushte materiale konsiderohen:

- Gjinia e kundërt
- Deklarimi i vullnetit të lirë të bashkëshortëve përpara organit kompetent,
- Forma e lidhjes së martesës.³⁶

a) Gjinia e kundërt

Parimisht martesa është bashkësi e lidhur në mes të dy personave me gjini të kundërt (një burri dhe një gruaje). Martesa është bashkësi jetese e dy personave me gjini të kundërt. Dallimi i gjinive është element natyror që e dallon martesën nga format tjera të organizimit shoqëror. Ky kusht e shpreh edhe parimin e monogamisë së martesës, sipas të cilit martesa është bashkësi e ligjshme vetëm një burri dhe një gruaje. Qëllimi i martesës është jeta e përbashkët e bashkëshortëve dhe lindjen e fëmijëve, që njëherësh është edhe funksion natyror i martesës. Logjikisht është e kuptueshme se ky qëllim arrihet me martesën e dy personave me gjini të kundërt. Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë, por edhe legjislacionet tjera pozitive si formë të vetme e kanë martesën në mes dy personave me gjini të ndryshme.³⁷

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut njeh vetëm martesën e dy personave me seks biologjikisht të kundërta.³⁸ Mirëpo, kohëve të fundit duke u mbështetur në parimin e mos diskriminimit gjinorë (seksual) ka filluar të lejohet edhe lidhja e martesës midis personave të të njëjtit gjini për shembull rasti i Holandës ku parashihet se “martesa mund të lidhet nga dy persona me gjini të ndryshme, ose të të njëjtit gjini”, përveç kësaj, edhe Danimarka, Norvegjia, Suedia, Belgjika, Franca, Gjermania etj,.. kanë ligje për lejimin e martesave me gjini të njëjtë.³⁹

³⁵ Neni 15, Ligji mbi familjen, (Gazeta zyrtare e RM’së), 2016

³⁶ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 72

³⁷ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 93

³⁸ Neni 12, Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut. Asambleja e përgjithshme të kombeve të bashkuara. 1948.

³⁹ Halili Fatmir, Çështjet martesore-sipas shariatit dhe sistemit laik, 2014, publikim

Në teorinë juridike bashkëkohore familjare ka mjaft diskutime për mundësin e lidhjes së martesave të personave me gjini të njëjta (homoseksuale). Në disa vende e kanë lejuar lidhjen, përkatësisht bashkimin e dy personave me gjini të njëjta, si një bashkim, por jo në kuptimin e martesave tradicionale, siç është martesa midis personave me gjini të njëjta. Si argumente për lejimin e bashkimeve të tilla merret e drejta e qytetarëve për të vendosur lirshëm për jetën private përkatësisht bashkimin e tillë. Megjithatë në të drejtën tonë mbrohet vetëm martesa e dy personave me gjini të ndryshme. Martesa midis dy personave me gjini të kundërt e ka kuptimin e martesës. Ndërsa format tjera të bashkimit të personave me gjini të njëjta janë vetëm forma të bashkëjetesës, por jo në kuptimi e martesës. Lejimi i formave të bashkëjetesës së personave me gjini të njëjta më tepër është e lejuar si e drejtë individit për të bashkëjetuar me partnerin që e dëshiron e shikuar si e drejtë private si “bashkëjetesë civile”, por jo në kuptimin e martesës ligjore që ka ekzistuar tradicionalisht. Vetëm martesa e dy personave me gjini të kundërt e realizon qëllimin natyror të martesës për lindjen e fëmijëve dhe krijimin e familjes. Në praktikë ekzistojnë raste kur vullnetin për të lidhur martesë e shprehin personat hermafrodit⁴⁰ (persona biseksual). Andaj lind pyetja a mund të konsiderohet martesa e ligjshme në mes këtyre personave? Çështjet e vërtetimit të përkatësisë seksuale janë çështjet e ekspertizës mjekësore. Në teori dominon mendimi se nëse martesa lidhet me person hermafrodit, ku dominon gjini e njëjtë me atë të bashkëshortit tjetër martesa është e pavlefshme. Bashkëshorti mund të paraqesë padi për anulimin e martesës nëse konstaton se bashkëshorti i tij është i të njëjtit gjini.⁴¹

Problem tjetër në teori por edhe në praktikën ligjore paraqet ndërrimi i gjinisë me ndërhyrje mjekësore (transeksualiteti). Me të arriturat mjekësore, ekziston mundësia e ndërrimit të gjinive, prandaj edhe shtohet pyetja e vlefshmërisë së martesës me personin e tillë. Gjatë lidhjes së martesës, organet kompetente shërbejnë me të dhëna nga librat e gjendjes civile dhe dokumente të lëshuara nga to. Në teorinë juridike ekziston mendimi se nëse nga të dhënat e gjendjes civile rezulton se bashkëshortët e ardhshëm janë me gjini të ndryshme

⁴⁰ *Hermafroditi është shfaqja e shenjave të paidentifikuara gjinore tek njeriu, ku mund të paraqitet si hermafroditizëm i vërtet (hermaphroditismus verus) dhe si hermafroditizëm i dukshëm (pseudo-hermaphroditismus)*

Spiroviq- Trpenovska Lilana, E drejta familjare, Shkup, 2004, fq. 79

⁴¹ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 94

atëherë mbi këto të dhëna duhet lejuar martesën. Megjithatë problemi shtohet nëse nga operacioni rezulton që bashkëshorti të dalë me të njëjtin gjini sikurse bashkëshorti tjetër atëherë a duhet të ruhet martesë apo të shuhet? Shpesh ndodh ti referohen zgjidhjes së martesës. Sipas legjislacionit tonë nuk ekziston vendim ligjor në lidhje me ndryshimin e gjinis, as praktikë gjyqësore nuk ka në këtë drejtim.⁴² Mirëpo ky fenomen mund të mbetet i fshehur nëse bashkëshortët nuk e zbulojnë këtë ndryshim seksual. Por e drejta e bashkëshortit për të kërkuar zgjidhjen e martesës është e lejuar.⁴³

b) Deklarimi i vullnetit të lirë të bashkëshortëve përpara organit kompetent

Martesa është një bashkësi jetese e themeluar mbi bazën e vullnetit të lirë të bashkëshortëve të ardhshëm. Bashkëshortët para se të lidhin martesë pajtohen, përkatësisht e kanë arritur marrëveshjen për martesë. Kushti themelor për lidhjen e martesës është vullneti i lirë i bashkëshortëve. Kjo nënkupton faktin se martesë nuk duhet të lidhet me ndonjë imponim të shprehur në formë të lajthimit, mashtrimit, apo të dhunës. Martesa nuk do të jetë e plotëfuqishme, nëse pëlqimi është arritur përmes shtrëngimit, kërcënimit ose lajthimit, apo ndonjë mungesë tjetër të vullnetit të lirë nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm.⁴⁴ Liria në dhënien e pëlqimit për martesë duhet të jetë maksimale, në kuptim që, ajo çka i afron bashkëshortët e ardhshëm drejt ushtrimit të së drejtës për martesë, nuk ka të bëjë thjeshtë me plotësimin e dëshirave të të tjerëve ose sugjerimeve të të tjerëve, por të së drejtës së tyre. Pra, pëlqimi i lirë është standard, i cili ndonëse shpallet si kusht i rëndësishëm, është i pakontrollueshëm prej asnjë organi tjetër administrativ ose gjyqësor, publik ose privat, përveç vetë bashkëshortëve.⁴⁵

Në kohën e lashtë kërkohej pëlqimi i kryetarëve të familjes. Më vonë përveç pëlqimit të *paterfamilias*-it⁴⁶ kërkohej edhe pëlqimi i bashkëshortëve dhe në fund pëlqimi i bashkëshortëve kishte rëndësi juridike dhe ishte kusht i vetëm. Përsa i përket pozitës juridike në të drejtën e

⁴² Micković Dejan, Ristov Angel, E drejta familjare, Shkup, 2015, fq. 115

⁴³ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 95

⁴⁴ Neni 19, Ligji për familje, (Gazeta zyrtare e RM.së), nr.80\1992

⁴⁵ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 104

⁴⁶ *paterfamilias*-i është më i vjetri në një familje romake, i cili ishte përgjegjës dhe udhëheqës i familjes, në gjuhën shqipe ka kuptimin e plotë Kryefamiljari.

lashtë gruaja pas martesës i nënshtrohej direkt *pater familias*-it. Në të drejtën klasike dhe post-klasike humbi varësia e drejtpërdrejtë e gruas nga *pater-familias*-it. Në këtë periudhë ekzistoi mendimi se martesa është lidhje për jetë e burrit dhe e gruas, është ndarje reciproke drejtësisë hyjnore dhe njerëzore. Ekzistoi edhe mendimi se martesa është lidhje mes burrit dhe gruas që përbën bashkësinë e pandarë të jetës. Martesa ishte bashkësi monogame e jetës e rregulluar me dispozita juridike.⁴⁷

Mënyra e deklarimit të vullnetit. Për të qenë e vlefshme lidhja e martesës deklarimi i vullnetit duhet të bëhet në mënyrën e paraparë me ligj. Deklarimi i vullnetit duhet të bëhet nga të dy bashkëshortët personalisht. Vullneti i bashkëshortëve të ardhëm nuk mund të kushtëzohet me ndonjë kusht ose afat. Deklaratat e vullnetit duhet të jenë të pakushtëzuara dhe të menjëhershme. Deklaratat duhet të përputhen njëra me tjetrën dhe të shprehin pajtimin e bashkëshortëve për të lidhur martesë. Vullneti duhet të jetë vullneti i vërtet (real) që do të thotë se vullneti i shprehur duhet të përputhet me vullnetin e deklaruar.⁴⁸ Lidhur me këtë shtrohet pyetja nëse vullneti i deklaruar nuk përputhet me vullnetin e brendshëm a prodhon fuqi juridike vullneti i deklaruar? Në teori ka mendime të ndryshme por ato mund të përmbliken në dy më kryesore:

-Teoria e vullnetit të vërtetë dhe

-Teoria e deklarimit.

Sipas teorisë së vullnetit të vërtetë, për lidhjen e martesës duhet të merret për bazë vullneti i vërtetë i bashkëshortëve. Sipas teorisë së deklarimit, për të qenë e plotfuqishme martesa merret për bazë deklarimi i vullnetit. Në praktik është e vështirë të vërtetohet vullneti i brendshëm i bashkëshortit në momentin e deklarimit të vullnetit për lidhjen e martesës. Teoria e dytë është më afërt praktikës sepse deklarimi i vullnetit duhet të merret për bazë për lidhjen e martesës. Kur, vullneti i deklaruar ka të meta (është dhënë me dhunë, mashtrim, lajthimi) atëherë këto janë fakte të cilat i japin të drejtën bashkëshortit për të kërkuar anulimin e

⁴⁷ Selmani Bashkim, Rexhepi Bekim, E drejta romake ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore, Ferizaj, 2014, fq. 311

⁴⁸ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 95

martësës.⁴⁹ Mirëpo çdo herë duhet pasur parasysh faktin se në momentin e lidhjes se martësës të ndërmerren të gjitha masat nga organet kompetente (ofiqari) për të kuptuar vullnetin e vërtetë të bashkëshortëve dhe për të penguar deklarimin e ndonjë vullnetin me të meta ose në ndonjë formë simuluese. Vullneti i bashkëshortëve çdo herë duhet të deklarohet pozitivisht para organit kompetent dhe të jetë i menjëhershëm nga të dy bashkëshortët dhe nuk duhet të ketë të meta, ashtu që ky vullnet të prodhojë efekt juridik për të lidhur martësë.⁵⁰

c) Forma e lidhjes së martësës

Si kusht themelor për lidhjen e martësës është edhe lidhja e martësës në formën e paraparë me ligj. Sikur të jenë plotësuar kushtet e lartpërmendura si dallimi i gjinive dhe vullneti i lirë i deklaruar përpara organit kompetent por nuk lidhet martesa në mënyrën e paraparë me ligj, nuk ka martësë dhe të gjitha kushtet tjera themelore mbesin pa efekt juridik. Së këndejmi, martesa duhet të lidhet para organit kompetent (ofiqarit) dhe në formën e paraparë me ligj. Legjislacioni pozitiv e ka paraparë kompetencën e organit për lidhjen e martësës dhe mënyrën e lidhjes së saj.⁵¹ Personat të cilët kanë qëllim të lidhin martesa dorëzojnë fletparaqitjen deri te organi administrativ që është kompetent për mbajtjen e librave amëz të të kurorëzuarve, fletparaqitja për lidhjen e martësës mund të jepet me shkrim ose me gojë në procesverbal.⁵²

Ofiqari pasi të kontrollojë deklaratën e personave që dëshirojnë të lidhin martësë, vërteton a ekzistojnë pengesat martesore. Ofiqari është i obliguar me aktvendim ta refuzojë lidhjen e martësës nëse vërteton se në bazë të ligjit nuk është e lejuar lidhja e saj.⁵³ Për lidhjen e martësës është e nevojshme që dy persona që dëshirojnë të lidhin martësë në prani të tjerëve të shprehin në mënyrë të lirë vullnetin dhe pajtimin e tyre për martësë para ofiqarit. Ofiqari është organ i administratës komunale për gjendjen civile. Dita dhe ora e lidhjes së martësës caktohet nga ana e ofiqarit në marrëveshje me personat që dëshirojnë të lidhin martesa.⁵⁴

⁴⁹ Neni 36, Ligji për familjen, (Gazeta zyrtare e RM.së), nr.80\1992

⁵⁰ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 96

⁵¹ Po aty, fq. 96

⁵² Neni 23, Ligji për familjen, (Gazeta zyrtare e RM.së), nr.80\1992

⁵³ Po aty, Neni 24, Alinea 1,2,

⁵⁴ Po aty, Neni 25

Përveç organit martesë duhet të lidhet edhe në formën e caktuar nga ligj. Lidhja e martesës bëhet në formë solemne (*ad solemnitatem*) në lokalet posaçërisht për këtë qëllim, përjashtimisht edhe në lokale tjera për ndonjë shkak i arsyeshëm.⁵⁵ Gjatë procedurës së lidhjes së martesës duhet të plotësohen edhe kushtet tjera të siç janë: prania e të dy bashkëshortëve, dëshmitarëve, nëpunësit të gjendjes civile (ofiqarit), mënyra e dhënies së deklaratave dhe regjistrimi i martesës. Dëshmitarët për lidhjen e martesës mund të jetë çdo person me aftësi për të vepruar.⁵⁶ Pa plotësimin e këtyre kushteve nuk mund të lidhet martesë, nëse nuk janë respektuar këto kushte martesë mund të jetë objekt anulimi, ngase si e tillë është e pavlefshme.⁵⁷

Pasi delegati i kuvendit të komunës të vërtetojë se nuk ka kundërshtim lidhur me raportin e ofiqarit, i njofton bashkëshortët e ardhshëm mbi rëndësinë e martesës dhe të drejtat dhe detyrimet që dalin nga ajo. Pastaj i pyet veç e veç çdo njërin nga bashkëshortët e ardhshëm se a pajtohen të lidhin martesë me bashkëshortin e ardhshëm. Deklaratën e bashkëshortëve të ardhshëm se a pajtohen të lidhin martesë, ofiqari do ta shënojë në librin amzë të të kurorëzuarve, në të cilën pastaj do të nënshkruhen bashkëshortët e ardhshëm, delegati i komunës, dëshmitarët dhe ofiqari. Martesë është e lidhur kur bashkëshortët e ardhshëm do të nënshkruhen në librin amzë të të kurorëzuarve. Pas nënshkrimit delegati i komunës shpall se midis burrit dhe gruas, të thirrur në emrat e tyre personale, është lidhur martesë, pastaj u jepet çertifikatë nga libri amzë i të kurorëzuarve.⁵⁸ Çertifikata e martesës përmban emrin, mbiemrin e bashkëshortëve, emrin mbiemrin e prindërve të bashkëshortëve, datëlindjen e bashkëshortëve, vendlindjen e bashkëshortëve, gjinin, komësinë, shtetësinë, numri dhe data e aktit të martesës, mbiemri pas martesës, vendbanimi, data e lëshimit, emri mbiemri i ofiqarit.⁵⁹

Nëse personat që duan të lidhin martesë janë të mitur, paraqesin propozim të përbashkët që tu lejohet lidhja e martesës, në gjyqin kompetent vendor për njërin nga ata.⁶⁰ Propozimi përmban të dhënat personale për personin e mitur, për prindërit e tij dhe për

⁵⁵ Spiroviq- Trpenovska Lilana, E drejta familjare, Shkup, 2004, fq. 81

⁵⁶ Neni 27, Ligji për familjen, (Gazeta zyrtare e RM'së), nr.80\1992

⁵⁷ Spiroviq- Trpenovska Lilana, Micković Dejan, Ristov Angel, E drejta familjare, Shkup, 2013, fq. 99

⁵⁸ Neni 29, Alinea 3,4,5,6,7, Ligji për familje, (Gazeta zyrtare e RM'së), nr.80\1992

⁵⁹ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 143

⁶⁰ Neni 96, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, (Gazeta Zyrtare e RM'së), 2008, nr 9, fq. 65

personin me të cilin dëshiron të lidhë martesë, si dhe dëshmi për rrethanat se ai person e ka arritur pjekurinë trupore dhe psikike, të duhur për kryerjen e të drejtave dhe detyrave që vijnë në martesë.⁶¹

2.Kushtet martesore sipas të drejtës Islame

Martesa në Islam është quajtur besëlidhje rigoroze. Duke qenë se martesë është hallka më e rëndësishme e mirëqenies së individit dhe shoqërisë, Islami i ka dhënë rëndësi dhe interes të veçantë mbarrëvajtjes së institucionit të martesës, prej të cilit dalin dhe aftësohen individët e shoqërisë humane. Prej mirësisë së legjislacionit Islam dhe saktësisë së tij në vënien e dispozitave është që për çdo akt, çfarëdo qoftë, ai ka vendos rregulla me të cilat rregullohen ato dhe përcaktohet vlefshmëria e tyre për t'u zbatuar dhe për të funksionuar.⁶²

Sipas të drejtës islam, për çdo punë juridike e cila kryhet duhet të plotësohen disa kushte elementare të caktuara për të qenë valide kontrata. Pasi që edhe martesë është një kontratë e përpiluar me pëlqimin e të dy palëve (burrit dhe gruasë) ajo në vete duhet të përmbajë elementet e caktuara të cilët i japin fuqi ligjore.

Kurse në terminologjinë islame nikah d.m.th. kurorëzimi në mes burrit dhe gruas, me qëllim për të gjetur kënaqësi mes njëri-tjetrit, si dhe formimi i një familjeje të mirë dhe shoqërie të shëndoshë. Në mesin e këtyre akteve është edhe akti i nikahut, i cili ka disa kushte të cilat do t'i përmendim më poshtë:

a) Pëlqimi i ndërsjellë mes dy bashkëshortëve.

Nuk lejohet të detyrohet burri të martohet me atë që nuk e do. Gjithashtu, nuk lejohet të detyrohet femra që të martohet me atë që nuk e do. All-llahu i lartësuar thotë: "O ju që besuat, nuk është lejuar për ju të trashëgoni gratë (e të vdekurve) në mënyrë të dhunshme, e as t'i shtrëngoni për t'u marrë diçka nga ajo që ju keni dhënë atyre, përveç nëse ato bëjnë ndonjë imoralitet të hapur. Çoni jetë të mirë me to. Nëse i urreni ato, bëni durim pse ndodh që All-

⁶¹ Neni 97, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, (Gazeta Zyrtare e RM'së, 2008), nr 9, fq. 65

⁶² Halil Cin, Martesa në të drejtën Islame dhe Osmane, Ankara, 1974, fq. 23

llahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni”.⁶³ Nëse nuk pranon të martohet, nuk është e lejuar për askënd ta detyrojë të martohet, qoftë edhe prindi, ndaj në këtë rast për prindin nuk ka mëkat, nëse nuk e marton, ngase ajo vetë nuk ka dashur të martohet. Mirëpo, prindi e ka obligim ta ruajë dhe të kujdesët për të. Nëse dy persona e kërkojnë (dorën e saj) dhe ajo thotë e dua këtë person ndërsa veliu (përfaqësuesi) thotë fejohu për tjetrin, në këtë rast femra duhet të martohet më atë që e dëshiron ajo, nëse është i përshtatshëm për të. E nëse nuk është i përshtatshëm për të, veliu (përfaqësuesi) ka të drejtë të ndërhyjë dhe ta pengojë nga martesë më të, dhe në këtë rast nuk ka fare mëkat.⁶⁴

Liria e palëve nënkupton lirinë e plotë pa ndonjë kufizim eventual për të hyrë në kontratë martesore për mashkullin ashtu edhe për femrën. Disa prej parakushteve janë si p.sh. që palët të mos jenë eventualisht në kurorë, të gjenden në liri, të mos jenë në burg, internim, të zënë rob. Gruaja poshtu duhet të jetë e lirë dhe të mos jetë në periudhë kohore të pritjes martesore. Shëndeti psikik dhe mendor nënkupton që kandidatët për martesë duhet të jenë psikikisht të aftë dhe të kenë shëndet me rastin e lidhjes së kontratës martesore. Palët që eventualisht kanë qenë psikikisht të sëmurë apo kanë vuajtur nga ndonjë traumë apo çrregullim mendor, por pas terapisë së përdorur janë shëruar, mund të lidhin martesën pas shërimit pa kurrfarë kufizimi eventual. Mosha madhore nënkupton që palët mund të lidhin martesë në moshën e rritur, dmth. të mos jenë të mitur. Sipas së drejtës Islame(sheriatit) mosha madhore për gjininë femërore për të lidhur kurorë martesore është 15 vjet.⁶⁵

Liria e vullnetit të palëve nënkupton lirinë e plotë të të dy palëve me vullnetin e tyre për të lidhur martesë. Preferohet pëlqimi i prindit, kujdestarit apo tutorit, por në asnjë mënyrë prindi, kujdestari apo tutori nuk ka të drejtë të kushtëzojë apo të detyrojë sidomos femrën që të lidhi martesën në rast se ajo e kundërshton dhe nuk ka dëshirë të martohet me personin e preferuar nga prindi apo kujdestari i saj. Preferohet sidomos për vajzat që mendojnë të martohen partnerin që e zgjedhin të i përgjigjet besimit të saj, moralit të saj, arsimimit të saj, gjendjes ekonomike dhe financiare të saj, pasi që pas martesës mund të ballafaqohet me

⁶³ Sureja Nisa, Ajeti 19. Kur'an-i me komentim në gjuhën shqipe, 2000, fq.112, përktheu Ameti Sherif

⁶⁴ Shejh Muhamed ibn Salih el-Uthejmin, Martesa, publikim, fq. 3

⁶⁵ Miftari Faik, Martesa sipas drejtës Islame, publikim, 2014

probleme të cilët do të shkaktojnë pasoja eventuale për psiqikën e saj. Sidomos preferohet pëlqimi i prindit apo kujdestarit të saj për shkak se ajo në moshën e re mund edhe të gabojë gjatë përzgjedhjes së saj. Ndërsa për gratë që kanë qenë të martuara, nuk preferohet pëlqimi i prindit apo kujdestarit eventuale, pasi që ajo është e aftë vetë të vendosë, duke pas parasysh se më parë ka qenë e martuar. Lidhja jofarefisnore nënkupton që palët të mos jenë në lidhje eventuale sipas gjakut, qumështit.⁶⁶

b) Veliu

Kurorëzimi nuk është i vlefshëm pa veliun. Nëse femra martohet vetën pa dijen e veliut, nikahu i saj konsiderohet i pavlefshëm, pavarësisht a e ka bërë nikahun vetë apo e ka autorizuar dikë. Veliu është a i cili ka arritur moshën e pjekurisë, është i shëndosh mendërisht, i mençur (e di rëndësinë e martesës) dhe duhet të jetë i afërm i saj, si p.sh. babai, gjyshi nga ana e babait, djali, nipi, vëllai, vëllai prej babe, axha, vëllai i babait prej babës, si dhe fëmijët e tyre të afërm e më të afërm. Kështu, veli nuk mund të jenë vëllezërit nga nëna, fëmijët e tyre, gjyshi nga ana e nënës dhe dajallarët. Për derisa nikahu nuk bëhet pa veliun, atëherë për veliun është obligim të zgjedhë atë që është më i miri, nëse kërkesat për ta fejuar janë të shumta. E nëse e kërkon vetëm një dhe është i përshtatshëm dhe femra gjithashtu e pëlqen, e ka obligim ta martojë me të. Atij nuk i lejohet të manipulojë më të për qëllime personale ose ta martojë më dikë që nuk përshtatet, për shkak se ai lakmon në diç që i afrohet për të, sepse kjo konsiderohet tradhti. Mund të vëresh disa persona që ua kërkon vajzën e tyre ndokush që është i përshtatshëm për ta fejuar, pastaj e refuzon atë dhe të tjerë. Kush është i tillë, pozita e tij si veli bie, dhe kështu të drejtën e martesës se saj e merr dikush tjetër nga me të afërmit e saj.⁶⁷

c) Dëshmitarët.

Preferohet prezenca e dy dëshmitarëve me rastin e lidhjes martesore, sepse mos prezenca e tyre nënkupton martesën të pavlefshme. Dëshmitarët duhet të jenë meshkuj dhe të moshës madhore.

⁶⁶ Miftari Faik, Martesa sipas drejtës Islame, publikim, 2014

⁶⁷ Shejh Muhamed ibn Salih el-Uthejmin, Martesa, fq. 3

d) Mehri (dhurata e martesës)

Mehri (dhurata) është njëri prej kushteve martesore me të cilin nënkuptohet dhuratat apo vlerat materiale që burri duhet t'i dhurojë gruas në rastin së lidhjes martesës, me qëllim të sigurimit material në rast të vdekjes eventuale të burrit apo me rastin e shkurorëzimit eventual të tij nga gruaja. Gruaja kur e pranon mehrin (dhuratën) nga burri, ajo është pronare dhe poseduese e vetme e saj, ajo mund të disponojë me të, tua dhurojë prindërve të saj, burrit ë saj, fëmijëve të saj apo ta mbajë për vete sipas dëshirës së saj. Në periudhën paraislamike tutori ose babai e merrte për vete dhuratën martesore të bijës që e martonte dhe vajzave nuk u jepte asgjë. Islami e ka ndaluar këtë dhe ka urdhëruar që dhurata e martesës është e drejtë e femrës që martohet.⁶⁸ E drejta e parë nga të drejtat e gruas, është mehri- garanca e kurorës dhe ku sipas ajetit kuranor thuhet: Grave jepnu dhuratën e kurorës së tyre më të mirë, e në qoftë se ato nga vullneti i vet ju falin diçka nga ajo, atëherë hajeni atë hallall të mirë.⁶⁹ Mehri (dhurata) është dy llojesh:

- *mehri muaxhel* dhe

- *mehri muexhel*

Mehri muaxhel nënkupton të gjitha dhuratat martesore që i jep burri gruas me rastin edhe të fejesës por edhe të martesës, sikurse stolitë e arit, veshjes, mbathjes, dhe të tjera, ndërsa mehri muexhel nënkupton sasinë e të hollave apo të lirave të dukatit të përcaktuar me rastin e kontratës së martesës nga ana e gruas. Lartësia e saj nuk është e përcaktuar, porse minimalja preferohet që të jetë në një lartësi të shumës minimale jetësore për periudhën kohore një vjeçare, ashtu që gruaja gjatë saj periudhe kohore një vjeçare të ketë të mira materiale të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe fëmijët e saj, me rastin e vdekjes të burrit apo edhe me rastin e shkurorëzimit të burrit nga ajo. Mehri muexhel mund të përcaktohet edhe më vonë, pasi që të kryhet akti i kurorëzimit që për një arsye apo tjetër është anashkaluar apo nuk është përcaktuar në kohën e lidhjes së martesës.⁷⁰

⁶⁸ Karaman Hajreddin, Historia e të drejtës islame, Ankara, 1975, fq.36, Përktheu: Izeti Metin

⁶⁹ El-Kardavi Jusuf, Gruaja në Islam, Shkup, 2000, fq. 102, Sureja Nisa, Ajeti 4

⁷⁰ Miftari Faik, Martesa sipas drejtës Islame, publikim, 2014, fq. 5

KAPITULLI III

1. Pengesat martesore sipas Ligjit për Familje të Republikës së Maqedonisë

1.1 Historiku i pengesave martesore

Pengesat martesore (*impedimenta matrimonii*) janë fakte dhe rrethana të përcaktuara shprehimisht në ligj, ekzistenca e të cilave pengon lidhjen e martesës së vlefshme. Ato ndryshe quhen kushte negative dhe nuk duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës, sepse paraqesin pengesë për lidhjen e saj dhe shkaktojnë anulimin e martesës.⁷¹ Për të krijuar efekte, ato gjithashtu duhet të jenë të parashikuara shprehimisht me dispozita ligjore dhe veprojnë *erga omnes* ndaj të gjithëve apo *inter partes* ndaj një individi.⁷²

E drejta zakonore parashikon pengesa të cilat e bënin të pamundur lidhjen e martesës. Ato ishin absolute dhe me rrjedhoja juridike, prandaj palët, para se të lidhnin martesën duhej të verifikonin mirë ekzistencën e tyre. Pengesat juridike kishin njëkohësisht edhe karakter moral.⁷³ Koncepti i gjërë i afrisë së gjakut në të drejtën zakonore shqiptare ishin një pengesë serioze për lidhjen e martesave me dashuri të të rinjëve brenda fshatit sepse ata e konsideronin veten të të njëjtit fis me njëri tjetrin, kurse të rinjtë që jetonin larg nuk kishin mundësi të njiheshin. Krahas faktorëve të tjerë, ky koncept ndikoi për ruajtjen e fejesave me shkuesi. Lidhjet ritual, si pengesa për fejesë, barazoheshin edhe lidhjet ritual, të cilat ishin të vëllamëria dhe kumbaria. Lidhja ritual krijonin idenë e “afrisë së gjakut” dhe bëheshin pengesë për fejesë dhe martesë. Vëllamëria (vëllezër gishtash) barazohej me lidhjet e vërteta të gjakut: “E ka ba gjak gishtash. Me ja lyp çikën për nuse, çon marren ke shpija”. Pengesat për kumbarinë ishin më të buta, deri në pesë breza, por nderi e donte “me e ruejt për jetë”.⁷⁴

Para se të lidhej fejesa, palët ishin të detyruara të verifikonin ekzistencën e pengesave martesore. Në rast se nga padijenja e tyre lidhej një fejesë e tillë, atëherë ajo konsiderohej e pavlefshme. Familja e djalit detyrohej të hiqte dorë menjëherë prej vajzës “së xanun”, kurse familja e vajzës detyrohej të kthente çdo gjë që kishte marrë për shkak të fejesës, si shejin

⁷¹ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 75

⁷² Trpenovski Spiroviq Liljana, Mickoviq Dejan, Ristov Angel, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 101

⁷³ Luarasi Aleks, Marrëdhëniet familjare, Tiranë, 2001, fq. 79

⁷⁴ Elezi Ismet, Kanuni i Labërisë, Tiranë, 2006, fq. 98

(unazën, shaminë) dhe shpërblimin për fejesë. Ekzistenca e pengesave për fejesë ishte shkaku i vetëm i pavlefshmërisë së fejesës e të martesës sipas së drejtës zakonore shqiptare. Kanunet nuk shprehen se si do të veprohej në rast se palët merrnin dijeni për ekzistencën e pengesave pas kryerjes së martesës, sidomos pas lindjes së fëmijëve. Mirëpo nga konteksti i normave kanunore, sidomos nga shembujt praktikë të zbatimit të tyre del se një martesë e tillë, sidomos pas lindjes së fëmijëve, nuk mund të deklarohet e pavlefshme. Pengesat kishin për qëllim të parandalonin ardhjen e disa rrjedhøjave të caktuara. Me martesën e palëve ato nuk mund të parandaloheshin, prandaj edhe pengesat në tërësi i referohen institutit të fejesës e jo atij të martesës. Përkatësia e ndryshme fetare e palëve ishte një pengesë ideologjike për fejesë, por jo juridike. Asnjë nga kanunet shqiptare nuk e rradhiti fenë ndërmjet pengesave për fejesë. Shkaku i një qëndrimi pothuajse të njëjtë i së drejtës zakonore për sa i përket fesë si pengesë për fejesë është se kanunet janë shumë të vjetra, qysh nga kohet pagane kur dallimet fetare nuk ekzistonin. Mandej dhe më vonë, pas pushtimit Osman, kur dallimet fetare u bënë një realitet, shqipëtarët treguan një tolerancë të habitshme për çështjet fetare. Megjithatë kjo nuk do të thotë se martesat e përzijera nga pikëpamja fetare ishin një gjë e zakonshme. Jo, ishin një dukuri e rallë, por nuk ishin pengesa kanunore.⁷⁵

Sipas së drejtës romake që martesa të ishte e vlefshme përveç kushteve konstitutive duhej që bashkëshortët të mos përfshiheshin në disa rrethana që e bënin lidhjen martesore nule, këto rrethana përbënin pengesat martesore. Martesa ekzistuese ishte një nga pengesat themelore për një martesë të re sekondare. E drejta romake në vendosjen e kësaj pengese niset nga rëndësia e mbrojtjes së parimit të monogamisë. Sëmundja e shfaqur para lidhjes së martesës ishte një tjetër pengesë. Ishte fjala për sëmundje të rënda të cilat bënin që martesa të mos realizonte atë funksion për të cilin edhe lidhej. Gjinia e gjakut në vijë të drejtë pa kufizime dhe në vijë të tërthortë deri në shkallë të gjashtë ishte një tjetër pengesë martesore. Po kështu pengesë ishte edhe krushqia në vijë të drejtë. Në kohërat e mëvonshme ndalohej martesa ndërmjet drejtuesit të provincës dhe grave që banonin në këtë provincë, ndërmjet të krishterëve dhe pagnëve, ndërmjet krishterëve dhe hebrenjëve, ndërmjet personave që ishin betuar se nuk do të martoheshin, ndërmjet atyre që kishin shkelur kurorën si dhe martesa e

⁷⁵ Luarasi Aleks, Marrëdhëniet familjare, Tiranë, 2001, fq. 82

ushtarëve. Në periudhën post klasike martesë e lidhur me dhunë ishte e pavlefshme ashtu sikurse edhe martesë e një të çmenduri.⁷⁶

1.2 Kuptimi dhe llojet e pengesave martesore

Martesa lidhet para organeve të shtetit dhe ka karakterin e vet laik (civil).⁷⁷ Me deklarimin e vullnetit të lirë si kusht themelor mund të lidhet martesë e vlefshme. Mirëpo, kur vullneti është deklaruar me forcë, mashtrim, lajthim në këtë rast mund të kërkohet anulimi i martesës sepse ekziston mungesa e vullnetit të lirë, që do të thotë egzistojnë pengesat martesore. Së këndejmi, pengesat dallojnë nga kushtet themelore, sepse pa plotësimin e kushteve themelore nuk mund të lidhet martesë. Sa i përket pengesave, mungesa e të cilave, nga ana e sistemit juridik, konsiderohet thelbësore, prania e tyre jo vetëm ndalon martesën, por sjell dhe pavlefshmërinë e saj në rast se ajo është kurorëzuar pavarësisht nga pengesat.⁷⁸ Për të krijuar efekte, ato gjithashtu duhet të jenë të parashikuara shprehimisht me dispozita ligjore dhe veprojnë *erga omnes*. Nëse do t'i referohemi praktikës gjyqësore të deritanishme, është shumë i spikatur fakti që, në seksionet e gjykatës që trajtojnë zgjidhjet e mosmarrëveshjeve familjare e martesore, pushimi i martesës përbën numrin më të madh të rasteve, për pavlefshmërinë le të themi se këto raste numërohen me gishta. Në teorinë juridike pengesat martesore klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme, si:

- a) Pengesat martesore të evitueshme dhe të pa evitueshme
- b) Pengesat martesore të përhershme dhe të përkohshme
- c) Pengesat martesore absolute dhe relative

a) Pengesat martesore të evitueshme dhe të paevitueshme

Ky klasifikim merr si kriter bazë mundësinë e evitimit të mungesës konkrete martesore. Të evitueshme janë ato pengesa martesore për të cilat gjyqi mund të japë lejen për lidhjen e martesës, por vetëm në raste të parashikuara me dispozita ligjore. Pengesat e tilla në të drejtën

⁷⁶ Selmani Bashkim, Rexhepi Bekim, E drejta romake ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore, Ferizaj, 2014, fq 313, 314

⁷⁷ Ismaili Hilmi, Sejdiu Fatmir, Historia e shtetit dhe e së drejtës I, Prishtinë, 2002, fq. 253

⁷⁸ Bonilini Giovanni, Manual i së drejtës familjare. Tiranë, 2005, fq. 57

tonë, janë: mituria dhe gjinia e krushqisë, nga se në rastet e justifikueshme gjykata mund të lejojë lidhjen e martesës me gjithë ekzistimin e këtyre pengesave martesore. Pengesat martesore të paevitueshme janë pengesat, për të cilat gjykata nuk mund të japë leje për të lidhur martesë. Pengesat e paevitueshme janë: mungesa e vullnetit dhe martesë ekzistuese, sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar si dhe gjinia e gjakut.⁷⁹

b) Pengesat martesore të përhershme dhe të përkohshme

Pengesat martesore të përhershme janë ato pengesa që nuk pushojnë së egzistuari dhe me kalimin e kohës, deri në vdekje. Si e tillë është gjinia e gjakut. Pengesat martesore të përkohshme janë pengesat të cilat me kalimin e kohës mund të pushojnë së egzistuarit. Të tilla janë : mungesa e vullnetit , martesë ekzistuese , sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar dhe mituria.⁸⁰

c) Pengesat martesore absolute dhe relative

Pengesat martesore absolute pamundësojnë lidhjen e martesës me cilindo person. Të tilla janë: sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar, mituria deri në moshën 16-vjeçare dhe ekzistimi i martesës. Pengesat martesore absolute veprojnë mbi të gjithë personat (erga omnes). Pengesat martesore relative pamundësojnë lidhjen e një martese vetëm me persona të caktuar (gjini krushqie). Pengesat e tilla veprojnë vetëm mbi persona të caktuar (*inter partes*). Ky klasifikim merr për bazë faktin se kush është i autorizuar për paraqitjen e padisë për anulimin e martesës. Me pengesa martesore absolute shkelen interesat e përgjithshme shoqërore, andaj është i gjerë rrethi i personave të cilët kanë të drejtë të parashtrojnë padi-secili nga bashkëshortët, prokurori publik dhe të gjithë personat që kanë një interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm që martesë të anulohet. Nga ana tjetër, me pengesa martesore relative shkelen vetëm interes personale të personave dhe vetëm bashkëshortët mund të paraqesin padinë për anulimin e martesës.⁸¹

⁷⁹ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 76

⁸⁰ Po aty, fq. 77

⁸¹ Po aty, fq. 76

1.3 Klasifikimi i pengesave martesore sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë

Legjislacioni ynë parasheh këto pengesa martesore:

- mituria
- martesa ekzistuese
- sëmundja psikike dhe pazotësia për të vepruar
- gjinia (e gjakut, krushqisë, adoptimit)
- mungesa e vullnetit

1. Mituria

Mituria është një pengesë absolute martesore, sepse vetëm personi madhor mund të lidhë martesë të vlefshme juridikisht. Me termin i mitur, në të drejtën martesore nënkuptojmë moshën e caktuar, e cila sipas ligjit nuk konsiderohet e mjaftueshme që persona me gjini të kundërta të mund të lidhin martesë. I mitur është personi i cili ende nuk ka mbushur 18 vjet. Mosha për të lidhur martesë është caktuar 18 vjet për burrin e po aq për gruan. Kjo, sepse të miturit nuk janë në gjendje për të kuptuar rëndësinë e deklaramit të vullnetit të lirë, për shkak të moshës së re, papjekurisë psikike dhe fizike, dhe as për të kuptuar pasojat që rezultojnë nga moskryerja e të drejtave dhe detyrimeve martesore.⁸² Në këtë mënyrë ligji mbron fëmijët që nuk janë në gjendje të kryejnë të drejtat dhe detyrimet martesore, duke mos u dhënë leje për të lidhur martesë, për shkak të papjekurisë psikike dhe fizike të tyre. Minimumin e moshës për të mitur, nën të cilën nuk lejohet lidhja e martesës as me vendim gjyqësor, nuk e përcakton ligji, po autorizohet gjykata që për shkaqe me rëndësi të lejojë lidhjen e martesës së një të mituri edhe përpara mbushjes së moshës 18 vjet, pra pa e caktuar minimumin e moshës së miturit nën të cilën lidhja e martesës është e ndaluar. Por, me atë rast, si shkaqe të rëndësishme apo të justifikueshme, përpara se ta japë lejen, gjykata gjithësesi duhet të vërtetoj për secilin rast konkret nëse i mituri ka arritur pjekurinë psikike dhe fizike të nevojshme për kryerjen e të drejtave dhe detyrave në martesë.⁸³

⁸² Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 87

⁸³ Po aty, fq.88

Ligji për familje i RM'së përcakton si minimum të moshës 16 vjet për të miturën si kusht që gjykata të mund të japë leje për martesë nëse ekzistojnë shkaqe të justifikueshme.⁸⁴ Mituria shkakton pavlefshmërinë absolute të një martese, por ajo është e përkohshme dhe e evitueshme. Është e përkohshme, sepse me kalimin e kohës i mituri mund të arrijë moshën madhore ose të fitojë zotësinë për të vepruar, ndërsa e evitueshme, sepse me leje të gjykatës i mituri mund të lidhë martesë të vlefshme nëse ka më shumë se 16 vjet.⁸⁵ Ndodh shpesh që të miturit, bashkëjetojnë, por pasi arrijnë moshën e pjekurisë atëherë bëjnë kurorëzimin në organin kompetent. Faktorët që ndikojnë në lidhjen e martesave të hershme janë të shumtë, mirëpo ne do të fokusohemi vetëm te disa nga to, si: mungesa e komunikimit të shëndosh në relacionet prindër-fëmijë, mungesa e shkollimit adekuat, sidomos për vajza - pasi që vajzat në këtë aspekt konsiderohen si më të shkelurat - pastaj faktorët ekonomiko-social, mungesa e vetëdijesimit adekuat për këtë fenomen (në disa komunitete faktor është edhe tradita, sepse ata tradicionalisht kanë pasur martesa të hershme), pastaj faktor tjetër është edhe frika e prindërve - familjes - se vajzat do të mund të kryenin marrëdhënie seksuale para martesës (apo të hasin në ngacmimet seksuale, dhe kjo do të ndikonte në prestigjin shoqëror, influencën dhe kredibilitetin familjar, për çka një pjesë e tyre i shtyjnë vajzat që të martohen në fëmijëri). Në martesat e hershme çiftet ende janë të papjekur psikologjikisht; ka divorce të shumta; dhuna shpeshherë është më e lartë si në aspektin fizik e po ashtu edhe atë psikologjik; gruaja kryesisht varet nga të ardhurat e burrit apo familjes së burrit; shtatëzani e hershme dhe e padëshiruar; problemet me shtatëzani ku kjo madje mund të rezultojë edhe me vdekjen e fëmijës apo edhe të nënës, sepse në konstruktin biologjik trupi i një të miture ende nuk është i përgatitur për të lindur fëmijë.⁸⁶ Martesa e fëmijëve ka ndodhur tek bashkësia rome dhe shumë më rrallë tek bashkësitë e tjera. Ka qenë e vështirë të vlerësohet numri i martesave të hershme, për shkak se martesat e këtilla janë regjistruar rrallë herë. Martesat e hershme janë shkelje e të drejtave të njeriut, por edhe një nga format e dhunës në bazë gjinore, ndaj është shumë i rëndësishëm parandalimi i këtij fenomeni që ndikon negativisht në arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve. Sipas një interviste të realizuar, rezulton se 11% e grave të moshës 20-49 vjeçe janë

⁸⁴ Bonilini Giovanni, Manual i së drejtës familjare, Tiranë, 2005, fq. 51

⁸⁵ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 88

⁸⁶ Kamberi Ferdi, Martesa e hershme dhe shoqëria kosovare, publikim, 2013

martuar para moshës 18 vjeçe. Martesat e hershme janë përhapur kryesisht në komunitetin rom por edhe në zonat rurale ku ende fanatizmi është prezent.

Nëse u referohemi ligjeve të Ballkanit shihet se Ligji i Familjes, i Kosovës, nuk lejon martesën e personave që nuk e kanë shtuar moshën madhore përkatësisht zotësinë e veprimit, nëse personi ka mbushur moshën 16 vjeç dhe me vendim gjyqësor i është dhënë zotësia e veprimit – emancipimi. Emancipimi shtohet pas një procedure jokontestimore për të cilën aplikojnë personat e interesuar ose prindërit e të miturve, por, vetëm kur ata dëshirojnë të lidhin martesë ligjore dhe në procedurën e përcaktuar me ligjin e familjes. Poashtu edhe Ligji i Familjes, i Kroacisë në nenin 25 e thekson, martesën mund ta lidhin vetëm personat të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeç. Mituria është një pengesë absolute martesore, sepse vetëm personi madhor mund të lidhë martesë të vlefshme juridikisht. Legjislacioni shqiptar i vitit 1982 e përcaktonte edhe moshën në mënyrë taksative për martesë duke e paraparë se femrat kanë të drejtë martese në moshën 16 vjeç, ndërsa meshkujt në moshën 18 vjeç. Kodi i Familjes aktual e përcakton moshën madhore për të dy gjinitë. Mosha madhore në Republikën e Shqipërisë shtohet në moshën 18 vjeç. Mosha 18 vjeç është moshë madhore, dhe konsiderohet “dysHEMEJA” e tolerueshme për lidhjen e martesës. Mosha madhore sipas Ligjit të Familjes në nenin 26, në Malin e Zi arrihet në moshën 18 vjeç me çrast edhe shtohet zotësia e veprimit. Poashtu emancipimi nuk arrihet pa vendim të gjykatës. Kur fëmija para mbushjes së moshës madhore martohet për arsye objektive gjykata kompetente mund të lejojë martesën edhe para mbushjes së moshës 18 vjeç.⁸⁷

Sipas të dhënave zyrtare të Entit Shtetëror për Statistikë të Maqedonisë. Në vitin 2014 janë martuar 13 meshkuj dhe 163 femra të moshës nën 18 vjet. Në 2015 janë martuar 5 meshkuj, ndërsa 135 femra të moshës nën 18 vjet, ndërsa në vitin 2016 – nën moshën 18 vjeçare janë martuar 7 meshkuj dhe 119 femra, dhe kështu vite me rradhë vazhdon numri i njëjtë të martesave.⁸⁸

⁸⁷ Belegu Majlinda, *Bashkësia faktike sipas legjislacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor*, Akademia diplomatike shqipëtare, Tiranë, 2016, fq. 42

⁸⁸ www.telegrafi.com /Gazeta KOHA, publikim, 2017

2. Martesa ekzistuese

Martesa monogame, ka baza nga e drejta romak ku është shprehur në përkufizimin e martesës dhënë në burimet ligjore: *-Nuptae sunt coniunctio maris et feminae et consorcium omnis vitae, divini et humani iuris communicatio-* " Martesa është një marrëdhënie mes një burri dhe një gruaje, një bashkësi e të gjitha formave të jetës, institucion i të drejtës hyjnore dhe njerëzore. Si një pengesë martesore qysh në ligjin romak, monogamia kishte për qëllim për të mbajtur martesën si një bashkim mes një burri dhe një gruaje në frymën e krishterimit, ndryshe nga vendet myslimane, veçanërisht në Perandorinë Osmane, ku poligamia është e lejuar, burri mund të ketë më shumë se një grua.⁸⁹

Ligji shprehimisht parasheh pavlefshërinë e martesës së re derisa martesa e parë e njërit bashkëshort nuk zgjidhet ose nuk pushon në mënyrën e parashikuar në ligj. Kjo do të thotë se nuk mund të lidhet një martesë tjetër para se të zgjidhet e mëparshmeja. Një rregull e tillë është shprehur në parimin e monogamisë, i cili gjenë zbatimin edhe te ne, si një themel i rëndësishëm i së drejtës martesore dhe i civilizimit juridik. Ligji nuk lejon qenien në të njëjtën kohë të dy martesave (bigaminë). Ashtu që, martesa e dytë, si e lidhur në kundërshtim me ligjin, nuk mund t'i heqë fuqinë ligjore martesës së parë. Në këtë rast, gjykata shqyrton më parë çështjen e martesës së mëparshme dhe në qoftë se kjo martesë shpallet e pavlefshme, martesa e dytë mbetet e vlefshme.⁹⁰

Qëllimi i monogamisë është mbrojtja e interes publik dhe të interesave individuale të drejtpërdrejta juridike të mbështetura në plotfuqishmërinë e martesës së mëparshme, e cila është zhvlersuar me lidhjen e martesës së re. Nga ana tjetër, bigamia është sanksionuar si vepër penale me norma penalo-juridike pozitive. Kjo ndryshe njihet si mungesa e *status liberum* që do të thotë, në çastin e lidhjes së martesës së re, njëri ose të dy bashkëshortët e ardhshëm janë në një raport martesore ekzistues ose nuk janë në kushtet e gjendjes së lirë për nga statusi marital.⁹¹

⁸⁹ Georgiev Aleksandr, Bracni precki, Shkup, 2013, fq. 4

⁹⁰ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 81

⁹¹ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 105

Nëpunësi i gjendjes civile ka detyrë të vërtetojë nëse bashkëshortët e ardhshëm janë të lidhur me një martesë tjetër. Këtë e bën me anë të certifikatës të të kurorëzuarve, e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se një person i cili një herë ka qenë i martuar nuk mund të lidhë martesë tjetër. Gjatë jetesës së tij, një person mund të lidhë një numër të pakufizuar martesash, por vetëm pasi që të mëparshmen ta ketë zgjidhur në një mënyrë të parashikuar në ligj. Martesa e re mund të lidhet menjëherë pas zgjidhjes së martesës së mëparshme. Pas zgjidhjes apo pushimit të martesës së parë, në mënyrë të parashikuar në ligj, legjislacioni ynë nuk parasheh kalimin e afatit të pritjes -postmartesore, si kusht për të fituar të drejtën për lidhjen e martesës së re, që ka si qëllim shmangien e kontesteve rreth vërtetimit të atësisë.⁹²

3. Sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar

Nuk lejohet të lidhin martesë personat, të cilët për shkak të formës së manifestuar të sëmundjes psikike me prani të simptomave psiohotike ose me shenja reziduale nga sëmundja nuk janë në gjendje për të kuptuar rëndësinë dhe detyrimet që rezultojnë nga martesë dhe që në të njëjtën kohë janë të paaftë për të gjykuar. Njëkohësisht nuk mund të lidhin martesë edhe personat me zhvillim të metë mendore (psikike) nëse i takojnë grupit të personave me mbetje mentale të rëndë dhe më të rëndë nëse IQ është nën 36 shkallë.⁹³ Sëmundjet psikike mund të jenë të natyrave të ndryshme si bie fjala ; skizofrenia, paranoja, deliriumet, depresionet maniakale edhe psikozat reaktive sikurse edhe disa sëmundje intelektuale (idiotësia, imbeciliteti, etj) të cilat klasifikohen si shkak pengese për martesë dhe lidhja e martesës me individët me probleme, prodhon pavlefshmërinë e saj.⁹⁴

Sëmundje psikike dhe zhvillimi i metë mendor janë situata objektivist të monitorueshme (të kontrollueshme) dhe të diagnostifikueshme. Për këtë arsye raportet mjekësore të veçanta janë shumë të rëndësishme. Jo çdo sëmundje përbën ndalesë për martesë. Kur sëmundja shfaqet pas lidhjes së martesës , kjo nuk është ndalesë për lidhjen e

⁹² Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 82

⁹³ Neni 18, Ligji për familjen, (Gazeta zyrtare e RM'së), 2016

⁹⁴ Shih deklaratën për shtyp të Amnesty International (AI), " Albania: disability and the right to marry", 11 Nëntor 2004

martësës, sepse nuk kishte mundësi të dihej që bashkëshorti apo bashkëshortja do të sëmurej.⁹⁵ Kur ofiqari refuzon lidhjen e martësës të personave me simptoma të sëmundjeve shpirtërore, gjykata duhet të vërtetojë me anë të ekspertizës mjeko-ligjore në secilin rast konkret nëse personat në fjalë manifestojnë sjellje të njerëzve anormal dhe nëse janë të sëmurë psikikisht, para se t'u lejojë apo të mos ua lejojë lidhjen e martësës personave të tillë. Është çështje e rëndësishme se bashkëshortët e ardhshëm nuk janë të detyruar në ligj t'i nënshtrohen ekzaminimit të shëndetit mental me rastin e lidhjes së martësës, veçse nëpunësi i gjendjes civile ka për detyrë ti këshillojë që të informohen reciprokisht për gjendjen shëndetësore deri në ditën e lidhjes së martësës. Në qoftë se kemi të bëjmë me një gjendje të kompromentuar të vetëdijes, pra të një gjendjeje të njohur për mjedisin, të shfaqur tek njëri nga bashkëshortët e ardhshëm, nëpunësi i gjendjes civile me aktvendim refuzon fletëparaqitjen për lidhjen e martësës. Siç theksohet shpesh në psikiatri, përkufizimi kufirit midis personit të shëndoshë dhe të sëmurë është çështje e cila nuk mund të zgjidhet në bazë të kriterëve objektive paraprakisht të përkufizuar.⁹⁶

Për të lejuar personin me pazotësi veprimi për të lidhë martësë, çdoherë kërkohet vendimi i gjykatës. Nëpunës i gjendjes civile duhet t'i këshilloj personat të cilët dëshirojnë të lidhin martësë, për tu informuar për gjendjen shëndetësore të bashkëshortëve. Personat të cilët janë të numëruar si persona me pengesa të zbutura në zhvillimin psikik ose me pengesa të lehta në zhvillimin psikik si edhe personat, të cilët kanë sëmundje trashëguese nga familja, mund të lidhin martësë pas mendimit të marrë lidhur me konstrukcionin gjenetik të dhënë nga Enti për shëndet mendor të fëmijëve dhe të rinjëve në Shkup ose ndonjë institucioni tjetër përkatës që merret me humultime gjentike.⁹⁷ Pra, gjykata duhet të hetojë lidhur me:

- Pjekurinë fiziko-psikike, që duhet të përfshijë gjithë pjekurinë e subjektit për të kuptuar rëndësinë e martësës në tërësinë dhe integriteti e saj. Kjo pjekuri duhet konstatuar prej veprimeve të subjekteve dhe jo thjesht prej deklarimeve të tyre;

⁹⁵ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 113

⁹⁶ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 105

⁹⁷ Micković Dejan, Ristov Angel, E drejta familjare, Skopje, 2015, fq. 120

- Rëndësinë e motivit. Motivi duhet trajnuar në raport me atë se çfarë i shtyn subjektet të kërkojnë lejen e gjykatës për lidhjen e martesës përpara kohe dhe jo sipas rregullave të martesës;
- Bazueshmëria e motivit. Arsytet duhet të jepen qartë. Ato duhet të jenë reale dhe konkrete.⁹⁸

Martesa mund të anulohet nëse bashkëshorti nuk ka aftësi për të vepruar për shkak të sëmundjes psikike të diagnostifikuar apo shkaqeve tjera.⁹⁹ Arsytet e ekzistimit të kësaj pengese martesore janë: E para, nuk ekziston shprehja e vullnetit në mënyrë relevante juridike, sepse personat me shëndet mental të metë nuk janë të vetëdijshëm dhe nuk mund ta kuptojnë rëndësinë e veprimeve të veta. Atë shprehje të vullnetit të lirë nuk janë në gjendje ta kuptojnë në mënyrë serioze. Vetëm personat e aftë për të kuptuar rëndësinë, qëllimin dhe për të realizuar të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga martesa mund të lidhin një martesë të vlefshme. E dyta, sipas analizave të kryera, 16 për qind të fëmijëve të sëmurë nga skizofrenia kanë trashëguar sëmundjet nga prindërit. Tek disa sëmundje të tjera mentale shkalla e trashëgimisë së sëmundjes nga prindërit arrin shkallën 60-80 për qind. Kjo pastaj do të ishte shkak degjenerimi i popullsisë dhe barrë e rëndë e shoqërisë për t'u kujdesur dhe për t'i shëruar personat e tillë.¹⁰⁰

Varësia ndaj drogave të ndryshme njihet si një problem mjaft shqetësues për popullsinë tonë, drogat e ndryshme jo vetëm që shkatrojnë personat që konsumojnë, por shkatrojnë edhe shoqërinë përreth, nga rritja e numrit të konsumatorëve rriten edhe problemet, kështu shumë prej tyre kanë humbur ardhmërinë e tyre, kanë humbur familjet e tyre, kanë shkatruar martesat e tyre, prandaj konsumimin e drogave e shohim si një lloj sëmundje që mund të pengojë që të lidhet martesa. Pra, nëse gruaja shtatzënë përdor drogat të paligjshme si p.sh. kanabis sativa (hashash), e-hapjet, amfetamina, kokaina apo heroina, ato mundet midis të tjerash, të shkaktojnë humbjen e fetusit, dëmtimin e placentës apo lindjen e parakohshme të fëmijës. Për më tepër, ka rrezik që zhvillimi normal mendor i fëmijës, të dëmtohet dhe fëmija të rrezikohet

⁹⁸ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 103

⁹⁹ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 105-106

¹⁰⁰ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 83

prej sëmundjeve të rënda, të cilat kërkojnë kurim dhe përkujdesje të veçantë.¹⁰¹ Kjo e njëjta vlen edhe për burrat. Prandaj ndodh që personat që kanë vendosur të lidhin martesë dhe pastaj kuptojnë që njëri nga bashkëshortët e ardhshëm është konsumator i ndonjë lloji droge, atëherë mund të kërkohet anulimi i asaj martese. Gjithashtu edhe alkoholi luan rolin e njëjtë si droga, pra edhe një person që është i alkoholizuar nuk mund të lidhë martesë. Si për drogën edhe për alkoholin me anë të kërkesës në gjykatë, ku gjykata duhet të vërtetojë me anë të ekspertizës mjeko-ligjore në secilin rast konkret nëse personat në fjalë janë konsumator të drogës apo alkoholit.

Veçori themelore e kësaj pengese martesore është se sëmundja psikike ose zhvillimi mendor i metë duhet të ekzistojë në çastin e lidhjes së martesës, përkatësisht në momentin e deklarimit të vullnetit para nëpunësit të gjendjes civile. Po në këtë rast duhet të ekzistojë edhe pazotësia e veprimit. Ekzistimi i sëmundjes psikike ose zhvillimit mendor i metë dhe pazotësia për të vepruar vetëm në çastin e lidhjes së martesës janë pengesa martesore absolute. Nuk është e vlefshme martesa e lidhur nga personi i sëmurë ose me zhvillim mendor të metë ose pazotësi veprimi. Në qoftë se sëmundja psikike ose zhvillimi mendor i metë shfaqet pas lidhjes së martesës, ajo nuk përbën shkak për pavlefshmërinë e martesës. Në këtë rast ajo mund të përbëjë vetëm shkak për të kërkuar zgjidhjen e martesës, në qoftë se provohet tronditja e thellë e marrëdhënieve bashkëshortore dhe pamundësia e vazhdimit të bashkëjetesës. Është çështje faktike nëse kjo pengesë martesore është paraqitur pas lidhjes së martesës. Nuk është juridikisht relevante nëse ka ditur apo jo bashkëshorti tjetër për ekzistimin e kësaj pengese para apo pas lidhjes së martesës. Duhet theksuar se sëmundja psikike dhe zhvillimi mendor i metë dhe pazotësia për të vepruar shkaktojnë pavlefshmërinë absolute, por të përkohshme, nëse sëmundja është e shërueshme.¹⁰²

4. Gjinia

Gjinia si pengesë martesore paraqitet në tri llojet e saja:

- a) Gjinia e gjakut
- b) Gjinia e krushqisë dhe

¹⁰¹ www.landlaeknir.is / Alkooli, drogat dhe shtatzënia, publikim

¹⁰² Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 84

c) Adoptimi (gjinia civile)

a) Gjinia e gjakut

Një parakusht i rëndësishëm për lidhjen e martesës është që pretenduesit për martesë të mos jenë të afërt nga gjaku me njëri tjetrin.¹⁰³ Gjinia e gjakut është pengesë martesore në shkallë dhe në vijë të përcaktuar në dispozita ligjore. Nuk mund të lidhet martesë midis personave në gjini gjaku në vijë të drejtë pa kufizim, ndërsa në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt: pra, vëllai dhe motra nga prindërit e përbashkët, vëllai dhe motra nga vija e amësisë ose e atësisë, xhaxhai dhe mbesa, daja dhe mbesa, teza dhe nipi, fëmijët e vëllait e të motrave nga prindërit e përbashkët dhe fëmijët e vëllazërve dhe të motrave në vijë të drejtë të amësisë ose të atësisë. Në vijë të drejtë, pavarësisht nga shkalla, gjinia e gjakut është pengesë martesore pa kufij. Shkallët ose gradët janë treguesit e afërsisë së lidhjes së gjakut midis këtyre personave. Çdo brez i përket një grade apo një shkalle. Sa breza janë, aq edhe shkallë do të kemi. Në llogaritjet e shkallëve do të zbresim gjithnjë atë që e quajmë trungu familjar, pra prindërit. Për sa u përket bashkëshortëve, është e kuptueshme që midis tyre nuk ka lidhje gjinie apo gjaku sepse kjo është një prej kushteve për martesë, midis tyre ka lidhje juridike.¹⁰⁴ Të gjitha kanunet shqiptare, pa përjashtim, mbanin qëndrim të prerë dhe të rreptë për ndalimin e martesave ndërmjet djemve e vajzave që i përkitnin të njëjtit fis d.m.th. që kishin lidhje gjaku nga nëna. Ekzogamia e kishte bazën në kujdesin për të lindur fëmijë të shëndetshëm e për të shmangur rrjedhojat e dëmshme që sillnin martesat e një gjaku (*konsanguine*).¹⁰⁵ Kurse sipas Kanunit të Skënderbeut pa mbarim, mjaftonte të ishin ndarë dikur “nga një zjarr”. Për lidhjet nga nëna dhe lidhjet e krushqisë fejesa ndalohej nga pesë deri në shtatë breza.¹⁰⁶ Kanuni i Labërisë mbante një qëndrim më të matur dhe më realist. Këtu pengesat për fejesë e martesë ishin më të ngushta për sa i përket afërsisë së gjakut: ato shtriheshin për fisin deri në shtatë breza dhe për gjininë deri në pesë breza. Aty bëhej qartë dallimi midis lidhjeve fisnore e gjinore dhe lidhjeve territoriale. Martesa brenda çetës nuk bëheshin; një gjë e tillë i konsiderohej “turpi i madh”, sepse ishin të afërt nga gjaku e mbaheshin si motër e vëlla, kurse brenda fshatit nuk

¹⁰³ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 108

¹⁰⁴ Po aty, fq. 110

¹⁰⁵ Gecovi Shtjefën, Kanuni i Lekë Dukagjinit, me parathënie të Gjergj Fishtës, Shkodër, 1993

¹⁰⁶ Neni 167, Frano Ilia, Kanuni i Skënderbegut, Shkodër, 1993

kishte ndonjë pengesë. Në rast si i gjithë fshati përkiste të njëjtës çetë, atëherë ndalohehin edhe brenda fshatit.¹⁰⁷

Duhet thekësuar gjinia si pengesë absolute martesore paraqitet krejtësisht për shkakë oportuniteti: si për arsye morali, psikologjike (shoqërore), ashtu edhe për arsye eugjenike (biologjike). Ky përcaktim gjithashtu ka një ndikim në mjekësi që konfirmon se për fëmijët e lindur në martesë, ku bashkëshortët janë në lidhje gjaku, ekziston një rrezik i madh që këta fëmijë të lindin me çrregullime të rënda psikologjike dhe fizike

si dhe rreziku i transmetimit të të ashtuquajturave sëmundje të trashëguara.¹⁰⁸ Me këtë rast gjithësesi duhet të kihen parasysh edhe doket e zakonet e rrethit konkret. Kjo pengesë martesore është e natyrës së përhershme sepse edhe baza prej nga rrjedh është e përhershme. Pengesa është relative, sepse krijon efekte vetëm ndërmjet personave të caktuar (gjini), por jo edhe ndaj personave të tretë.¹⁰⁹ Në krahasim me gjininë e gjakut në një vijë të drejtë, dhe gjinia e gjakut në vijë të tërthortë kur përcaktohet rrethi i personave që nuk mund të martohen, në vende të ndryshme ka dallime të caktuara si rezultat i zakoneve, traditave të ndryshme për shkak të ndikimit të gjatë të fesë në këtë çështje. Pra, në ligjet e mëparshme të Kroacisë dhe Sllovenisë, shkalla e katërt e gjinisë së gjakut konsiderohet si pengesë martesore e larguar, në mënyrë që gjykata të mund të japë leje për të lidhur një martesë mes kushërinjve të parë, nëse ajo përputhej me perceptimet e popullit

dhe zakonet e tyre. Lidhur me gjininë e gjakut në vijën të tërthortë në shkallën e tretë, legjislacionet veprojnë në dy mënyra: disa nuk e konsiderojnë atë si një pengesë martesore (në ish-Bashkimin Sovjetik, ish Çekosllovakia, Gjermania Perëndimore), dhe disa këtë shkallë të gjinisë së gjakut është përfshirë në shqetësimet martesore për të cilat jepen disa përkufizime mundësitë për heqjen e tyre, siç është rasti në të drejtë angleze dhe franceze.¹¹⁰

¹⁰⁷ Elezi Ismet, Kanuni i Labërisë, Tiranë, 2006, fq. 97

¹⁰⁸ Spiroviq- Trpenovska Lilana, E drejta familjare, Shkup, 2004, fq. 92

¹⁰⁹ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 84

¹¹⁰ Georgiev Aleksandr, Bracni precki, Shkup, 2013, fq. 12

Duhet thekësuar se gjinia si lidhje gjaku krijohet midis personave që rrjedhin njëri prej tjetërit, ose prej një të paralindurit të përbashkët, si në bashkësi jashtëmartesore, ashtu edhe në bashkësi martesore. Mirëpo, kur është fjala për bashkësinë jashtëmartesore, vërtetimi i këtij fakti në praktikë paraqet problem në vete, sepse nëpunësi i gjendjes civile nuk mund të vërtetojë një rrethanë të tillë me aktlindje. Martesat e tilla me person në gjini, të cilat ligji i ndalon shprehimisht, nuk do të ndodhin ose mund të jenë tepër të ralla, konsiderojmë se ato janë të ndaluara dhe nga mjedisi ku jetojmë, sepse paraqitet rreziku potencial i lindjes së fëmijëve me të meta fizike e shpirtërore, gjë që është vërtetuar në mënyrë të padyshimtë nga të arriturat e shkencës së biologjisë.¹¹¹

b) Gjinia e krushqisë

Gjinia krushqisë në kuptimin juridik është lidhje që krijohet midis njërit bashkëshort dhe personave gjini të bashkëshortit tjetër. Bazë për krijimin e gjinisë së krushqisë (*affinitas*) është martesa. Ky fakt relevant juridik tregon se pa martesë nuk ka as gjini të krushqisë. Me rëndësi është të themi se krushqia llogaritet vetëm midis bashkëshortëve dhe gjinive të tyre përkatëse dhe jo midis anëtarëve të gjinive me njëri-tjetrin, të cilët gjithsesi quhen krushq me njëri-tjetrin.¹¹² Mirëpo gjinia e krushqisë, e krijuar një herë, nuk mund të pushojë edhe nëse ka pushuar martesa, në bazë të së cilës ajo ka lindur. Pra, gjinia e krushqisë është e përhershme. Matja e afërsisë së personave gjini të krushqisë bëhet sipas vijave dhe shkallëve, në atë mënyrë sikurse matja e afërsisë së gjinisë së gjakut. Prandaj, mund të thuhet se në cilën shkallë gjinie gjendet njëri bashkëshort me personat në gjini të vet të gjakut, po në atë shkallë krushqie ndodhet dhe bashkëshorti i tij. Nuk mund të lidhin martesë personat në krushqi: vjehrrri dhe reja, dhëndri dhe vjehrra, njerka dhe thjeshtri, njerku dhe thjeshtira, pa marrë parasysh faktin nëse ka pushuar martesa, lidhja e së cilës ka sjellë këtë marrëdhënie. Kjo dispozitë është e karakterit urdhërues.¹¹³

Krushqia, pra, krijohet vetëm midis gjinisë së njërit bashkëshort dhe bashkëshortit tjetër, por jo edhe midis gjinisë së njërit bashkëshort me gjininë e bashkëshortit tjetër. Nuk

¹¹¹ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 84

¹¹² Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 111

¹¹³ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 85

lidhen me asgjë nga pikëpamja ligjore gjinia e njërit bashkëshort me gjininë e bashkëshortit tjetër, megjithëse quhen në gjuhën e popullit krushqi midis tyre. Bazë për krijimin e gjinisë së krushqisë mund të jetë edhe bashkësia jashtëmartesore, nëse ajo është vërtetuar me vendimin gjyqësor apo është njohur vullnetarisht nga bashkëshortët. Një rëndësi të veçantë ka fakti nëse në atë bashkësi jashtëmartesore kanë lindur fëmijë. Në vënien e kësaj pengese ligjdhënësi është nisur nga konsiderata morale, nga detyrimi i bashkëshortëve për të ruajtur ndjenjat më të pastërta të miqësisë e të respektit ndaj personave të gjinis të bashkëshortit tjetër. Aq më shumë sepse gjinia e krushqisë nuk ka mbështetje në ndonjë lidhje gjaku.¹¹⁴

c) Gjinia e adoptimi

Gjinia e vendosur me birësim është pengesë për lidhjen e martesës së vlefshme. Gjinia e adoptimit (civile) nuk mbështetet në ndonjë lidhje gjaku, por në arsye të pastra morali, sepse marrëdhëniet midis adoptuesit dhe të adoptuarit duhet të zhvillohen të shëndosha, të sinqerta, identike me ato që zhvillohen mes prindërve dhe fëmijëve. Adoptimi mund të jetë i plotë dhe jo i plotë. Pasi gjinia e adoptimit njihet njëjt si gjinia e gjakut ajo ndalon martesën me:

- Ndalohet martesa midis adoptuesit dhe të adoptuarit dhe pasardhësve të tyre pa kufizime,

- ndalohet gjithashtu martesa midis të adoptuarit dhe bashkëshortit/bashkëshortes të adoptuesit, këtu është fjala për rastin kur adoptimi është bërë prej njërit nga bashkëshortët, por kjo nuk ndryshon qenien e të adoptuarit si bir i familjes, ashtu sikurse gjinia e gjakut që ndalon martesat midis të paralindurve dhe të paslindurve, pa kufizime,

- ndalohet martesa midis adoptuesit dhe bashkëshortit të të adoptuarit, për të njëjtën arsye si ndalohet martesa midis vjehrrit dhe nuses apo vjehrrës dhe dhëndërit,

- ndalohet martesa midis të adoptuarëve, fjala është për të adoptuarit prej të njëjtit adoptues, ashtu siç ndalohet martesa midis motrës dhe vëllait,

- ndalohet martesa midis të adoptuarit dhe fëmijëve të adoptuesit, sepse rasportet e krijuara ndërmjet tyre janë ligjërisht (dhe jo edhe natyrisht) si ato ndërmjet vëllezërve dhe

¹¹⁴ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 86

motrave. Sot gjithnjë e më shumë kemi raste ku çiftet pa fëmijë adoptojnë dhe ashtu sikurse pasojat janë të njëjta me ato midis prindërit natyror dhe fëmijës, edhe lidhjet e tjera do të respektohen në mënyrë të ngjajshme.

-ndalohet martesë midis personit të adoptuar dhe gjinisë së tij të origjinës.¹¹⁵

Pengesa ka të bëjë edhe me fëmijët e tyre deri në shkallë të katërt të vijës së tërthortë. Krejtësisht është e kuptueshme se gjinia e adoptimit nuk vendoset mbi bazë të rrethanave eugjenike, por me akt juridik. Prandaj, është e qartë se lidhjet e të adoptuarit me familjen e tij të origjinës, si lidhje biologjike, nuk zhduken, dhe pengesa martesore e caktuar me ligj, sikurse kur është fjala për gjini të gjakut, ekziston edhe më tej. Problemi shtrohet sepse fëmijët e adoptuar shpeshherë nuk i njohin prindërit e vërtetë, sepse kryesisht adoptohen fëmijët e braktisur si foshnja apo të paprindër. Adoptimi i plotë si pengesë martesore është i karakterit të përhershëm, i paevitueshëm dhe shkakton pavlefshmërinë absolute të martesës. Adoptimi i plotë nuk mund të shkëputet. Ndryshe nga adoptimi i plotë, adoptimi jo i plotë shkakton nulitetin relativ, por mund të jetë pengesë martesore e përkohshme dhe e evitueshme, sepse mund të shkëputet dhe adoptuesi dhe i adoptuari, për shkaqe të arsyeshme mund të lidhin martesë me leje të organit kompetent. Rrallësia e martesave të tilla është e kuptueshme, sepse adoptuesi shpesh bën më tepër për të adoptuarin se prindërit për fëmijën e vet.¹¹⁶

5. Mungesa e vullnetit

Vullneti është elementi i rëndësishëm i kushteve të martesës, ai është vet thelbi, që një martesë të jetë e vlefshme juridikisht, kërkohet që vullneti i deklaruar të përputhet me dëshirat e brendshme të bashkëshortit të ardhshëm. Vullneti i deklaruar lirisht është prezumim i vetëm për lidhjen e një martesë të vlefshme.¹¹⁷ Pra, ai e fiton rëndësinë e vet juridike kur të jetë i shprehur, kur të tjerët do të jenë në mundësi për ta kuptuar atë. Mungesa e pëlqimit të lirë, apo një pëlqim jo i plotë, e bën martesën të pavlefshme juridikisht. Një martesë e pavlefshme nuk sjell pasojë juridike për bashkëshortët dhe si rregull goditet për pavlefshmëri.¹¹⁸ Mungesa e

¹¹⁵ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 116

¹¹⁶ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 87

¹¹⁷ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 184

¹¹⁸ Mandro-Balili Arta, Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore, Tiranë, 2014, fq. 47

vullnetit të lirë ekziston atëherë kur vullneti i deklaruar nuk përputhet me vullnetin e vërtetë (të brendshëm). Shkak i kësaj mungese është deklarimi i vullnetit me dhunë, kanosje, mashtrim ose lajthim. Për të qenë një martesë e vlefshme nuk mjafton vetëm që pëlqimi të ekzistojë, por ai duhet të jetë pa të meta. Mungesa e vullnetit është cilësuar nga legjislacioni pozitiv si pengesë martesore, ekzistimi i së cilës ka si pasojë anulimin e martesës. Martesa nuk do të jetë e plotëfuqishme nëse pëlqimi është arritur përmes shtrëngimit, kërcënimit ose lajthimit, apo ndonjë mungesë tjetër të vullnetit të lirë nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm.¹¹⁹ Mungesa e vullnetit është pengesë martesore edhe në legjislacionet tjera. Sipas legjislacionit tonë kur vërtetohen mungesat e vullnetit në momentin e lidhjes së martesës, nëpunësi i gjendjes civile nuk do të lejojë lidhjen e martesës. Por, nuk janë të ralla rastet e verifikimit të një lloj ndryshimi midis vullnetit të brendshëm dhe atij të shfaqur. Kjo mund të ndodhë sepse deklarimi është bërë pa pëlqimin e subjektit. Veset janë defekte në formimin e vullnetit, kjo ndodh atëherë kur ndërhyjnë një element “turbullues” (si rezultat i pijeve alkoholike apo substancave psikotrope) që ka ndikuar në një vullnet të formuar jo-lirisht, jo-normalisht. Mund të ndodhë për shkak respektit, vlerësimit apo nderimit që detyron në mënyrë spontane të lidhë martesë me një person ndaj të cilit mungon vullneti por ndien një lloj detyrimi, apo persona të rëndësishëm kanë dhënë pëlqimin dhe duhet respektuar.¹²⁰ Nëse martesa është e lidhur pa u zbuluar mungesa e vullnetit, atëherë kjo është shkak për të kërkuar anulimin e martesës. Shkaqet që e bëjnë vullnetin me mungesa janë dhënia e deklaratës së vullnetit nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit, kanosjes dhe dhunës. Këto janë katër kategori të cilat ndikojnë në vullnetin e bashkëshortëve, ekzistimi i të cilave e bënë vullnetin me të meta.¹²¹

a) Dhuna

Me dhunë nënkuptojmë shtrëngimin e njërit bashkëshort apo të të dy bashkëshortëve për të lidhur martesë kundër vullnetit të tyre. Dhuna që ushtrohet për lidhjen e martesës, në kundërshtim me vullnetin e brendshëm, të vërtetë të bashkëshortit, mund të jetë e natyrës psikologjike edhe fizike. Ajo është kurdoherë sinonim i kërcënimit, dhe kufizohet vetëm në

¹¹⁹ Neni 19, Ligji për familjen, (Gazeta zyrtare e RM’së), nr: 80/1992

¹²⁰ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 185

¹²¹ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 98

paralajmërimet frikësuese serioze, që kërcënuesi ia drejton personit të caktuar, se ndaj tij do të ushtrohet së shpejti dhunë fizike ose do të shkaktohet një e keqe tjetër po qe si ai nuk do të lidhë martesë me personin e caktuar.¹²² Në këtë rast bashkëshorti i ardhshëm e ka deklaruar vullnetin e tij për të lidhur martesë edhe pse është i vetëdijshëm se nuk dëshiron të lidhë martesë, mirëpo nën ndikimin e dhunës e jep deklaratën e pajtimit. Dhuna është shkalla më e lartë që ndikon në mungesën e vullnetit për të lidhur martesë. Dhuna mund të jetë psikike, fizike (trupore) seksuale dhe ekonomike.¹²³ Dhuna është një veprim i drejtpërdrejtë i shtrëngimit. Dhuna duhet të jetë serioze. Me dhunë serioze nënkuptojmë formën e manifestimit të dhunës e cila me të vërtetë ndikon në dhënien e deklaratës së pajtimit kundër vullnetit të bashkëshortit të ardhshëm. Nëse dhuna nuk është e intenzitetit serioz nuk mund të merrët si shkak për mungesë të vullnetit. Gjithashtu dhuna si veprim ndaj individit është edhe e kundërligjshme. Kur martesa është e lidhur nën ndikimin e dhunës, sjell pavlefshmërinë e martesës dhe është shkak për të kërkuar anulimin e saj.¹²⁴ Dhuna fizike dallon nga dhuna psikologjike, ngase te dhuna fizike kanosja fillon të ekzekutohet, vjen deri te realizimi i saj. Rastet më tipike janë mbajtja me forcë me rastin e firmosjes së deklaratës. Këtu nuk mund të flitet për vullnetin e personit që firmos, por vetëm të atij që e ushtron dhunën. Duke pasur parasysh mënyrën e lidhjes solemne dhe publike të martesës, prezencën e dy dëshmitarëve dhe të nënpunësit të gjendjes civile, tash për tash mund të ndodhë një dhunë e tillë vetëm në raste tepër të ralla, si mundësi teorike. Por, nuk mund të thuhet se dhuna është çrrënjësor plotësisht. Dhuna fizike shfaqet ende aty-këtu dhe vazhdon të jetë e pranishme si masë detyrimi për lidhjen e martesës, si: rrahja, plagosja, rrëmbimi etj., megjithëse rastet e tilla janë gjithnjë më të pakta. Në rrethanat e reja të krijuara me ndërtimin e shoqërisë demokratike e të shtetit ligjor, për dhunën fizike më tepër mund të flitet si relik i së kaluarës, kur prindërit ushtronin dhunë mbi vajzat e veta për lidhjen e martesës, në kundërshtim me vullnetin e vërtetë të tyre. Tani dhuna është e mundur vetëm në veprimet që i paraprijnë lidhjes së martesës. Në hipotezën se paraprakisht është ushtruar dhunë fizike ndaj bashkëshortit të ardhshëm (p.sh duke e rrahur

¹²² Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 72

¹²³ Neni 4, alineja 5,6,8,9. Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, (Gazeta zyrtare e RM,së). Nr:9/2008.

¹²⁴ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 103

disa herë, lidhur, plagosur lehtë etj.,) kjo martesë do të quhej absolute e pavlefshme. Martesa do të anulohet nëse bashkëshorti ka dhënë pëlqimin nën ndikimin e frikës, dhunës ose kanosjes serioze.¹²⁵

Në rast se vajzat apo gratë e reja kundërshtojnë, që të lidhin martesën e përcaktuar të tyre, atëherë ato shpesh hasin në kundërshtim nga ana e familjes së tyre përmes sharjeve dhe kërcënimeve për rrahje, dhe arrijnë deri në kërcënim për vrasje në emër të nderit. Pas martesës pritet, që vajzat dhe gratë ti binden bashkëshortit dhe eventualisht edhe familjes së tij. Në rast se ajo si bashkëshorte nuk plotëson detyrat e veta, atëherë në raste ekstreme mund të shkohet edhe deri në keqtrajtime fizike dhe psigjike të saj, si psh. kërcënime apo rrahje. Përveç kësaj nga ajo kërkohet, që ti qëndrojë në dispozicion burrit. Tmerri i vazhdueshëm i përdhunimit është për vajzat dhe gratë një nga pasojat më të këqia të martesës së detyruar. Si pasojë e martesës së detyruar mund të krijohen depresionet, lëndimet e shkaktuara vetë, vetëvrasja dhe sëmundje shqetësuese trupore kronike psigjike.¹²⁶ Viktimë të kësaj dhunë janë si femrat edhe meshkujt që detyrohen të martohen për shkaqe se u ka kaluar koha e martesës, nga shkaqet ekonomike detyrohen të martohen me persona të panjohur për të marrë nënshtetësi të ndonjë shteti, ka prindër që jetojnë në mërgim dhe udhëtojnë në vendlindje bashkë me fëmijët e tyre të rritur dhe i martojnë ose i fejojnë me persona nga origjina e tyre pa dëshirë, prindër që detyrojnë fëmijët të martohen shkak i ndonjë borxhi apo mirësie, martesa të detyrueshme shkak i pasurisë, etj. Jo çdo here këto martesa të detyruara me dhunë janë anuluar, ka ndodhur që edhe të jenë realizuar duke jetuar si viktime përgjithmonë.

Në diskutimet publike ka tendenca, që martesën e detyruar t'ia rendisin shoqërive të caktuara fetare. Përkundrazi shkaqe për martesat e detyruara janë strukturat patriarkale të trashëguara, traditat dhe zakonet, por jo besimi fetar në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Asnjëra nga besimet fetare botërore si budizmi, kristianizmi, besimi hebrej, hinduizmi apo islamizmi, nuk përcakton martesën e detyruar.¹²⁷

¹²⁵ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq.79

¹²⁶ www.zwangsheirat-nrw.de/mbi-martesen-e-detyruar/ publikim, fq. 1

¹²⁷ Po aty, fq. 2

b) Kanosja

Me kanosje kuptohet vetëm ushtrimi i dhunës psikologjike dhe jo edhe i dhunës fizike. Ajo është kurdoherë sinonim i kërcënimit dhe kufizohet vetëm në paralajmërimet frikësuese serioze, që kërcënuesi ia drejton personit të caktuar, se ndaj tij do të ushtrohet së shpejti dhunë fizike ose do të shkaktohet një e keqe tjetër po që se ai nuk do të lidhë martesë me personin e caktuar. Kanosja duhet të jetë aq serioze sa personi i kanosur, edhe pse nuk e dëshiron lidhjen e martesës, asaj nuk mund t'i shmanget, për shkak të manifestimit të frikës së madhe. Kanosja serioze mund të shkaktohet si nga i fejuari, i cili do të lidhte martesë me personin e kërcënuar, ashtu edhe nga ndonjë person tjetër i familjes ose një tjetër i afërt i tij. Kanosja duhet të jetë e tillë që personi i kanosur të krijojë bindjen se ajo do të realizohet. Kanosja duhet të jetë e mundshme dhe e kundërligjshme. Mund të thuhet se serioziteti i kanosjes vlerësohet në bazë të peshës dhe rëndësisë së vlerave të rrezikuara. Në të shumtën e rasteve ato janë nderi, jeta, integriteti trupor, pasuria, etj. Frika është elementi i dytë i dhunës psikologjike, është formë e reagimit subjektiv të personit të kanosur seriozisht. Nga frika se personi i kanosur do ta rrëmbejë apo do ta plagosë, ose do t'ia çënojë nderin, tek personi ndaj të cilit ushtrohet kanosja krijohet ndjenja se nuk mund t'i shmanget të keqes së paralajmëruar. Prandaj lidh martesë pa vullnetin e tij, dhe vazhdon të sillet ashtu si e kërkon personi që i është kanosur. Si, rrjedhojë, një martesë është lidhur me kanosje në qoftë se lidhja e saj është rezultat i kanosjes. Ndryshe, personi i kërcënuar, po të kishte mundësi për t'iu shmangur kanosjes dhe për të shprehur vullnetin e tij të lirë, as që do t'i shkonte mendja për të lidhur një martesë të tillë.¹²⁸ Kjo do të thotë që nuk përputhet vullneti i brendshëm dhe ai i jashtëm për shkak të presionit. Kanosja është mjet për arritjen e qëllimit, që është ai i lidhjes së martesës. Në rastin e frikës bëhet fjalë për kërcënime intensive të drejtuara për nga shtrëngimi për martesë, në rastin e dhunës, zgjedhja e një zgjidhjeje të tillë, siç është ajo e lidhjes së martesës, i paraqitet subjektivit, si e keqja më e vogël në krahasim me atë që mund t'i paraqitet atij nëse nuk e lidh ose nuk e pranon këtë martesë. Të tilla janë ato situata të kërcënimit për ushtrimin e dhunës familjare dhe që, për të shpëtuar të tjerët, subjekti detyrohet të pranojë martesën.¹²⁹ Martesa me

¹²⁸ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 78

¹²⁹ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 187

grabitje, pra djali e kërcënon vjazën që të martohet me të, që mos të pësoj familja, apo djali i dashuruar ndaj vajzës që ajo se don po me anë të ndonjë kërcënimi e merr dhe vajza heshtë, pajtohet me fatin veç mos të krijoj armiqësi mes familjeve. Kemi raste kur vajza fejohej shkak i gjakmarrjes, që të paguhet çmimi i gjakut jepet vajza për nuse, pa vullnetin e vajzës me frikë që mos të ketë vrasje më në familje. Raste që pak a shumë janë zbutur, por përsëri egzistojnë posaçërisht në vendet rurale, vendet që zbatojnë rregullat e paraardhësve.

c) Lajthimi

Lajthimi ekziston kur njëri bashkëshort ka pasur mendim të gabueshëm mbi rrethanat, faktet dhe mbi cilësitë thelbësore të bashkëshortit tjetër në momentin e lidhjes së martesës, ekzistenca e të cilave jetesën e përbashkët e bëjnë të padurueshme. Ato tani dalin që janë të një intensiteti të lartë, ashtu që po t'i kishte ditur bashkëshorti tjetër nuk do ta lidhte martesën dhe nuk do ta deklaronte vullnetin përpara organit kompetent. Me fjalë të tjera, këtu kemi të bëjmë me shpërputhje të vullnetit të vërtetë me atë të deklaruar, për shkak të mosdijes për rrethanat dhe kushtet thelbësore, që jetesën e përbashkët e bëjnë të padurueshme.

Rrethanat dhe kushtet e tilla i fsheh dhe nuk i tregon botërisht bashkëshortit tjetër. Mosdija e tillë e veçon lajthimin nga dhuna, sepse kur është fjala për ekzistimin e shpërputhjes së vullnetit, bashkëshorti ka qenë i vetëdijshëm për ekzistimin e rrethanave apo kushteve thelbësore, të cilat jetesën e përbashkët e bëjnë të padurueshme.¹³⁰ Por, për shkak të dhunës që është ushtruar mbi të, ai ka qenë i detyruar për ta lidhur një martesë të tillë. Lajthimi mund të jetë:

- a) Lajthimi për personin fizik
- b) Lajthimi për personin qytetar
- c) Lajthimi për cilësitë thelbësore

a) Lajthimi për personin fizik

Ky lloj lajthimi ekziston kur krijohet parafytyrimi (bindja) e gabuar me të cilin lidhet martesa. Lajthimi për personin fizik ekziston kur njëri nga bashkëshortët, duke menduar se po

¹³⁰ Podvorci Hamdi, E drejta famljare, Prishtinë, 2005, fq .79

lidhte martesë me personin A, në të vërtetë ai gabimisht lidh martesë me personin B. Tani raste të tilla të lajthimit janë të ralla, por ende të mundshme, posaçërisht kur është fjala për lidhje të martesës me anë të përfaqësuesit pa prezencën e dy bashkëshortëve të ardhshëm. Madje në praktikën tonë fejesat janë lidhur përmes personave të tretë (shkuesit). Ndërsa për shkak të emancipimit jo të mjaftueshëm, fejesa e tillë ka rezultuar dhe me martesë.¹³¹ Por, lajthime të tilla kanë qenë fort të mundishme edhe tek ne, kur shikuesi ka ndërmjetësuar fejesën, ashtu që në vend të vajzës së re e të bukur, që me rastin e fejesës e kishte parë ndokush nga familja e të fejuarit, është martuar me vajzë më të moshuar e më pak të bukur, e cila nuk është parë fare nga familja e të fejuarit. Edhe tani është e mundshme një gjë e tillë, në raste kur pa u parë ose pa u njohur fare dy persona fejohen dhe martohen, e kjo ndodh rëndom në treva në të cilat ende nuk janë çrrënjësuar plotësisht zakonet e lashta dhe prapanike.¹³² Megjithatë për shkak të lidhjes së martesave me shtetas të huaj ose qytetar që jetojnë jashtë vendit mund të gjinden lajthitje të tilla në personin fizik, përshkak të prenzantimeve të rrejshme ose krijimit të paraftyprimeve të gabuara.¹³³ Kemi raste kur personat njihen nëpërmjet internetit (nëpërmjet faqeve sociale) dhe ato vendosin të lidhin martesë, mirëpo pastaj kuptojnë se personat e paraqitur në internet janë krejt ndryshe me atë që shohin përpara. Duke lajthitur nëpërmjet fotografive me pamje krejtësisht tjetër, me anë të fotografive të përpunuara me fotoshop, nga ajo realja.

b) Lajthimi për personin qytetar

Ky lajthim ekziston kur një person lidh martesë me një person tjetër fizik, me të cilin s'ka menduar dhe s'ka pasur për qëllim që të martohet. Por, kjo ka ndodhur ngase ai person i ka paraqitur rrejshëm atributet e qytetarit, jo ato të vërtetat, ndërsa bashkëshorti tjetër nuk ka qenë fare në dijeni për këtë; po t'i kishte ditur ato, nuk do të lidhte martesën. Personi qytetar përbëhet nga katër elemente themelore:

- 1) Emri personal (emri dhe mbiemri)
- 2) Shënimi i ditës, muajit dhe i vitit të lindjes

¹³¹ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 99

¹³² Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 80

¹³³ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 99

- 3) Shtetësia, e cila shihet nga shënimi i vendit, komunës dhe i shtetit të lindjes, dhe
- 4) Vendbanimi.

Në attribute të qytetarit përfshihet gjendja pasurore dhe profesioni, për shkak se ato nuk radhiten në atributet kryesore dhe nuk janë shkak për anulimin e martesës. Paraqitja e rrejshme bëhet duke falsifikuar dokumentet e identifikimit, si letërnjoftimin, pasaportën apo aktlindjen e vet, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, duke u prezantuar me dokumente të huaja, të vjedhura apo të keqpërdorura, veçanërisht të personaliteteve të shquara që kanë krijuar emër në shkencë, art, film, sport apo në ndonjë fushë tjetër të rëndësishme shoqërore.¹³⁴ Këto raste më shumë i hasim tek martesa me personat e vendeve të ndryshme, pra martesa e një shtetasi tjetër me një shtetas të një shteti tjetër, pra që nuk njihen që më herët apo personat që kanë një të kaluar të errët dhe duan të kenë një jetë të re duke falsifikuar identitetin e tyre.

c) Lajthimi për cilësitë thelbësore të personit

Lajthimi për cilësitë thelbësore të personit ekziston nëse njëri nga bashkëshortët është në lajthitje (ka mendim të gabuar) mbi disa cilësi të personit tjetër, të cilat po t'i ishin të njohura në çastin e lidhjes së martesës, gjithësesi që do të ndikonin në të dhe ai nuk do ta lidhte martesën.

Me mosnjohjen e tyre nga ana e bashkëshortit tjetër në çastin e lidhjes së martesës, por që janë të tilla që po të diheshin paraprakisht, nuk do të çonin në lidhjen e martesës prej tij. Pra, padijenja e këtyre cilësive ka bërë që ky bashkëshort të japë pëlqimin për martesa. Të tilla cilësi mund të jenë: një sëmundje fizike ose psikike, një e metë morale, një anomali ose një devijim seksual, të tilla që pengojnë jetën e bashkëshortore, etj. Vlerësimi i këtyre gabimeve varet shumë nga ndikimi që ato ushtrojnë në çastin e zbulimit dhe në pasojat që do të shkaktojnë në jetën e ardhshme bashkëshortore. Elemente të pandashme për këtë lloj lajthitjeje janë:

¹³⁴ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 80

- Sëmundja, e meta, defekti ka ekzistuar shumë më përpara sesa lidhja e martesës, sepse nëse kjo sëmundje ose e metë shfaqet më pas, nuk është shkak për pavlefshmëri, por për zgjidhje të martesës
- Që kjo nuk është ditur absolutisht ose nuk është ditur me saktësi.¹³⁵

Jo të gjitha sëmundjet sjellin si pasojë pavlefshmërinë e martesës për shkak të lajthimit në cilësitë thelbësore. Këtu është fjala për ato situata që i sjellin një kërcënim ose rrezik të madh familjes që krijohet përmes martesës. Të tilla mund të jenë psikopatitë ose sëmundjet infektive, që vlerësohen si tepër të neveritshme që nuk pranohen nga arsyeja, që janë të pashërueshme. Për sa u përket anomalive seksuale, të tilla mund të jenë impotenca e pashërueshme, transeksualizmi. Pasi teknikat e riprodhimit artificial mund të mbulojnë defektin e pakthyeshëm që vjen si rrjedhojë e impotencës, por përsëri ngel si një lajthim.

Ndër cilësitë thelbësore mund të hyjnë edhe dënimi i mëparshëm me heqje lirie i personit, qenia e tij delikuent, sjelljet kriminale, prostitucioni i ushtruar më parë, mungesa e cilësive të rëndësishme morale, pasja e fëmijëve jashtëmartese dhe veprimtari të tjera, të cilat nuk dihen nga bashkëshorti tjetër në kohën e lidhjes së martesës. Për sa i përket çështjes së veprës penale të kryer para martesës, këtu duhet të dallojmë disa momente, kur personi ka vuajtur dënim ose kur për të ka pasur një vendim të formës së prerë që e dënon atë, por ai i është fshehur ekzekutimit të vendimit, kur personi është i dyshuar, çështja është në gjykim, por nuk ka një vendim të formës së prerë, kur akuza ndaj personit vërtetohet dhe ky dënohet me vendim të formës së prerë pas lidhjes së martesës.¹³⁶

Një rast lajthitjeje i rëndomtë është edhe ai që lidhet me shtatëzanin e gruas, shkaktuar nga një person tjetër, në rastin e lajthitjes së burrit si bashkëshort ka qenë një burrë tjetër që e ka shkaktuar shtatëzaninë e gruas bashkëshorte të ardhshme, në rastin e lajthitjes së gruas, pretendenti për bashkëshort i ardhshëm ka lënë shtatzënë një grua tjetër ose ka fëmijë jashtë martese, të cilin e ka mohuar ose nuk e ka treguar kurrë përpara aktit të celebrimit të martesës. Në këtë rast burri kërkon pavlefshmërinë e martesës dhe mosnjohjen e fëmijës si bir ose bijë të tij. Kjo është e natyrshme. Nuk mund të kërkojë pavlefshmërinë e martesës dhe të

¹³⁵ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 189

¹³⁶ Po aty, fq.189

pranosh njohjen e atësisë mbi një fëmijë që nuk është i yti. Kjo mund të ndodhë edhe kur fëmija lind para lidhjes së martesës, por burri zbulon se nuk ka qenë babai i fëmijës pas celebrimit të saj.¹³⁷ Megjithëkëtë, në secilin rast konkret, nëse vendos për pavlefshmërinë e një martese, gjykata duhet të vërtetojë:

- 1) nëse lajthimi ka ekzistuar në çastin e lidhjes së martesës,
- 2) se ka qenë i një natyre të tillë që po ta kishte ditur bashkëshorti tjetër nuk do të lidhte martesa,
- 3) se lajthimi është i një natyre të tillë që jetesën bashkëshortore e bën të padurueshme.¹³⁸

Të drejtën për të parashtruar padi për anulimin e martesës e kanë bashkëshortët, prokurori publik dhe personat e tjerë të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë për anulimin e martesës. Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës vetëm për bashkëshortin e lajthitur, dhe atë në afat prej 6 muajsh nga marrja vesh për lajthim dhe më së voni në afat prej 3 vitesh. Lajthimi mbi cilësitë themelore të bashkëshortit është i një rëndësie të veçantë dhe është paraparë si fakt për anulimin e martesës.¹³⁹

d) Mashtrimi

Mashtrimi është krijimi me qëllim i fakteve dhe rrethanave të pavërteta nën ndikimin e të cilave një person lidh martesë. Mashtrimi është shkaktimi i vetëdijshëm i lajthimit të personat që dëshirojnë të lidhin martesë. Mashtrimi mund të jetë një veprim aktiv i palës ose fshehje e ndonjë rrethane. E rëndësishme është që veprimi mashtrues është i vetëdijshëm për mashtruesin, ndërsa personi i mashtruar nuk e di, dhe as që ka mundur ta di se është i mashtruar. Shembull: personi A me qëllim i ofron personit B dokumente të rrejshme për moshën, shtetësinë, vendbanimin, gjendjen shëndetësore etj. Personi B nën ndikimin e rrethanave të këtilla, përkatësisht mashtrimit lidhë martesë. Sikur mos të krijoheshin rrethanat mashtruese, personi B nuk do të lidhë martesë. Në këtë rast nuk ka përputhje në mes vullnetit të shprehur dhe vullnetit të vërtetë. Martesa e lidhur me mashtrim të paramenduar për faktet

¹³⁷ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 190

¹³⁸ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 81

¹³⁹ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 100

të cilat po të njiheshin me kohë do ta ndalonin bashkëshortin tjetër ta lidhë këtë martesë dhe që tani e bëjnë jetën e përbashkët të padurueshme do të anulohet. Mashtrimi është një veprim i cili mund të shkaktohet si nga vetë bashkëshortët që dëshirojnë të lidhin martesë ashtu edhe nga person të tjerë. Mashtrimi në vete përmban dy elemente a) elementin objektiv; b) elementin subjektiv. Elementi objektiv është krijimi i rrethanës ose fakteve të pavërteta. Ndërsa elementin subjektiv është qëllimi (dashja), përkatësisht veprimi i vetëdijshëm për të krijuar rrethana dhe fakte të pavërteta. Mashtrimi duhet të jetë i kundërligjshëm, i mundshëm dhe serioz. Mashtrimi duhet të jetë serioz ashtu që personi i vendosur nën mashtrim nuk është në gjendje të kuptojë veprimin mashtrues. Veprimi i tillë mashtrues duhet të ketë për pasojë shtyrjen e personit të mashtruar për të lidhur martesë, çka do të thotë se duhet të ekzistojë lidhja si shkak (mashtrimi) dhe si pasojë (lidhja e martesës). Mashtrimi është një shkak që ndikon në mungesën e vullnetit. Vullneti i deklaruar nuk përputhet me vullnetin e vërtetë. Martesa e lidhur me mashtrim është e pavlefshme dhe mund të kërkohej anulimi. Sikur të lajthimi edhe mashtrimi mund të ekzistojë në; person fizik, personin qytetar dhe në cilësitë thelbësore të personit.¹⁴⁰

2. Pengesat martesore sipas te drejtës Islame

Ajo që është detyrimore sipas Islamit, pavarësisht nga lloji i dispozitës së martesës, është fakti se kontrata e martesës mes dy palëve, për të qenë e shëndoshë, e vlefshme është kusht që të mos ekzistojë ndonjë pengesë juridike që pengon lidhjen e kontratës së martesës. Ashtu siç garanton legjislacioni familjar i Republikës së Maqedonisë që martesë të lidhet me vullnet të plotë nga bashkëshortët me gjini të kundërt në formë të caktuar, të njëjtën gjë e garanton edhe legjislacioni familjar në Islam, pra vërejmë se legjislacioni ynë dhe legjislacioni Islam gjithashtu parashohin pengesat e njëjta për martesë, përveç një kategorie të veçantë që e ka legjislacioni Islam. Nuk lejohet të detyrohet burri të martohet me atë që nuk e do. Gjithashtu, nuk lejohet të detyrohet femra që të martohet me atë që nuk e do. Liria e palëve nënkupton lirinë e plotë pa ndonjë kufizim eventual për të hyrë në kontratë martesore për mashkullin ashtu edhe për femrën. Disa prej parakushteve janë si p.sh. që palët të mos jenë

¹⁴⁰ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 103

eventualisht në kurorë, të gjenden në liri, të mos jenë në burg, internim, të zënë rob. Gruaja poshtu duhet të jetë e lirë dhe të mos jetë në periudhë kohore të pritjes martesore. Shëndeti psiik dhe mendor nënkupton që kandidatët për martesë duhet të jenë psiikisht të aftë dhe të kenë shëndet me rastin e lidhjes së kontratës martesore. Palët që eventualisht kanë qenë psiikisht të sëmurë apo kanë vuajtur nga ndonjë traumë apo çrregullim mendor, por pas terapisë së përdorur janë shëruar, mund të lidhin martesën pas shërimit pa kurrfarë kufizimi eventual. Mosha madhore nënkupton që palët mund të lidhin martesë në moshën e rritur, dmth. të mos jenë të mitur. Sipas së drejtës Islame (shariatit) mosha madhore për të lidhur kurorë martesore është 15 vjet.¹⁴¹

2.1 Llojet e pengesave martesore

Juristët islamë, kur i diskutuan këto kushte në detaje, konstatuan se pengesat e kurorëzimit sipas legjislacionit Islam janë dy lloje, që janë:

- a) Pengesa të përhershme, që nënkupton se me ekzistimin e këtyre pengesave, apo njëres prej tyre, kontrata e martesës është e ndaluar përgjithmonë mes këtyre dy palëve
- b) Pengesa të përkohshme, të cilat mund të evitohen në momente të caktuara, dhe pas evitimit të lejohet kontrata e martesës mes dy palëve.¹⁴²

a) Pengesat martesore të përhershme janë gjithsej tri lloje:

- 1. lidhje gjaku (neseb),
- 2. lidhje e qumështit (red'a)
- 3. lidhje krushqie (sihrijet)¹⁴³

Të gjitha këto kufizime të martesës janë të parapara sipas ajeteve Kur'anore dhe si të tilla janë të përhershme dhe vlejné për të gjitha kohërat, pa marrë parasysh rrethanat e ndryshme shoqërore, periudhat e caktuara kohore apo kushtet jetësore. Kufizimet apo

¹⁴¹ Miftari Faik, Martesa sipas drejtës Islame, publikim, 2014, fq.5

¹⁴² Zimeri Jusuf, Martesa me të afërmen-min, nxitje e panevojshme, publikim, 2013, fq. 2

¹⁴³ Džananović Ibrahim, Islamsko bratno pravo, Sarajevo, 1985, fq. 6

pengesat e martesës me persona të caktuar të gjinisë femërore me të cilët janë të parapara ndalesat e përhershme apo edhe të përkohshme janë të parapara në ajetet e sures Nisa.

Gratë e ndaluara përjetësisht janë ato me të cilat mashkulli nuk mund të martohet kurrë. Ndalesa e përhershme mund të jetë si pasojë e lidhjeve të gjakut, krushqisë apo mëndeshës (ajo e cila e ka ushqyer me gji). Allahu i Mashërishëm i përmend gratë me të cilat burri e ka të ndaluar martesën përherë në ajetin vijues: “Mos u martoni me ato gra me të cilat qenë të martuar prindërit tuaj, me përjashtim të asaj që ka kaluar (para islamizmit) pse ajo ishte turpësi, përbuzje e traditë e shëmtuar.”¹⁴⁴ “ U janë ndaluar juve (të martohemi me): nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezeta tuaja, bijat e motrës, nënat tuaja që ju kanë dhënë gji, motrat nga gjiri, nënat e grave tuaja (vjehrrat) dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt, e nëse nuk kenë pasur kontakt me to (me gratë), atëherë s’ka pengesë (të martoheni me ato vajza) dhe (janë të ndaluara) gratë e bijave tuaj që janë të lindjes suaj (jo të bijve të adoptuar), dhe të bashkoni (përnjëherë në një nikah) dy motra, përpos asaj që ka kaluar. Vërtetë, Allahu falë shumë, është mëshirues i madh.”¹⁴⁵

Nuk u lejohej të martoheni edhe me gra të martuara (që kanë burrat e nuk janë të lëshuara), përveç atyre që i keni futur në pushtetin tuaj (robëreshat e luftës). Ky është obligim mbi ju nga Allahu. U janë lejuar, pos këtyre (që u përmendën), të tjerat që t’i merrni me pasurinë tuaj (me nikah) duke pasur për qëllim bashkëshortësi e jo prostitucion. E për atë që përjetuat ju nga ato (gratë me të cilat patët kurorë), jepni shpërblimin e tyre të caktuar se është obligim. E nuk ka pengesë për ju, pas përcaktimit (te nikahut), në atë që ju pëlqeni mes vete. Allahu është i gjithëdijshtë, i urti.¹⁴⁶ Ashtu siç ndaloi amoralitetin dhe atë që shpie në kurvëri, Islami ndaloi edhe perversionin seksual që njihet me emrin "homoseksualizëm". Ky akt përveç

¹⁴⁴ Sureja Nisa, Ajeti 22, Nahi, I Hasan, Kur’ani i madhërishëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe, Tiranë, 2010, fq. 113

¹⁴⁵ Po aty, Sureja Nisa, Ajeti 23, fq. 113

¹⁴⁶ Po aty, Sureja Nisa, Ajeti 24, fq. 114

se kundërshton rendin natyror, korrupton seksualitetin e njeriut dhe konsiderohet krim kundër të drejtave të femrave.¹⁴⁷

1. Pengesat martesore në lidhje gjaku

Martesa e ndaluar, për shkak të farefisnisë. Muslimanit pra nuk i lejohet të martohet me paraardhësit e tij (gjyshërit) sado të largët qofshin, por as edhe me pasardhësit (nipër dhe mbesa) sado të largët qofshin, pa mos caktuar shkallë të gjinis së gjakut. Kjo, për shkak se ngjashmëritë e kodeve gjenetikë tek secili, shkaktojnë sëmundje të trashëgueshme. Sot, shkencëtarët e gjenetikës, kanë zbuluar mbi tre mijë sëmundje të trashëgueshme. Disa prej tyre janë të tilla që pengojnë funksionimin normal të trurit, shqisave etj. Duke u bazuar në autorët e librave të drejtës Islame, te medh'hebit hanefi, pengesa e martesës si ndalim i përhershëm për shkak të afërsisë së gjakut përfshin një numër të madh kategorish. Të gjitha femrat e vijës vertikale të farefisnisë së të fejuarit i ndalohet, sikur nëna e tij, nëna e nënës së tij, ose nëna e babait të tij në vijën vertikale. Dhe të gjitha femrat e vijës zbritëse siç janë, për shembull vajza e tij, vajzat e fëmijëve të tij etj. Gjithashtu është ndaluar pasardhësit e prindërve të tijë pavarësisht brezit do të thotë motrat e tij, për nga babai apo nëna dhe vajzat e vëllezërve të tijë dhe të motrave dhe të vajzave e fëmijëve të vëllezërve dhe motrave. I ndalohen edhe pasardhësit direkt të gjyshërve dhe gjysheve të tyre, ndërsa ato janë tezet nga nëna apo babai por i lejohet gjenerata e dytë e pasardhësve të tyre.¹⁴⁸ Nga ajo që thamë më herët, mund të konkludojmë se gratë të cilat janë ndaluar për një burrë për shkak të lidhjes të gjakut janë shtatë llojëshe:

1. Nënata e tij (përfshirë këtu gjyshet e tij nga ana e babait dhe nënës dhe më lartë)
2. Bijat dhe mbesat e tij (dhe më poshtë)
3. Motrat e tij (tamam motra dhe motra vetëm nga babai apo vetëm nga e ëma)
4. Hallat e tij (përfshirë hallat e babit, nënës, gjyshërve dhe më tej)
5. Tezet e tij (përfshirë tezet e babait, nënës, gjyshërve dhe më tej)
6. Bijat dhe mbesat e vëllezërve (vëllezërve të plotë dhe gjysmë vëllezërve (vëllezërve vetëm nga nëna apo nga babet dhe më tej)

¹⁴⁷ El-Karadavi Jusuf, Hallalli dhe harami në Islam, Shkup, 2002, fq. 232

¹⁴⁸ Gashi Drilon, Martesa me vajzën e xhaxhait, hallës, dajës dhe tezes, publikim, fq. 3

7. Vajzat dhe mbesat e motrës së tij (dhe gjysmë motrave dhe më tej)¹⁴⁹

5. Pengesat martesore në lidhje krushqie

Sipas lidhjes së krushqisë martesë është e ndaluar me nënën e gruas (vjehrrën), me vajzën e gruas nga burri tjetër që ka qenë më parë e martuar, me gratë e djemve (nuset), si dhe bashkëshorti martesor njëkohësisht së bashku dy motrat, por me rastin e vdekjes së një motre, nuk është e ndaluar bashkëshorti martesor me motrën e saj, që në traditën tonë ka qenë e përhapur, edhe sot e kësaj dite ka raste që veprohet pa kurrfarë pasoje, martesë me balldëzen (baxhanakeshën), pas vdekjes eventuale të gruas.¹⁵⁰ Gratë të cilat janë përgjithmonë të ndaluara për një burrë për shkak të lidhjeve martesore janë katër llojesh:

1. Bashkëshortet e baballarëve dhe gjyshërve të tij. Kjo ndalesë ndodh në momentin kur njeriu e bën aktin e kurorëzimit me ndonjë grua, gruaja e tij konsiderohet haram për bijtë e tij, bijtë e djemve, për djemtë e djemve të tyre, si dhe për bijtë e bijave të tyre e kështu me radhë, pa marrë parasysh a ka pasur marrëdhënie intime me të apo jo.
2. Bashkëshortet e djemve dhe nipërve të tij. Kjo ndalesë ndodh sapo të kurorëzohen burri e gruaja, gruaja e tij konsiderohet haram për babanë dhe gjyshërit e tij e kështu më radhë, qofshin gjyshërit nga ana e babait apo nënës. D.m.th. pas kryerjes së aktit të nikahut, edhe nëse nuk ka bërë marrëdhënie më të.
3. Nënën e bashkëshortes. Kjo ndalesë ndodh me kryerjen e aktit të kurorëzimit, nëna dhe gjyshet e saj konsiderohen të ndaluara, edhe nëse nuk ka pasur marrëdhënie intime më të, pa marrë parasysh se a janë gjyshet nga ana e babait apo nënës.
4. Vajzat dhe mbesat e atyre grave me të cilat ka pasur marrëdhënie seksuale. Këtu hyjnë vajzat e gruas dhe pasardhëset e tyre, mirëpo me kusht që të ketë marrëdhënie më nënën e tyre. Nëse ndodh shkurorëzimi para kryerjes së marrëdhënieve intime, atëherë vajzat e gruas dhe pasardhëset e tyre nuk janë të ndaluara, sepse All-Ilahu i lartësuar thotë: " dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja më të cilat patët kontakt (marrëdhënie intime), e nëse nuk keni pasur kontakt me

¹⁴⁹ Gjellaj Besim, Martesë (Nikahu), publikim (www.mbueroja.net/) fq. 7

¹⁵⁰ Po aty, fq. 5

to (me gratë), atëherë s'ka pengesë (të martoheni me ato vajza)"¹⁵¹ Pra, sapo të martohet burri më ndonjë grua dhe bën marrëdhënie më të, vajzat e saj, vajzat e bijve dhe bijave të saj e kështu më radhë konsiderohen haram për të, pa marrë parasysh a janë nga martesë më burrin e parë apo me të dytin. Nëse shkurorëzimi është bërë para marrëdhënieve intime, atëherë vajzat e gruas dhe pasardhëset e tyre nuk janë haram për të.¹⁵²

6. Pengesat martesore në lidhjet nga qumështi

Kur jemi të lidhja e qumështit do të sqarojë se çfarë nënkupton ndalimi i martesës sipas lidhjes së qumështit, pasi që kufizimi i martesës sipas lidhjes së gjakut dhe lidhjes së krushqisë është e njohur, ndërsa ndalimi sipas lidhjes së qumështit është më pak e njohur, pasi ky ndalim nuk ekziston në legjislacionin familjar të Republikës së Maqedonisë, por në shoqërinë tonë ka qenë prezente në kohët e kaluara, sot kjo dukuri shumë pak ose fare pak është e njohur. Më parë ka qenë traditë sidomos tek arabët, që foshnja të merr gji përveç nënës edhe nga gratë tjera, për shkak të mungesës së qumështit të nënës së vet, apo për arsye tjera specifike, sëmundjes, varfërisë, gjithashtu edhe tek ne ka qenë e shprehur dhënia e gjirit prej mëndeshave për shkak të mungesës së qumështit të nënës, nëna ka qenë e detyruar që foshnjën ta ushqejë me qumështin e gjirit të grave tjera të përafërta apo më të largëta. Lidhja sipas qumështit ndodh ashtu që ndonjë grua tjetër, jep gji foshnjës, pas kësaj pason kufizimi apo ndalimi i martesës si pasojë e lidhjes së qumështit. Një grua që jep gji fëmijës tjetër, automatikisht fëmijët e saj shëndërrohen në vëllezër dhe motrat e foshnjës sipas lidhjes së qumështit, personi i cili lidh martesën me motrën e tij sipas lidhjes së qumështit, martesë e tillë është e pavlefshme sipas së drejtës Islame (shariatit). Sipas lidhjes së qumështit ndalohet martesë me nënën (gruan apo gratë që kanë dhënë gji) sipas qumështit, vajzat sipas qumështit, motrat sipas qumështit etj. Do të thotë ndalimi që vlen për martesat sipas lidhjes së gjakut gjithashtu vlen edhe sipas lidhjes së qumështit.¹⁵³

¹⁵¹ Sureja Nisa, Ajeti 23, Nahi, I Hasan, Kur'ani i madhërishtëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe, Tiranë, 2010, fq. 113

¹⁵² Gjellaj Besim, Martesë (Nikahu), publikim (www.mbueroja.net/) fq. 8,9

¹⁵³ Miftari Faik, Martesë sipas drejtës Islame, publikim, 2014, fq. 7

Qumështi i nënës e ushqen dhe e rrit foshnjën. Kur një grua i jep gji një foshnje, ai lidhet me të (gjdhënësen) në të njëjtën mënyrë sikur ta kishte lindur ajo. Gjdhënia ndalon në martesë atë që e ndalon afërsia familjare.¹⁵⁴ Ajetet kuranore cekin se “Vërtetë Allahu ua ka ndaluar martesat me ato që i keni nga gjiri, njësoj sikurse ua ka ndaluar me ato nga lindja (apo lidhja e gjakut)”. Megjithatë, që gjdhënia të rezultojë në lidhje të ndaluara, duhet t’i plotësojë kushtet vijuese:

1. Duhet të kryhen pesë e më shumë gjdhënie.
2. Foshnja duhet të jetë e uritur dhe të pijë derisa të ngopet në secilën thithje.¹⁵⁵
3. Të gjitha thithjet e ndaluara duhet të bëhen para se bebja të ndahet nga gjiri në moshën dy vjeçare.¹⁵⁶

Me “mëndeshë” (nënë nga gjiri) nënkuptojmë gruan e cila i jep një fëmijë në bazë të kushteve të sipërshënuara. Ndërsa “baba birësues” është ai njeri i cili vepron si prind dhe kujdestar për një fëmijë në vend të babait natyrorë të fëmijës, duke mos e adoptuar atë ligjërisht. Në tabelën vijuese, do t’i shënojmë tetë llojet e grave me të cilat një mashkull e ka të ndaluar martesën si pasojë e lidhjes nga gjiri:

	Lidhjet e birësuar	Numërohet si
1	mëndesha	nënë
2	Vajza e birësuar	bijë
3	E ëma e mëndeshës	Gjyshe-nga ana e së ëmës
4	E ëma e babit birësues	Gjyshe-nga ana e babit
5	Motrat e mëndeshës	teze
6	Motra e babit birësues	hallë
7	Mbesa e mëndeshës	mbesë
8	Motra e birësuar	motër

¹⁵⁴ Zimeri Jusuf, Martesa me të afërmen-min,nxjtje e panevojshme,publikim,2017

¹⁵⁵ Aisha r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “një apo dy thithje nuk e bëjnë të ndaluar” Është e rëndësishme të theksohet se lidhjet e birësuar aplikohen vetëm me personin e ushqyer me gji dhe pasardhësin e tij. Ato nuk aplikohen tek të afërmit tjerë si tek vëllezërit dhe motrat e tij nga gjaku.

¹⁵⁶ Miftari Faik, Martesa sipas drejtës Islame,publikim,2014, fq. 7

b) Pengesat martesore të përkohshme

Pengesat të përkohshme të martesës janë: martesa e dy motrave së bashku, si dhe ndalimi i martesës për shkak të gruas që gjendet në periudhën e iddetit (periudha e caktuar kohore e përkohshme në të cilin është e ndaluar martesa). Iddeti është i bazuar në konstatimin e sigurtë se gruaja e shkurorëzuar nuk është shtatzënë. Si pasojë, ajo duhet të mos martohet një periudhë të caktuar pasi që të shkurorëzohet.¹⁵⁷ Kjo periudhë kohore nënkupton dy raste të veçanta që kanë të bëjnë me gruan e cila gjendet në iddet. Rasti i parë është kur gruas i vdes burri, pas kësaj e ka të ndaluar të martohet në periudhën kohore prej 4 muaj e 10 ditë, ndërsa në rast se eventualisht ka mbet shtatzëne me burrin që ka vdekur atëherë kjo periudhë kohore llogaritet gjer në nëntë muaj, deri me lindjen e foshnjës, si dhe 40 ditë pas lindjes së foshnjës, në të cilin pason periudha e nifasit.

Rasti i dytë është për shkak të ndarjes së gruas nga burri (shkurorëzimit), me ç'rast periudha kohore e saj në të cilin nuk mund të martohet, është kalimi i tri cikleve të menstruacionit, e në rast se eventualisht është shtatzëne, atëherë periudha kohore e saj llogaritet nëntë muaj, deri në lindjen e foshnjës, si dhe 40 ditë pas lindjes së foshnjës, pas së cilit pason periudha e nifasit, do të thotë gjithsejtë 10 muaj e 10 ditë.¹⁵⁸ Gjithashtu edhe gruan që është në kurorë valide (legjitime) nuk ka të drejtë mashkulli ta martojë, këtë të drejtë eventuale mashkulli mund të fitojë vetëm pasi që ajo të jetë e shkurorëzuar nga burri i saj i mëparshëm. Kjo vlen edhe në rastin kur vajza është e fejuar, nuk ka të drejtë mashkulli tjetër ta fejojë apo ta martojë. Këtë të drejtë mund të fitojë vetëm atëherë kur vajza eventualisht për shkaqe të ndryshme mund të prish fejesën me dëshirën e saj, kjo praktikohet edhe në të drejtën zakonore. Poashtu nuk preferohet që muslimani të martojë prostitutën, gjithashtu edhe gruaja të martohet për njeriun i cili është i prirur jetës amorale, në se këta persona për sjelljet e tyre janë penduar atëherë mund të martohen, pasi që Zoti është mëshirues dhe pranon pendimin e singertë.¹⁵⁹

¹⁵⁷ Hajreddin Karaman, Historia e të drejtës islame, Ankara, 1975, fq.37, Përktheu: Izeti Metin

¹⁵⁸ Miftari Faik, Martesa sipas islamit, pjesa II, publikim, 2014

¹⁵⁹ Po aty.

1. Gratë e ndaluara përkohësisht për martesë

Ndalesë e përkohshme është ajo e cila ia ndalon një burri martesën me një grua nën rrethana të caktuara. Në qoftë se rrethanat pushojnë së vazhduari, ndalesa përfundon dhe gruaja bëhet e lejuar për të. Gratë e ndaluara përkohësisht janë si në vijim:

- Martesa me më shumë se katër gra, në qoftë se një burrë ka katër gra, të gjitha gratë e tjera bëhen përkohësisht të ndaluara për të. Kjo nënkupton se ai nuk mund të martohet edhe me një tjetër derisa nuk e shkurorëzon një nga gratë e tij. Nuk është e lejuar për një burrë të marrë më tepër se katër gra. Madje edhe ata të cilët kishin më shumë se katër gra para se ta pranonin Islamin, Profeti Muhamed i urdhëroi që t'i zgjedhin katër nga to, ndërsa të tjerat t'i shkurorëzojnë.¹⁶⁰
- Martesa me dy motra në të njëjtën kohë, për aq kohë sa një burrë është i martuar me një grua të caktuar, të gjitha motrat e saja bëhen përkohësisht të ndaluara për të, ai nuk mund të martohet me ndonjërin prej tyre përderisa nuk e shkurorëzon motrën e tyre.
- Martesa me hallën/tezen dhe mbesat tyre në të njëjtën kohë, është e ndaluar martesa me një hallë apo teze dhe mbesën e saj në të njëjtën kohë. Burri duhet ta shkurorëzojë njërin nga ato para se ta martojë (grua).
- Gruan e martuar me një burrë tjetër, kjo qartazi tregohet në ajetin 24 sures Nisa. E njëjta gjë vlen tek guraja e cila është shkurorëzuar me një shkurorëzim të përcaktuar (dy herët e para) dhe është ende në identin e saj. Gruaja e tillë konsiderohet të jetë ende nën përgjegjësinë e bashkëshortit paraprak dhe askush nuk mund t'i afrohet asaj për martesë para se të përmbushet ideti (koha e pritjes) i saj.
- Kurorëshkelëset, është e ndaluar martesa me një grua e cila dihet se është kurorëshkelëse ose prostitutë,¹⁶¹ përveç nëse është e vërtetuar pendimi i saj.¹⁶² Por ajetet kuranore ndalojnë martesën me një lavire.

¹⁶⁰Surja Nisa, Ajeti 3, Nahi, I Hasan, Kur'ani i madhërishëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe, Tiranë, 2010, fq. 109

¹⁶¹ Po aty, Surja Nur, Ajeti 3, fq. 64

(Laviri nuk do të duhej të martohej me tjetërka, pos me ndonjë lavire ose idhujtare, e lavirja me të nuk do duhej të martohet kush, pos ndonjë lavir o idhujtarë. Ajo martesë është e ndaluar për besimtarët)

¹⁶² Amr ibn Shu'ejbi transmeton nga babai i tij, e ai nga gjyshi i tij se Marthed ibn Ebi Marthed el-Ganavi r.a i ndihmonte robërit muslimanë të arratiseshin nga Meka. Një prostitutë në Meke e quajtur Anak ishte dashnorja e

- Gratë idhujtare, është e ndaluar martesë me idhujtaret derisa ato ta pranojnë Islamin. Çështja e martesës me një idhujtare do të jepet më detajisht në ajetin e mëposhtëm. “Mos u martoni me idhujtaret derisa ato të besojnë Zotin”. Ajeti tregon se muslimanit i ndalohet martesë me idhujtare ashtu siç i ndalohet muslimanes të martohet me idhujtar për shkak të dallimit të madh në fe.¹⁶³
- Martesë gjatë ihramit, personi i cili shkon në haxh apo umre e ka të ndaluar martesën përderisa është në gjendje të Ihramit.¹⁶⁴
- Martesë me një robëreshë (e zënë rob) duke qenë shtatzënë, profeti Muhamed i ka ndaluar marrëdhëniet seksuale me robëreshat e luftës (qofshin ato gra pa kurorë apo me kurorë) derisa ato t’i pastrojnë mitrat e tyre nga marrëdhëniet paraprake.¹⁶⁵

2. Martesat tjera të ndaluara

Ekzistojnë edhe forma tjera të martesës të cilat praktikoheshin gjatë kohës së injorancës (xhahilijeti) apo viteve të para Islamit, por të cilat më pastaj u ndaluan. Në mesin e tyre janë:

a. Martesë mut’ah (e përkohshme)

Martesë mut’ah është martesë e përkohshme. Kohëzgjatja e saj saktësohet në kohën kur nënshkruhet kontrata e martesës. Në fund të afatit, të dy bashkëshortët e lënë njëri-tjetrin pa shkurorëzim. Për më tepër, partnerët nuk trashëgojnë nga njëri-tjetri. Një martesë e tillë ishte e rëndomtë gjatë kohës së injorancës (xhahilijetit). Qëllimi i saj ishte vetëm për ta plotësuar një nevojë fizike të mashkullit. Profeti Muhamed e kishte lejuar këtë për një kohë por pastaj e ndaloi përgjithmonë.¹⁶⁶

tij. Ai erdhi tek i Dërguari i Allahut a.s. dhe e pyeti: “O i Dërguari i Allahut, a mund të martohem me Anakën?” i Dërguari a.s. nuk tha asgjë derisa iu shpall ajeti kështu që ai e thirri dhe i tha: “Mos u marto me të”.

¹⁶³ Surja El Bekare, ajeti 221, Nahi, I Hasan, Kur’ani i madhërishtëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe, Tiranë, 2010, fq. 64

¹⁶⁴ Faik Miftari, Martesë në Islam, publikim, fq. 6

¹⁶⁵ Ebu Se’id el-Hudri r.a. transmeton se i Dërguari a.s. ka thënë lidhur me robëreshat e luftës së betejës së Avtastit: “Nuk mund të kemi marrëdhënie seksuale me një grua shtatzënë, derisa ajo ta lind atë (foshnjën), e as me një grua jo-shtatzënë derisa ajo ta kryejë ciklin menstrual (një herë).

¹⁶⁶ Ebu Hurejre r.a. transmeton se i Dërguari a.s. ka thënë: “Mut’ha është e shfuqizuar nga martesë, divorci, ideti dhe trashëgimia.” Ulemaja dallojnë në mendime lidhur me atë nëse martesë mut’ha ishte e ndaluar gjatë luftës së Hajberit apo gjatë çlirimit të Mekës. Kjo e fundit duhet të jetë më e fortë dhe është pranuar nga shumica e dijetarëve. Sabrah ibn Ma’bed r.a. transmeton se gjatë çlirimit të Mekës, i Dërguari i Allahut a.s. tha: “o ju njerëz. Unë më herët ua pata lejuar të martoheshit me gra përmes mut’a-së (martesës së përkohshme). Por vërtetë, Allahu tash ua ka ndaluar një gjë të tillë deri në Ditën e Gjykimit. Prandaj, ata të cilët kanë gra të tilla, le t’i

b. Martesa tahlil

Në qoftë se një burrë e shkurorëzon gruan e tij tre herë, ai nuk mund të rimartohet me të përveç nëse ajo martohet me një tjetër burrë, dhe nëse bashkëshorti i dytë e shkurorëzon atë, atëherë ajo ka të drejtë të martohet me bashkëshortin e saj të parë. Gruaja duhet të kryejë marrëdhënie seksuale me bashkëshortin e dytë para se të bëhet e lejuar për bashkëshortin e parë (në qoftë se bashkëshorti i dytë dëshiron ta shkurorëzoj atë).¹⁶⁷ Me qëllim që të tejkalojë këtë kufizim, disa njerëz e zbatojnë një dredhi (mashttrim) që ta bëjnë të mundur për gratë që të kthehen tek bashkëshortët e tyre (të parë). Një burrë tjetër do të martohet me të, dhe do ta përfshijë një kusht në kontratën e martesës se sapo të çiftëzohet me të, martesë e tyre merr fund. Kjo është një formë e martesës mut'ah, përshkak se në vete përmban faktorin e përkohshëm. Si rrjedhojë ajo pasqyron një mosbinjdi të qartë ndaj urdhëresave dhe udhëzimeve të Allahut. Përshkak të kësaj, ajo e meriton mallkimin e Allahut. Ne, vërtetë, këtë (tahlilin) e konsideronim si zina gjatë kohës së profetit. Dhe atë të cilët veprojnë një gjë të tillë, do të vazhdojnë të mbesin në gjendje të zinasë në qoftë se qëllimi i tyre është që t'ia bëjnë të lejuar burrit të parë, madje edhe nëse qëndrojnë se bashku për njëzet vite.¹⁶⁸

c. Martesa shigar

Shigar është një process kur dy burra i martojnë të bijat e njëri-tjetrit me bijtë e tyre (d.m.th. i ndërrojnë vajzat) apo femrat të cilat i kanë nën kujdestarinë e tyre duke mos ua dhënë mehrin asnjërës prej tyre. Profeti Nafiu, shpjegon: “shigar është ai burrë i cili e marton të

shkurorëzojnë ato, dhe të mos u marrin asgjë nga ajo u kanë dhënë atyre.” Sabrah r.a. gjithashtu transmeton: “Në vitin e çlirimit të Mekës, i Dërguari a.s. na lejoi që të kënaqemi me gra (nëpërmes mut'as). Por më vonë na e ndaloi atë, madje para se të linim Mekën”. Ibn Abasi r.a. nuk ishte në dijeni se i Dërguari a.s. e kishte ndaluar martesën mut'ah, kështu që Aliu r.a. iu afrua dhe i tha: “Vërtetë, i Dërguari i Allahut e ka ndaluar kënaqjen me gratë (përmes martesës mut'ah) në ditën e Hajberit.

¹⁶⁷ Ibn Omeri r.a. transmeton se të Dërguarit a.s. iu prezentua një rast si në vijim: “një burrë e kishte shkurorëzuar bashkëshorten e tij tre herë. Pastaj një burrë tjetër u martua me të, i mbylli dyert, dhe i lëshoi perdet (d.m.th ai kishte privatësi të plotë me të) por e shkurorëzoi atë pa bërë marrëdhënie seksuale. A e bën kjo të lejuar që ajo të martohet përsëri me bashkëshortin e saj-pyeti ai?” I Dërguari a.s. u përgjigj: “Ajo nuk bëhet e lejuar për bashkëshortin e parë derisa i dyti të kryejë marrëdhënie seksuale me të”. Gjithashtu, Aishja, Enesi, dhe Ubejdullah ibn Abasi r.a. transmetojnë se Rufa'h el-Karzi e shkurorëzoi gruan e tij tri herë e cila më pastaj u martua me Abdurrahman ibn Zubejrin. Por ajo nuk e lejoi atë t'i afrohet dhe shkoi tek i Dërguari a.s. duke pohuar se ai ishte i paafat, dhe se ajo kërkonte shkurorëzim. Abdurrahmani e refuzoi këtë, duke thënë se ajo në fakt dëshironte t'i kthehej bashkëshortit të saj të parë. I Dërguari a.s. i tha se kjo nuk mund të ndodhë derisa ajo të kryejë marrëdhënie seksuale me bashkëshortin e dytë.

¹⁶⁸ Ebu Aminah Bilal Filips, Petku i Dashurisë dhe mëshirës, fq. 119

bijën e tij me të birin e një burri tjetër me kusht që ai t’ia japë të bijën e tij për martesë (të birit të tij) dhe të dytë, nuk kërkojnë mehër nga njëri -tjetri.” Profeti Ibn Omeri transmeton se profeti Muhamed i ka ndaluar martesat shigar dhe ka thënë: “asnjë shigar nuk është i lejuar në Islam”. Edhe në qoftë se mehrët specifikohen, kjo martesë ngelet si një burim i dyshimt i cili duhet shmangur. El-A’raxh transmeton se el-Abas ibn Abdullah ibn Abasi e martoi të bijën e tij me Abdurrahman ibn el-Hakemin dhe Abdurrahmani ia dha të bijën e tij për martesë Abasit, ata i caktuan disa mehre. Përsëri, Mu’avije (i cili atëherë ishte halife) i shkroi Mervan ibn Hakemit duke e urdhëruar atë që t’i ndajë ata duke i thënë: “kjo është martesë shigar të cilën profeti Muhamed e ka ndaluar.

d. Martesa me qëllim shkurorëzimi

Disa burra martohen me gra për një qëllim specifik, duke synuar që t’i shkurorëzojnë ato sapo të përmbushin qëllimet e tyre. Një shembull i kësaj natyre, është praktikë e rëndomtë në disa vende perëndimore, është martesë me një grua me qëllim të fitimit të shtetësisë së vendit të saj, duke planifikuar që ta shkurorëzojë atë sapo ta përmbush synimin e tij. Në qoftë se kontrata martesore e kushtëzon një martesë të tillë, atëherë kjo bëhet formë e ndaluar e martesës mut’ah. Mirëpo në qoftë se nuk e përmban, shumica e konsiderojnë këtë martesë si valide, por burri ngelet gjynahqar për shkak se ai e mashtron gruan duke e fshehur qëllimin fillestar të tij.¹⁶⁹

e. Martesa me jomuslimane

Allahu e ka ndaluar martesën me idhujtarët, qofshin meshkuj apo femra. “Mos u martoni me idhujtare, gjersa të bëhen besimtare. Skllavja besimtare është më e mirë se idhujtarja, edhe nëse kjo e fundit mund t’ju pëlqejë. Ata ju thërrasin në zjarrë, kurse Allahu, me mirësinë e tij, ju thërret në Xhennet e falje (të gjynaheve). Ai ua shpjegon njerëzve shpalljet e veta, që të mendojnë ata.”¹⁷⁰ Allahu ka bërë përjashtim nga ky rregull duke i lejuar muslimanët (gjinia mashkullore) të martohen me të krishtere dhe çifute, me një kusht të rëndësishëm: ato duhet të jenë të pastra (të ndershme), që i bie se ato nuk duhet të jenë të shthurura apo

¹⁶⁹Ebu Aminah Bilal Filips, Petku i Dashurisë dhe mëshirës, fq 120

¹⁷⁰Surja Bekare, Ajeti 221, Nahi, I Hasan, Kur’ani i madhërishtëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe, Tiranë, 2010, fq. 64

prostitute.¹⁷¹ Thotë Allahu i Madhëruar: “Sot ju janë lejuar gjërat e mira e të pastra. Ju janë lejuar edhe ushqimet e ithtarëve të Librit; po ashtu, edhe ushqimet tuaja janë të lejuara për ata. Kushdo që mohon besimin, veprat e tij do të zhvlerësohen dhe në jetën tjetër ai do të jetë i dështuar”.¹⁷²

Kushti i “nderit-virgjërisë” zakonisht nuk praktikohet në kohën tonë. Grua e ndershme është ajo e cila është ruajtur brenda shtëpisë së saj sikur një diamant, që kurrë nuk është përfshirë në puthje, prekje, përkëdhelje apo ndonjë formë të marrëdhënieve të shthurura me burra tjetër përveç bashkëshortit të saj. Gruaja jomuslimane nuk ka besim se mund të ruhet nga kryerja e gjynaheve.¹⁷³ E tillë është kultura perëndimore e ditëve të sotshme e cila e ka legjitimuar amoralitetin me miratimin dhe trimërimin e prindërve dhe të afërmeve. Shumë rallë ndodh që të gjendet një vajzë e cila kalon vitet e saja të adoleshencës duke mos u përfshirë në marrëdhënie seksuale. Virgjiniteti është tani një dukuri e rallë në mesin e perëndimorëve.¹⁷⁴

¹⁷¹ El-Karadavi Jusuf, Hallalli dhe harami në Islam, Shkup, 2004, fq. 252

¹⁷² Surja Maide, Ajeti 5, Nahi, I Hasan, Kur’ani i madhërishëm dhe kuptimet e tij në gjuhen shqipe, Tiranë, 2010, fq. 140

¹⁷³ Madje edhe në kulmin e fuqisë dhe dominimit të Islamit, Omeri r.a. ishte kundër martesës me Ithtarët e Librit. Ebu Ve’il trasmeton se Hudhejfe r.a. u martua me një grua çifute. Omeri r.a. i shkroi atij: “Shkurorëzoje atë.” Ai ia ktheu: “Në qoftë se kjo është e ndaluar, unë do ta shkurorëzoj atë.” Omeri r.a. i shkroi: “Nuk them se është e ndaluar, por frikësohem se ju (o musliman), një ditë do të shoqëroheni me prostitutat e tyre (nëse secili e merr këtë çështje shumë shtruar). Xhabiri r.a. u pyet lidhur me martesën me të krishteret dhe çifutet. Ai u përgjigj: “Ne martoheshim me to gjatë kohës së luftës kur ishim me Se’ad ibn Ebi vekasin r.a. në el-Kufa. Kjo ndodhi për arsye se ishte vështirë të gjendej ndonjë grua muslimane. Por kur u kthyem (nga lufta), i shkurorëzuam ato.”

¹⁷⁴ Ebu Aminah Bilal Filips, Petku i Dashurisë dhe mëshirës, fq 133-140

KAPITULLI IV

1. Anulimi i martesës

Anulimi i martesës është mënyrë gjyqësore e zgjidhjes së martesës së pavlefshme dhe trajtohet se martesa fare nuk është lidhur. Pavlefshmëria e martesës është një institut i veçantë në të drejtën familjare që është ndërtuar dhe ka për qëllim të parandaloj lidhjen e martesave në kundërshtim me cilindo kusht që e ka paraparë ligji për vlefshmërinë e martesës. Çdo martesë e lidhur prezumohet se është e ligjshme, përkatësisht e vlefshme, derisa nuk paraqiten fakte që e argumenojnë të kundërtën, dhe se martesa me vendim të gjykatës të shpallet e pavlefshme.¹⁷⁵ Nëse do t'i referohemi praktikës gjyqësore të deritanishme, është shumë i spikatur fakti që, ndërsa në seksionet gjykatës që trajtojnë zgjidhjet e mosmarrëveshjeve familjare e martesore, zgjidhja e martesës përbën numrin më të madh të rasteve, për anulimin e martesave le të themi se këto raste numërohen me gishta.¹⁷⁶ Gjykata mund ta shpall një martesë të pavlefshme, përkatësisht të anulojë një martesë, mbi bazën e disa fakteve të cilat parashihen me ligj. Deri në çastin e anulimit të saj martesa shkakton njëloj pasoja juridike sikurse martesa e vlefshme, edhe sa u përket fëmijëve (ata janë martesorë) edhe sa u përket bashkëshortëve (paraqiten pasojat sikurse është fjala për zgjidhjen e martesës). Kujdesi që ligjvënësi i kushton rregullimit të saj me norma juridike ligjore është krejtësisht i bazuar.¹⁷⁷

Për shkak të rëndësisë së martesës si institucion juridik e shoqëror, paraprakisht në ligj janë paraparë të gjiha shkaqet e anulimit (*nulla nullitas sine lege*) s'ka anulim nëse shkak i për të cilat një martesë mund të anulohet paraqiten pengesat martesore. Pra martesa do të anulohet nëse vërtetohet se gjatë lidhjes së saj ka egzistuar ndonjëra nga pengesat martesore të parapara nga neni 16 deri në nenin 22 të ligji për familjen në RM.¹⁷⁸ Si shkaqe për anulimin e martesës njihen si : martesa pa vullnetin e bashkëshortëve, martesa e lidhur nën moshën e paraparë me ligj, martesa e lidhur gjatë vazhdimin të një martese të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve, sëmundja psikike dhe zhvillimi i mendor i metë e tillë që e bën të paaftë të

¹⁷⁵ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 150

¹⁷⁶ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 150

¹⁷⁷ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 114

¹⁷⁸ Neni 35, Ligji mbi familjen, (Gazeta zyrtare e RM' së), nr:80/1992

kuptojë qëllimin e martesës, gjinia dhe krushqia në shkallën e ndaluar prej ligjit, martesë midis birësuesit dhe të birësuarit, fëmijëve të të birësuesit me të birësuarin dhe midis të birësuarve, martesë me një shtetas të huaj pa lejen e organit kompetent shtetëror, martesë nën ndikimin e kanosjes.¹⁷⁹

Anulimi i martesës mund të kërkohej kur egzistojnë shkaqet për anulimin e martesës së pavlefshme ose të rëzueshme.¹⁸⁰ Kur bëhet fjalë për problemin se sipas cilit ligj duhet vlerësuar shkaqet për anulimin e martesës së lidhur me element të huaj, nevojitet të diferencojmë se a kërkohej anulimi i martesës së lidhur me element të huaj të përzier (të martesës së lidhur në mes shtetasit të Maqedonisë dhe të huajës) ose të martesës me elementin e huaj unik të shprehur në subjekt (martesë e lidhur në mes të huajve) ose të martesës së lidhur me element të huaj të shprehur në të drejta dhe detyrime (martesë e lidhur në mes shtetasit të Maqedonisë dhe shtetases së Maqedonisë të lidhur në shtetin e huaj dhe para organit të huaj).¹⁸¹

Pengesat martesore duhet të kenë egzistuar përpara lidhjes së martesës ose të paktën në kohën e lidhjes së saj. Nuk kanë vlerë të njëjtë për pavlefshmërinë e martesës të gjitha shkaqet e paraqitura, prandaj nga një shkak i tillë, mosrespektimi i tyre nuk shkakton pasoja të njëjlojta. Duke nisur nga kjo, pengesat martesore ndahen në pengesa martesore absolute dhe në pengesat martesore relative.¹⁸² Klasifikimi i pavlefshmërisë së martesave në pavlefshmëri absolute dhe relative bëhet nisur nga fakti se çfarë është cenuar, cili mund të reagojë dhe cilët janë kufijtë e reagimit dhe cilat janë pasojat në njërin rast ose në tjetërin. Klasifikimi bëhet së pari duke marrë intenzitetin e cenimit të interesit të shtetit, rëndësia e të cilit varet nga norma, rregulla ose parimi i veçantë që është shkëlqur rast pas rasti. Në këto raste nëse bëhet fjalë për cenime të parimeve të sanksionuara në mbrojtje të interesit publik, martesë është absolutisht e pavlefshme. Pavlefshmëria absolute ndodh kur janë cenuar ato që ligji i quan kushte thelbësore për lidhjen e martesës. Në rastin e një martesë relativisht të pavlefshme vihet në diskutim kryesisht cenimi i interesit të individëve që e kanë lidhur martesën.¹⁸³ Së dyti, ndryshimi

¹⁷⁹ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 159

¹⁸⁰ Janevski Aresen, E drejta kontestimore, Shkup, 2009, fq. 455

¹⁸¹ Jezdiq Mihajlo, E drejta ndërkombëtare private III, Prishtinë, fq. 52

¹⁸² Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq. 114

¹⁸³ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 160

qëndron tek e drejta e padisë, e cila në rastin e një martese absolutisht të pavlefshme, jo vetëm nuk parashkruhet, por mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës. Kjo, edhe njëherë shpreh karakterin e përgjithshëm të interesit të dëmtuar ose të shkelur. Së treti, në rastin e një martese absolutisht të pavlefshme, të drejtën e padisë ligji ia rezervon secilit bashkëshort, prokurorit dhe kujtdo që ka interes të drejtpërdrejt të ligjshëm. Madje kjo e drejta e padisë, nëse është ushtruar para vdekjes së bashkëshortit, mund t'u kalojë trashëgimtarëve vetëm në rastet e cenimit të rendit publik. Pra, padia e nulitetit është absolute, sepse mund të vihet në jetë prej kujtdo që ka interes, për shkak të natyrës së përgjithshme të shkeljes së kryer përmes aktit të martesës. Së katërti, një martesë absolutisht e pavlefshme është joekzistuese, sepse nuk ka ekzistuar kurrë dhe në fakt, si e tillë, nuk kërkon asnjë formaliteti për ti dhënë fund. Një martesë absolutisht e pavlefshme karakterizohet nga mosprodhimi i pasojave, ndërsa një martesë relativisht e pavlefshme i prodhon efektet e saj, ndonëse në mënyrë të pasigurt e të paqëndrueshme, që zgjat derisa subjektet ose subjekti, interesi i të cilit është cenuar gjatë aktit të martesës, nuk e konsideron me vend tu drejtohet autoriteteve gjyqësore dhe të parashtrojë motivin e pavlefshmërisë relative të martesës.¹⁸⁴

1.1. Anulimi absolut i martesës

Anulimi absolut i martesës, ekziston atëherë kur ekzistojnë shkaqet të cilat sipas ligjit e shkaktojnë nulitetin absolut të martesës. Këto shkaqe janë shkaqet më të rënda të pavlefshmërisë së martesës. Shumica a këtyre shkaqeve e ruajnë përgjithmonë fuqinë e tyre juridike. Martesa përveç që është interes i bashkëshortëve, trajtohet edhe si interes i shoqërisë, përkatësisht shtetit. Për lidhjen e martesës janë përcaktuar kushtet ligjore. Shteti ka përcaktuar kushte për lidhjen e martesës me qëllim të mbrojtjes së saj dhe krijimit të një sigurie juridike.¹⁸⁵ Bëhet fjalë për ato martesa, të cilat, ndonëse etiketohen si absolutisht të pavlefshme, paraqiten në formatin e një absolutizmi relative, derisa mund të riparojnë defektin e aktit të martesës gjatë marrëdhënies me anë të investimit të dy aktorëve kryesorë; përmes gjykatës kompetente dhe përmes vullnetit të bashkëshortëve.¹⁸⁶ Si shkaqe të anulimit absolut mund të numërohen:

¹⁸⁴ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 161,162,163

¹⁸⁵ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq 151

¹⁸⁶ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 165

- a) martesë ekzistuese,
- b) sëmundjet psikike dhe paaftësia për të vepruar,
- c) mosrespektimi i dallimit të seksve,
- ç) gjinia (e gjakut, e krushqisë dhe adoptimit),
- d) lidhja e martesës para moshës 16 vjeçare,
- e) mosrespektimi i procedurës për lidhjen e martesës dhe
- f) shmangia nga qëllimi i martesës.

a) Martesë ekzistuese

Martesë ekzistuese si shkak i nulitetit absolut nënkupton faktin se nuk mund të lidhet martesë e re përderisa ekziston një martesë e mëparshme. Kjo do të thotë se nuk mund të lidhen dy martesë në të njëjtën kohë. Martesë e lidhur në kohën e ekzistimit të martesës së mëparshme të njërit nga bashkëshortët është nule, por nuk do të anulohet nëse martesë e mëparshme është zgjidhur në ndërkohë. Martesë ekzistuese është pengesë martesore në të gjitha legjislacionet që e njohin parimin e monogamisë.¹⁸⁷ Nëse gjatë procesit gjyqësor, ku gjykohet pavlefshmëria e martesës së dytë për shkak të shkeljes së parimit të monogamisë, bashkëshortët ngrenë pretendimin se martesë e parë ka qenë e pavlefshme, e zgjidhur ose ka mbaruar për shkak të vdekjes së njërit prej bashkëshortëve, është detyrë e gjykatës që, përpara se të merret me pavlefshmërinë e martesës së dytë, të verifikojë nëse martesë e parë është zgjidhur, ose të gjykojë mbi pavlefshmërinë e saj. Nëse martesë e parë është zgjidhur ose shpallet e pavlefshme nga gjykata, atëherë gjykata mund të vendosë për vlefshmërinë e martesës së dytë.¹⁸⁸ Nisur nga fakti që monogamia është një parim mjaft i rëndësishëm, martesë e dytë, pa mbarimin ose pavlefshmërinë e së parës, përbën një cenim të interesit publik. Në këto kushte rrethi i personave të ligjshëm aktivisht është i gjerë. Të tillë janë bashkëshortët, ai i cili është lidhur me martesën e parë, prokurori, kushdo që ka një interes ë

¹⁸⁷ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 152

¹⁸⁸ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 173

drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm dhe trashëgimtarët, por për këtë të fundit, vetëm kur gjykimi ka filluar para vdekjes së bashkëshortit. Kalimi të drejtës trashëgimtarëve ndodh sepse cenimi i parimit të monogamisë nënkupton cenim të rendit publik. Padia nuk parashkruhet dhe mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës. Rastet në këtë klasifikim hyjnë tek ato të pavlefshmërive “të pashërueshme” dhe për këtë arye, padia përkatëse ka karakter absolut dhe nuk parashkruhet.¹⁸⁹ Këto raste shpesh i hasim posaçërisht kur personat duan të fitojnë shtetësinë e një shteti nëpërmjet martesës me shtetasit e atij shteti, por njëkohësisht kanë martesë ekzistuese në shtetin e lindjes.

b) Sëmundjet psikike dhe paaftësia për të vepruar

Paaftësia për të vepruar si shkak i nulitetit absolut të martesës nënkupton faktin se martesa e lidhur nga një person që nuk ka aftësi për të vepruar, mund të anulohen. Martesa mund të anulohet nëse bashkëshorti nuk ka aftësi për të vepruar për shkak të sëmundjes psikike të diagnostifikuar apo shkaqeve tjera. Mirëpo duhet pasur parasysh faktin se, një person mund të konsiderohet me paaftësi për të vepruar vetëm nëse me vendimin e gjykatës i merret aftësia për të vepruar. Kështu që nuk mund të thuhet se një person për shkak të sëmundjes psikike, është i paaftë për të vepruar kjo mund të konstatohet vetëm me vendimin e gjykatës.¹⁹⁰ Gjyqi është i obliguar që të përcaktojë që personi ndaj të cilit është ngritur procedura për heqjen e aftësisë për punë të kontrollohet nga së paku dy mjekë, prej të cilëve njëri prej tyre doemos duhet të jetë specialist për sëmundje nervore dhe psikike.¹⁹¹ Legjislacioni familjar i Republikës së Maqedonisë së pari e kategorizon personat të cilët për shkak të formës së manifestuar të sëmundjeve psikike me presencë të simptomave psihotike dhe me shenja reziduale të sëmundjes, nuk janë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e martesës dhe detyrat të cilat dalin nga ajo, njëkohësisht janë të paaftë për tu gjykuar, së dyti kategorizon personat me ngecje në zhvillimi mental, sidhe personat me ngecje të rëndë me IQ nën 36 shkallë, së treti kategorizon personat me ngecje të buta në zhvillimin psikik dhe personat të cilët kanë

¹⁸⁹ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 178-179

¹⁹⁰ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 152

¹⁹¹ Neni 45, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, (Gazeta zyrtare e RM' së), nr. 9

sëmundje të rënda të trashëguara nga familja¹⁹². Për shëndetin mendor, person me çrregullime mendore është ai person që ka probleme të funksionimit mendor, të cilat, në bazë të njohurive mjekësore, klasifikohen si çrregullime mendore dhe është nevoja për trajtim të specializuar shëndetësor, ka prapambetje mendore, paraqet çrregullime psikosociale që kërkojnë trajtim të specializuar psikosocial.¹⁹³ Sëmundjet të cilat mund të ndikojnë që gjykata të shpall një person me paaftësi për të vepruar janë të ndryshme si p.sh., alkoolizimi kronik, marrëzia, narkomania, sëmundjet seksuale të transmetueshme, etj. Paaftësia për të vepruar është shkak i nulitetit absolut të martesës nëse ka ekzistuar në momentin e lidhjes së martesës. Sëmundja duhet të ketë ekzistuar para lidhjes së martesës. Gjyqi në bazë të rezultateve nga kontrolli dhe veprimet e realizuara nga organizata shëndetësore, do të vendos nëse personi i kontrolluar do të mbahet në institucionin publik shëndetësor apo do të lëshohet.¹⁹⁴ Nëse ky shkak është krijuar gjatë ekzistimit të martesës mund të jetë shkak i shkurorëzimit. Në këtë rast të drejtën e padisë e ka secili prej bashkëshortëve. Kjo do të thotë që edhe ai që ka qenë i sëmurë psikik dhe është shëruar ose është në intervalin e kthjelltësisë, nëse fiton zotësinë për të vepruar, kur kjo i është hequr, mund të kërkoj pavlefshmërinë e martesës. Mirëpo nëse ky shkak ka qenë para ekzistimit të martesës, por është shëruar gjatë ekzistimit të martesës, atëherë është shkak i nulitetit relative, sepse do të varet nga vullneti i bashkëshortëve se a do të kërkoj anulimin e martesës.¹⁹⁵ Ka individë që ndonëse me shqetësime psikike janë të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm për rëndësinë e familjes, martesës e të fëmijëve.

c) Dallimi i sekseve

Dallimi i sekseve është shkak i anulimit absolut të martesës sepse vetëm personat me sekse të ndryshme, pra vetëm një burrë dhe një grua mund të lidhi martesë. Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave me sekse të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes. Në parimet themelore të martesës e ka përcaktuar kushtin e dallimit të sekseve për vlefshmërinë e martesës. Martesa që shkel parimin e heteroseksualitetit (lidhjet midis personave me gjini të

¹⁹² Spiroviq-Trpenovska Liljana, Semejno Pravo, Skopje, 2004, fq. 119-120

¹⁹³ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 179-180

¹⁹⁴ Neni 66, Ligji për procedurë jashtëkontestimore, (Gazeta zyrtare e RM' së), nr. 9

¹⁹⁵ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 152

njëjtë) është një situatë tipike. Kështu që martesë e lidhur në kundërshtim me këtë kusht është absolutisht nule. Kjo është në përputhje me qëllimin e martesës jo vetëm për të krijuar familje por kundër natyrës jetësore. Kështu që mos respektimi i dallimit të sekseve ka si pasojë pavlefshmërinë absolute të martesës. Martesa midis personave me sekse të kundërta është kusht për martesë ligjore pothuajse në të gjitha legjislacionet. Tendencat e lejimit të martesave me sekse të njëjta, kanë ndikuar që në disa vende perëndimore, të lejohen disa modele të bashkëjetesës së personave me sekse të njëjta, në kuptimin e një bashkëjetese civile (civil union) p.sh në Vermont. Bashkëjetesat e tilla ende nuk trajtohen si martesë. Ato janë bashkëjetesa por në kuptimin e legjislacionit nuk janë trajtuar në mënyrë të njëjtë me martesën heteroseksuale.¹⁹⁶

d) Gjinia (e gjakut, krushqisë dhe adoptimit)

Gjinia (e gjakut, krushqisë dhe adoptimit) është pengesë martesore e përcaktuar me ligj. Mos respektimi i kësaj pengese sjell anulimin absolut të martesës. Kështu që gjinia është shkak për nulitetin absolut të martesës. Është e pavlefshme martesë e lidhur midis personave me lidhje gjinore në vijë të drejtpërdrejtë, pra të paralindurve dhe të paslindurve (pa kufizime) dhe në vijë të tërthortë midis: vëllait dhe motrës, ungjit (daja, xhaxhai) mbesa dhe nipi, fëmijëve të vllazërve dhe të motrave.¹⁹⁷ Martesa mund të anulohet kur është lidhur mes personave në gjini gjaku, gjini adoptimi ose gjini krushqie. Se në cilën shkallë gjinia është shkak për të kërkuar anulimin absolut të martesës, kjo mvaret se a është fjala për gjini gjaku, të adoptimit, apo të krushqisë.¹⁹⁸ Ekzistenca e lidhjeve të krushqisë, si ato ndërmjet vjehrrit dhe nuses, vjehrrës dhe dhëndërit, njerku dhe thjeshtërës, e njerkes dhe thjeshtërit, e bën një martesë absolutisht të pavlefshme. Gjithashtu edhe ekzistenca e raporteve ose e lidhjeve të birësimit e bën një martesë absolutisht të pavlefshme. Në rastrin e birësimit, që konsiston në bërjen juridikisht tëndin të një fëmije që nuk është lindur prej teje në vijë natyrore ose biologjike, midis birësuesit dhe të birësuarit krijohen po ato raporte sikurse midis prindit biologjik dhe fëmijës.¹⁹⁹

¹⁹⁶ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 153

¹⁹⁷ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 174

¹⁹⁸ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 154

¹⁹⁹ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 175

Gjinia e gjakut është shkak i nulitetit absolut të martesës në vijë të drejtë deri në pakufi, ndërsa në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt. Gjinia e gjakut është pengesë martesore edhe në legjislacione tjera positive si: në legjislacionin e Shqipërisë (KFSH), i Gjermanisë (KCGJ) etj. Gjinia e krushqisë është shkak i nulitetit absolut nëse kanë lidhur martesë personat në shkallën e parë. Ndërsa gjinia e adoptimit është shkak i nulitetit absolut në mënyrë të njëjtë sikur gjinia e gjakut. Lidhur me gjininë si shkak të nulitetit absolut është bërë fjalë në pjesën që i referohet pengesave martesore. Këtu është e rëndësishme të ceket se lidhja e martesës në mes personave në shkallë të gjinisë të ndaluar nga ligji është shkak për nulitetin absolut të martesës.²⁰⁰ Të drejtën në padi e kanë vetë bashkëshortët, prindërit për fëmijët e tyre, duke kundërshtuar lidhjen e martesës së të afërmeve të tyre, prokurori ka të drejtë kundërshtimi të martesës me lidhje gjaku dhe krushqie për shkaqe që parashikohen në ligj.²⁰¹

e) Lidhja e martesës para moshës 16 vjeçare

Martesa presupozon, tek subjektet që e lidhin, një vetëdije të plotë të rëndësisë së përmbajtjes së saj dhe të rëndësisë së lidhjes që rrjedh prej saj. Lidhja e martesës para moshës 16 vjeçare është shkak për nulitetin absolut të martesës.²⁰² Aftësia për të lidhur martesë arrihet në moshën 18 vjeçare. Ndërsa me vendim të gjykatës mund ti lejohet lidhja e martesës personit që është nën moshën 18 vjeçare por që është mbi moshën 16 vjet. Gjegjësisht, lidhja e martesës me vendim të gjykatës lejohet për personat nga mosha 16 deri 18 vjet. Prandaj, në asnjë mënyrë nuk lejohet lidhja e martesës e personave më të ri se 16 vjet. Lidhja e martesës para kësaj moshe është shkak për nulitetin absolut të martesës. Të drejtën në padi kanë prindërit, prokurori.

f) Mos- respektimi i procedurës për lidhjen e martesës

Mos-respektimi i procedurës për lidhjen e martesës si shkak për nulitetin absolut të martesës, nënkupton faktin se martesa nuk është lidhur para organit kompetent dhe nuk është lidhur në formën e paraparë me ligj, prandaj si e tillë është e pavlefshme. Martesa duhet të lidhet në formën civile. Për tu lidhur martesa është e nevojshme që dy personat të gjinisë

²⁰⁰ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 154

²⁰¹ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 196-197

²⁰² Bonilini Giovanni, Manual e së drejtës familjare, Tiranë, 2005, fq. 129

(sekseve) të kundërt në prani të tjerëve, të shprehin në mënyrë të lirë vullnetin dhe pajtimin e tyre për martesë para ofiqarit. Forma e lidhjes së martesës është solemne. Martesa që nuk është e lidhur publikisht dhe përpara nënpunësit të gjendjes civile. Kërkesa e publicitetit të martesës vjen si rrjedhojë e një sërë veprimesh që konsistojnë në procedurat e shpalljes së saj, mundësitë në kundërshtimit të saj ose të ligjësimi si kundërshtues të lidhjes së martesës së re të prindërve, bashkëshortëve, kujdestarit, pokurorit, paraardhësit dhe të afërmit, pjesëmarrjes edhe të dëshmitarëve gjatë aktit të lidhjes së martesës etj. Kështu që mosrespektimi i procedurës së paraparë me ligj për lidhjen e martesës është shkak për nulitetin absolut të martesës. Kërkesa për pavlefshmërinë e martesës për shkak të formës mund të bëhet nga bashkëshortët, nga prindërit e tyre, nga të paralindurit dhe nga të gjithë ata që kanë një interes të drejtpërdrejtë, si dhe prokurori. Zyra e gjendjes civile, kur krijon bindje për pavlefshmëri të aktit të martesës ose ka vend për ndreqje të gabimeve materiale e të shkeljeve të ligjit, mund ti kërkoj prokurorit të vendit, ku është lidhur martesa, të paraqesë padi në gjykatë.²⁰³

g) Shmangia nga qëllimi i martesës

Shmangia nga qëllimi i martesës është shkak i paraparë me ligj për anulimin absolut të martesës. Martesa lidhet me qëllim që bashkëshortët të kenë jetë të përbashkët. Lidhja e martesës në mënyrë fiktive, për ndonjë qëllim tjetër, p.sh fitimi i shtetësis, fitimi i trashëgimisë dhe që nuk ka për qëllim jetën e përbashkët të bashkëshortëve dhe krijimin e familjes është shkak për anulimin absolut të martesës. Pra, është fjala për një martesa kur burri edhe gruaja bien dakord që të mos përmbushin detyrimet dhe të ushtrojnë të drejtat që lindin nga martesa. Kjo është një martesa fiktive.²⁰⁴ Martesa e lidhur pa qëllim të bashkëjetesës në mes të bashkëshortëve është nule. Martesa është e pavlefshme kur bashkëshortët me anë të martesës në të vërtetë nuk kanë qenë të interesuar të krijojnë bashkëjetesë, por të fshehin disa veprime juridike ose fillimisht dëshirojnë të arrijnë qëllime tjera (siç janë trashëgimia ligjore, pensioni familjar, ikja nga përgjegjësia penale etj). Mirëpo, me ligj është përcaktuar se martesa e tillë nuk do të anulohet nëse bashkëshortët më vonë vendosin të krijojnë bashkëjetesë.²⁰⁵ Të drejtën e

²⁰³ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 193

²⁰⁴ Po aty, fq 192

²⁰⁵ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 154

padisë për pavlefshmërinë e martesës për shkaqet që lidhen me stimulim pra shmangia nga qëllimi i martesës e kanë secili nga bashkëshortët, prokurori dhe kushdo tjetër që ka interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm. Kjo padi mund të ngrihet edhe pas zgjedhjes së martesës. E drejta e padisë për pavlefshmërinë e martesës nuk parashkruhet.²⁰⁶

1.2. Anulimi relative i martesës

Anulimi relative i martesës ekziston atëherë kur para martesës ekzistojnë disa shkaqe që vërtetë paraqesin pengesat martesore, mirëpo martesa e tillë nuk duhet të anulohet për interes të përgjithshëm. Pra, këto janë rrethanat që ndikojnë veç ndaj bashkëshortët, si dhe rrethin e ngushtë të personave. Pikërisht për këtë arsye e drejta për një padi për anulimin e martesave relativisht të pavlefshme i përket kryesisht bashkëshortëve dhe personave që kanë një interes të afërt ligjor për anulimin e një martese të tillë. Prandaj, lind karakteristika tjetër e martesave relativisht të pavlefshme, që është parashikimi i një periudhe brenda së cilës personat e përmendur mund të iniciojnë një procedurë për anulimin e martesës.²⁰⁷ Shkaqet që çojnë martesën në anulim relative janë; mungesa e vullnetit për të lidhur martesa dhe mituria.

a) Mungesa e vullnetit për të lidhur martesë

Mungesa e vullnetit për të lidhur martesë ekziston atëherë kur vullneti i deklaruar për të lidhë martesë nuk përputhet me vullnetin e vërtetë (të brendshëm) të bashkëshortëve, për shkak se vullneti është deklaruar nën ndikimin e dhunës, kanosjes, mashtrimit ose lajthimit. Për këtë arsye themi se vullneti i deklaruar nën ndikimin e këtyre rrethanave është me mungesa dhe është shkak për të kërkuar anulimin e martesës. Martesa nuk do të jetë e plotfuqishme nëse pëlqimi është arritur përmes, shtrëngimit, kërcënimit ose lajthimit apo ndonjë mungesë tjetër të vullnetit të lirë të bashkëshortëve të ardhshëm. Se çka është dhuna, kërcënim, mashtrim dhe lajthim është bërë fjalë në pjesën që i referohet pengesave martesore në rast të mungesës së deklarimit të vullnetit për lidhjen e martesës.²⁰⁸ Gjithashtu elemente të këtij anulimi mund të jetë edhe një paraqitje e gabuar që mund të vijë si rezultat i pijeve alkoholike,

²⁰⁶ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 193

²⁰⁷ Spiroviq-Trpenovska Liljana, Semejno Pravo, Skopje, 2004, fq. 123

²⁰⁸ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 155

narkotike ose substancave psikotrope të përdorura.²⁰⁹ Këtu është e rëndësishme të thuhet se lidhja e martesës për shkak të mungesave në vullnetin është shkak për nulitetin relative të martesës. Martesa do të anulohet nëse bashkëshorti e ka dhënë pëlqimin me anë të frikës, dhunës ose kërcënimit serioz. Kur është fjala te padia për anulimin e martesës, nuk bën dallimin në rastet e anulimit absolut dhe relative të martesës, por vetëm thuhet se personat që kanë të drejtë të parashtrojnë padi për anulimin e martesës janë bashkëshortët, prokurori publik dhe të gjithë personat e tjerë që kanë interes të drejtpërdrejtë juridik.²¹⁰

Nuk mund të kërkohej anulimi i martesës për martesës e cila ka pushuar.²¹¹ Të drejtën për të paraqitur padi e kanë të dy bashkëshortët, në rastin kur pëlqimi i lirë ka munguar nga ana e të dyve, vetëm bashkëshortit të kanosur, vetëm bashkëshortit në lajthim, vetëm bashkëshortit që nuk ka dhënë pëlqim të lirë. Këto janë situata të riparueshme dhe mund të shëndërojnë martesën në të vlefshme.²¹² Shkaqet që mund të shuhet janë pushimi i dhunës, kanosjes ose kur bashkëshorti merr vesh për mashtrimin, lajthimin. Kështu që, për këto shkaqe mund të ngritet padi private vetëm nga bashkëshorti i cili e ka deklaruar vullnetin nën ndikimin e këtyre rrethanave, të ketë kaluar 6 muaj po jo më tepër se 3 vjet nga lidhja e martesës. Megjithatë, nga ai do të varet se a dëshiron të kërkojë anulimin e martesës apo jo. Për këtë, mungesa e vullnetit është shkak për anulimin relative të martesës, sepse nëse bashkëshorti nuk dëshiron të paraqet padi martesa mbetet në fuqi.²¹³

b) Lidhja e martesës nën moshën 18 vjet

Lidhja e martesës nën moshën 18 vjet është shkak për anulimin relative të martesës. Martesë mund të lidhin vetëm personat të cilët e kanë mbushur moshën 18 vjet, dhe me vendim të gjykatës edhe personat që e kanë moshën nga 16-18 vjet. Martesa e lidhur nën moshën 18 vjet është e pavlefshme, përveç nëse është dhënë leja nga gjykata për t'u lidhur martesa. Ligji kursen cilësimin e pavlefshmërisë të martesës së lidhur nën moshë, kur vërehet se; personi e ka arritur moshën e kërkuar, gruaja ka lindur fëmijë, gruaja ka mbetur shtatzënë,

²⁰⁹ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 184

²¹⁰ Neni 36 alinea 1, Ligji për familjen, (Gazeta zyrtare e RM, sè), nr:80/1992

²¹¹ Micković Dejan, Ristov Angel, Zakon za semejstovo, Skopje, 2015, praktika gjyqsore nr:5

²¹² Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 191

²¹³ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 156

por gjykata bën kujdes të kontrollojë edhe rrethana të tjera përpara se ta vlersojë si të vlefshme një martesë të tillë.²¹⁴ Nëse nuk ka vendim të gjykatës për lejimin e lidhjes së martesës martesa e tillë mund të anulohet. Lidhja e martesës nën moshën 18 vjet është shkak për anulimin relative të martesës, sepse gjykata gjatë shqyrtimit të padisë, për shkaqe të arsyeshme mund ta refuzoj padinë dhe martesa të mbetet në fuqi. Në këtë rast gjykata vleron se mbetja në fuqi e martesës është më e dobishme duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat relevante.²¹⁵ Kjo martesa mund të kundërshtohet përmes një padie për pavlefshmëri martesa prej secilit nga bashkëshortët, prokurorit dhe kujtdo tjetër që ka një interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm. E drejta e padisë nuk parashkruhet dhe mund të ngrihet edhe pas zgjedhjes së martesës.²¹⁶

1.3 Pasojat e anulimit të martesës

Anulimi i martesës prodhon disa pasoja, përkatësisht efekte juridike. Pasojat e anulimit të martesës janë të njëjta si për anulimin absolut ashtu edhe për anulimin relative. Martesa që shpallet e pavlefshme me vendim të formës së prerë konsiderohet se nuk është lidhur.²¹⁷ Sistemi juridik rregullon pasojat që rrjedhin nga martesa, që mund të grupohen në tre klasa: pasoja personale të bashkëshortëve d.m.th që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e bashkëshortëve me anëtarët e tjerë të familjes, kryesisht me fëmijët.²¹⁸ Pra, si martesa absolutisht edhe ajo relativisht e pavlefshme, janë vendosur nën një emërues të përbashkët. Nga përkufizimi, një martesa e pavlefshme është e paqenë (joekzistuese). Një gjykim dhe vendim deklarativ kryesisht lidhur me pasojat e një martesa absolutisht të pavlefshme është shumë i rëndësishëm, madje i nevojshëm për të parandaluar ankesat e papritura, pështjellimin ose mundësinë e akuzimit për bigami. Një martesa relativisht e pavlefshme është efektive derisa të bëhet e pavlefshme formalisht, pra përmes rrugës gjyqsore. Me tu shpallur e pavlefshme formalisht martesa relativisht e tillë, në mënyrë prapavepruese, pasi merr formë të

²¹⁴ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq 182

²¹⁵ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq. 156

²¹⁶ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 183

²¹⁷ Po aty, fq 206

²¹⁸ Bonilini Giovanni, Manual i të drejtës familjare, Tiranë, 2005, fq 71

prerë, konsiderohet se nuk është lidhur. Sikurse martesë absolutisht e pavlefshme.²¹⁹ Pasojat janë: juridike familjare dhe juridike penale.

- Pasojat juridike familjare

Pasojat juridike familjare kanë të bëjnë me çështje statusore dhe pasurore. Pas anulimit të martesës, fëmijët e lindur në martesë të tillë, nuk konsiderohen jashtëmartesor. Këta fëmijë e ruajnë statusin e fëmijëve martesor dhe pse anulohet martesë sepse iu njihet atësia dhe amësia. Bashkëshortët e ndërrojnë statusin e tyre nga persona të martuar në persona të pamartuar. Pastaj, shtrohet çështja e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, mbajtja e fëmijëve, mbiemri martesor, e drejta e trashëgimit, kompensimi i shpenzimeve gjyqësore dhe dëmshpërblimi. Të gjitha këto pasoja janë të njëjta sikur të shkurorëzimi, prandaj edhe do të trajtohen në pjesën që i referohet shkurorëzimit si mënyrë të zgjedhjes së martesës.²²⁰

- Pasojat juridike penale

Pasojat juridike penale kanë të bëjnë me përgjegjësin penale të personave përgjegjës. Si persona përgjegjës mund të jenë bashkëshortët, nëpunësit civil ose personat e tjerë të cilat me rastin e lidhjes së martesës me shkaqe që shkaktojnë nulitetin e martesës kanë qenë të përfshirë në ndonjë veprim që është element i ndonjë veprë penale.²²¹

1.5 Procedura për anulimin e martesës

Procedura për anulimin e martesës është procedurë e veçantë kontestimore në kontestet martesore në të cilën gjykata përcakton se pushon martesë e cila deri atëherë ka prodhuar efekte juridike të martesës së plotëfuqishme, si ndaj bashkëshortëve, ashtu edhe ndaj fëmijëve, nëse egzistojnë shkaqe ligjore për këtë. Procedura për anulimin e martesës inicohet me padi. Padia ka natyrë konstituive sepse me të kërkohet që të pushojë marrëdhënia martesore deri atëherë e plotëfuqishme. Parashtrimi i padisë për anulimin e martesës nuk është i lidhur për afat, sepse e drejta për anulimin e martesës së pavlefshme, si e drejtë personale nuk

²¹⁹ Mandro-Balili Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007, fq. 207

²²⁰ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq.157

²²¹ Po aty, fq. 157

parashkruhet. Në martesën e lidhur nën dhunë, nën lajthim padia mund të parashtrohet në afat prej një viti nga dita që merret vesh për ushtrimin e dhunës apo lajthimin.²²²

Në procedurën për anulimin e martesës është përcaktuar kompetenca vendore e zgjedhur ose e përzier, krahas gjykatës me kompetencë të përgjithshme vendore kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e përbashkët të fundit. Zgjedhjen e gjykatës kompetencë vendore në rastin konkret e bën paditësi.

Në padinë për anulimin e martesës mund të kumulohet edhe kërkesa për shkurorëzimin e martesës. Kumulimi i këtyre kërkesave bëhet sipas rregullave të kumulimit eventual, së pari paraqitet kërkesa për anulimin e martesës, e më pas kërkesa për shkurorëzim të martesës. Nëse gjykata vërteton se kërkesa për anulimin e martesës është e pabazuar, do të vendosë për kërkesën për shkurorëzim të martesës. Nëse, ndërkaq e pranon kërkesën për anulimin e martesës, kërkesa për shkurorëzimin e martesës mbetet e pa objekt. Në procedurat për anulimin e martesës mund të kumulohet edhe kërkesa për ruajtjen edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve të përbashkët si edhe kërkesa për mbajtjen e bashkëshortit.

Në procedurat për anulimin e martesës janë theksuar autorizimet zyrtare të gjykatës edhe atë sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike (parimi i hetimit) dhe përcaktimit të masave të përkohshme. Në procedurat për anulimin e martesës, gjykata mund të vërtetojë faktet mbi të cilat palët e mbështesin kërkespadinë edhe atëherë kur ato nuk janë kontestues në mes palëve, nëse palët në kontest kanë fëmijë të mitur të përbashkët dhe nëse ato fakte kanë të bëjnë me fëmijët. Gjatë procedurës për anulimin e martesës mund të paraqitet nevoja që të përcaktohet masa të përkohshme me qëllim të sigurimit të mbajtjes së fëmijëve të përbashkët dhe besimin e tyre në ruajtje dhe edukim, si dhe për sigurimin e mbajtjes së bashkëshortit. Masa të përkohshme për mbajtjen e bashkëshortit, gjykata mund të përcaktojë vetëm sipas propozimit të bashkëshortit dhe në dobi të tij. Masat e përkohshme zgjasin deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës për anulimin e martesës.²²³

²²² Janevski Arsen, Zoroska-Kamilovska Tatjana, E drejta procedurale civile, Shkup, 2009, fq. 455

²²³ Po aty, fq. 456

Nëse në procedurën për anulimin e martesës, gjykata vërteton se kërkespadija është e bazuar sjell aktgjykim me të cilin e anulon martesën. Aktgjykimi për anulimin e martesës ka natyrë konstituive. Dispozitivi i aktgjykimit për anulimin e martesës mund të ketë vetëm një urdhër, se martesë anulohet, ose të jetë i ndërlikuar- të përmbajë edhe urdhëra tjerë. Kështu, përveç urdhërit se martesë anulohet, në aktgjykim mund të përmbahen edhe urdhëra si, urdhër për mbajtjen e fëmijëve të mitur të përbashkët dhe besimi i tyre për ruajtje dhe edukim, urdhëri për mbajtjen e bashkëshortit, nëse një kërkesë e këtillë është paraqitur në procedurë dhe urdhëri për shpenzimet e procedurës. Kundër aktgjykimit për anulimin e martesës të sjellë në shkallë të parë është e lejuar ankesa në pajtim me rregullat e procedurës së përgjithshme kontestimore. Aktgjykimin e plotfuqishëm për anulimin e martesës, gjykata në afat prej 30 ditësh ia dërgon organit të administratës, i cili është kompetent për udhëheqjen e librit amë të të kurorëzuarëve, me qëllim të regjistrimit të ndyshimeve, si dhe qendrës për punë sociale, nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur ose fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore.²²⁴

2. Anulimi i martesës në të drejtën Islame

2.1 Kuptimi i anulimit në të drejtën Islame

Pasi martesë ka mjaft rëndësi në të drejtën islame dhe shihet si një bazament i krijimit, zhvillimit, harmonisë, mbijetesës, ruajtjes dhe forcimit të familjes si faktor themelor për ruajtjen dhe zhvillimin e një shoqërie të shëndoshë. Andaj për të pasur një martesë të tillë nuk duhet ekzistuar ndonjë pengesë martesore që të çoj martesën në anulim. Anulimi i martesës është mënyrë gjyqësore e zgjidhjes së martesës së pavlefshme dhe trajtohet sikurse të mos ishte lidhur martesë aspak. Kurorëzimi në të cilin kontrata martesore është konstatuar si e pavlefshme apo jokomplete dhe se duhet anuluar. Në këtë kategori shkurorëzimi bën pjesë shkëputja e martesës përmes vendimit të gjykatës islame me ose pa pëlqimin e palëve. Dallimi në mes të shkurorëzimit dhe anulimit të martesës. Shkurorëzimi dallon thelbësisht nga anulimi i martesës, sepse:

- anulimi i martesës është zgjidhje e një martesë të pavlefshme, ndërsa

²²⁴ Janevski Arsen, Zoroska-Kamilovska Tatjana, E drejta procedurale civile, Shkup, 2009, fq. 457

- shkurorëzimi është zgjidhje e një martesë të vlefshme.

Ndërsa e pezulluar quhet kur mangësia qëndron në një cilësi prej cilësive të aktit, si fjala vjen, mangësia qëndron në një kusht prej kushteve që janë jashtë qenies së vet aktit, apo të shtyllave kryesore të aktit. Në këtë akt rezultojnë disa çështje, nëse plotësohen kushtet e shfrytëzimit dhe të çështjeve kryesore. Me fjalë tjera e pezulluar quhet ajo çka në esencë është e ligjësuar (e fuqishme), por atë ligjësim e pengon një cilësi e rastit, aksidentale. Martesa e fëmijës tepër të vogël, apo martesa me të ndaluarat, është martesë e paligjësuar (e prishur). Ndërsa, martesa pa dëshmitarë është martesë e pezulluar. Nga pezullimi nuk rezulton kurrfarë e drejte, as kurrfarë obligimi.²²⁵ Ky lloj pezullimi apo anulimi nënkupton zgjidhjen e një martesë të plotëfuqishme gjatë jetës së bashkëshortëve, në procedurë gjyqësore, për shkaqe të përcaktuara me ligj si *lidhja e gjinisë* (gjinia gjakut, krushqisë), ose *mungesa e vullnetit* gjatë aktit të martesës me fjalë tjera mosplotësimi i kushteve themelore të martesës.²²⁶ Me anulim nënkuptohet shkurorëzimi i cili pason si pasojë e krijimit të lidhjes farefisnore, në rast se zbulohet lidhja farefisnore, për të cilin më parë nuk kanë qenë në dijeni, për shkak të mohimit të Zotit apo rregullave dhe parimeve të fesë, për shkak të ndërrimit të fesë të burrit dhe të gruas, apo vetëm të burrit apo gruas. Shkurorëzimi me vendim të gjyqit arrihet pas kërkesës së gruas për të ndërprerë kontratën martesore me kërkesë të saj si pasojë e disa rasteve specifike të parapara. Gjyqi do të shqyrtojë kërkesën e gruas për shkurorëzim në këto raste: “mosdurimit të bashkëjetesës martesore (burrit), impotencës së burrit, mungesës së burrit, sëmundjes psikike apo fizike të burrit, për shkak të varfërisë së skajshme të burrit, për shkak të tradhtisë bashkëshortore të burrit, për shkak të sëmundjes vdekjeprurëse të burrit”.²²⁷

Ekzistojnë baza të ndryshme për ta anuluar cilëndo kontratë martesore që është jo e favorshme apo e papranueshme për të dy palët kryesore. Pasi që në Islam çdo lloj veprimi është njëkohësisht edhe veprim fetar, pritet që ai të kuptohet dhe të vihet në veprim me qëllimin më të mirë dhe për kënaqësinë e Zotit. Nëse ai rezulton me dëm apo jobarazi, Islami urdhëron që

²²⁵ Vehbetu Zubejli, Usuli fikhu islam, Ligjet e shariatit, Kacanik, 2013, fq. 104

²²⁶ Vërbani Musli, Shkurorëzimi ian dhe anulimi i kurorës, publikim, 2017

²²⁷ Džananović Ibrahim, Islamsko bratno pravo, Sarajevo, 1985, fq 30

kjo të rregullohet. Nëse detyrimi në fe është i ndaluar me Kur'an, atëherë ç'mbetet për të thënë lidhur me martesën!²²⁸

2.2 Shkaqet dhe llojet e anulimit të martesës në të drejtën Islame

Anulimi i martesës në të drejtën Islame shkaktohet nga mos plotësimi i kushteve për martesë apo dëshira për të lidhur martesë me gratë që e drejta Islame i ndalon në martesë. Pra, martesa do të anulohet nëse vërtetojmë se nuk është plotësuar ndonjë kusht për martesën apo egziston ndonjë pengesë martesore. Si shkaqe për anulimin e martesës njihen: ideti, martesa pa vullnetin e bashkëshortëve të ardhshëm, mungesa e veliut (tutorit), gjinia e gjakut, krushqisë dhe e qumështit.

-Ideti: Gruaja kontraktuese duhet të jetë e lirë nga çfarëdo lidhje martesore. Kjo do të thotë se ajo, në kohën kur mendon për një martesë tjetër, nuk guxon të jetë tashmë e martuar. Nëse ajo është vejushë apo e shkurorëzuar, duhet të jetë e lirë nga shtatzënia; mirëpo, nëse ajo pret fëmijë, duhet të presë deri sa të lindë, dhe pastaj mund të kontraktojë martesën. Ajo gjithashtu nuk guxon të jetë në periudhën e pritjes "Iddet"²²⁹, që paraqet një periudhë të kufizuar kohore, që duhet kaluar para se të rimartohet një vejushë apo një e shkurorëzuar. Nëse bën akt kurorëzimi me ndonjë burrë tjetër gjatë idetit, akti i kurorëzimit është i pavlefshëm sikurse të kishte qenë e martuar, ndërsa me bashkëshortin e saj mund të bëjë akt të kurorëzimit edhe gjatë idetit, sepse koha e pritjes së femrës është i paraparë për ruajtjen e spermatozoidit, pra të pasardhësve të burrit. E kur të kalojë ideti ka të drejtë të martohet me kë të dojë. Gjatë kësaj kohe idetit nëse burri dhe gruaja dëshirojnë të martohen ato mund të martohen pa dëshmitarë dhe pa akt të ri të kurorëzimit dhe pa mehr. Ndërsa prej momentit kur të kalojë ideti, nëse burri dhe gruaja dëshirojnë të martohen, ato patjetër duhet të kenë

²²⁸ Abdulati Hamude, Struktura familjare në Islam, Shkup, 1995, fq. 63

²²⁹ Iddet do të thotë *numërim, pritje*. Ndërsa në terminologji iddet quhet: Koha e kufizuar me ligj për t'i definuar dhe për t'i përfunduar çështjet të cilat rezultojnë prej shkakut dhe gjurmëve të martesës nëse ndodh shkurorëzimi. Kjo pritje e gruas në shtëpinë e burrit edhe pas shkurorëzimit, në sheriatin islam quhet Iddet. E shkurorëzuara apo gruas së cilës i vdes burri dhe ajo është në kohën e iddetit, duke pasur parasysh se ende ka gjurmë të martesës, me fjalë të tjera ka disa detyra, të drejta dhe obligime martesore deri sa të përfundojë ai afat. Pa marrë parasysh iddeti a është për shkak të shkurorëzimit apo të vdekjes ajo nuk lejohet të fejojë gjatë kësaj periudhe kohore. Është e ndaluar fejesa, edhe haptazi, edhe fshehtazi. Pasi gruaja mund të jetë shtatzënë me burrin e shkurorëzuar apo të vdekur.

dëshmitarë, të bëjnë akt të ri të kurorëzimit dhe të caktojnë shumë të re të mehrit, e ajo të konsiderohet shumë e mehrit të caktuar.²³⁰

-Martesa pa vullnetin e bashkëshortëve: Femra që është në moshë dhe është vejushë, apo e shkurorëzuar, është e lirë të bëjë zgjedhjen e vet. Babai nuk mund ta detyrojë atë të martohet kundër vullnetit të saj. Kjo mbështetet nga traditat e profetit Muhamed dhe nga praktika e zakonshme, për shkak se një grua e tillë ka përvojë dhe natyrisht se mund t'i kuptojë implikimet e martesës. Ka pak gjasa që ajo të keqduhëzohet lehtë. Sidoqoftë, mendimi i shumicës dërrmuese është ndarë në çështjen se a thua është mosha apo përvoja e mëparshme bashkëshortore, është me rëndësi në këtë situatë. Sipas disa juristëve, nëse gruaja ka pasur martesa paraprake, ajo është e lirë të bëjë zgjedhjen e vet, madje edhe nëse është nën moshë. Me përvojën e saj, ajo shumë mirë mund ta mbrojë veten.²³¹ Profeti Muhamed e ka ndaluar martesën e femrës pa pëlqimin e saj, pavarësisht se a është virgjëreshë apo e vejë, përveç që e veja patjetër duhet të pohojë më fjalë, kurse të vajza e virgjër mjafton heshtja e saj, sepse ndoshta turpërohet të pohojë më fjalë pëlqimin për martesë. Nëse nuk pranon të martohet, nuk është e lejuar për askënd ta detyrojë të martohet.²³² Një grua e lirë me arsye të shëndoshë dhe me moshë të plotë duhet të japë pëlqimin e vet në mënyrë që kontrata të jetë e vlefshme. Në mungesën e një mbrojtësi ligjor, veli, ajo duhet të ketë arsye të shëndoshë dhe ta ketë arritur moshën e pubertetit, para se t'i lejohej të martohet. Në secilin rast identiteti i që të dy palëve duhet t'i jetë i njohur njëri-tjetrit.²³³ Të gjithë juristët pajtohen se së paku është e rekomandueshme, edhe pse madje disa këtë e quajnë të domosdoshme, që babai të kërkojë pëlqimin e bijës së vet para se ta japë atë për martesë. Kështu ka thënë dhe ka vepruar Profeti Muhamed me bijat e tij. Arsyeja që zakonisht jepet për kërkimin e pëlqimit të vajzës, është se kjo do ta kënaqte atë dhe do ta kultivonte afërsinë ndërmjet familjeve. Po ashtu, është e rekomandueshme që të konsultohet edhe nëna e vajzës, për shkak se, pavarësisht nga kënaqësia personale, ajo, si edhe babai, ka mëshirë për vajzën e vet dhe është njësoj e

²³⁰ Vërbani Musli, Iddeti, publikim, 2017

²³¹ Abdulati Hamude, Struktura familjare në Islam, Shkup, 1995, fq. 93

²³² Gjelaj Besim, Martesa (Nikahu), publikim (www.mbueroja.net/) fq. 3

²³³ Abdulati Hamude, Struktura familjare në Islam, Shkup, 1995, fq. 82

interesuar për mirëqenien e saj.²³⁴ Gjithashtu edhe djali që do të lidhë kurorë duhet që të shpreh vullnetin e lirë të tij, pasi një detyrim apo kërcënim çon martesën në anulim.

-Veliu: E drejta ligjore për detyrim, aty ku zbatohet, mund të ushtrohet vetëm nga babai, i cili është po ashtu i kualifikuar për të qenë edhe tutor (veli), me supozimin se kujdesi dhe mëshira e tij për të bijën janë rëndom të natyrshme. Disa juristë të tjerë këtë të drejtë të njëjtë, në mungesë të babait, ia japin edhe gjyshit, duke besuar se ky i dyti është njësoj i mëshirshëm dhe me përvojë. Disa juristë të tjerë e autorizojnë cilindo tutor për ta ushtruar këtë të drejtë, por e njohin edhe "zgjedhjen e pjekurisë" për të miturin, me anën e të cilit kontrata martesore mund të revokohet nga i mituri me arritjen e moshës së pjekurisë. Kjo vlen njësoj si për të miturit ashtu edhe për të miturat.²³⁵ Baza e autorizimit të tutorit në këtë drejtim është përkujdesi i tij i nënkuptuar për mirëqenien e të mbrojturit. Ekzistojnë dallime të mëdha në mendime përkitazi me faktorët, të cilët e justifikojnë detyrimin. Kjo e përfshin virgjërinë, miturinë dhe varësinë nga tutori. Kur'ani apo Profeti Muhamed në asnjë vend nuk flasin me miratim për një autorizim të tillë detyrues. Ekzistojnë të dhëna autentike se disa baballarë i kanë dhënë bijat e tyre për martesë pa pëlqimin e tyre, por me siguri se jo pa qëllime të mira. Kjo sigurisht do të thotë se prindërit tradicionalë kanë pasur për zakon t'i ujdisin martesat e fëmijëve të tyre dhe ta marrin pranimin e këtyre të dytëve si një gjë që nënkuptohet. Në shoqëritë që bazohen mbi traditën, do të pritej që një baba, i cili përveç dashurisë dhe kujdesit të nënkuptuar për fëmijët e vet, i ka kualifikimet e tutorit ligjor, ta njohë më mirë "fushën e zgjedhjeve" dhe të ketë së paku një ide të përgjithshme për kërkesat dhe priret e të mbrojturve të tij. Aq më tepër, duke e ditur se modestia (heja) dhe respekti i të mbrojturit(ës) ndaj prindit janë ndër virtytet më të larta islame, dhe se martesa është një bashkim i më shumë se dy individëve, ka pak të ngjarë se ka mundur të ketë ndonjë detyrim të formuar të shkallës së lartë. Miratimi i fëmijëve për atë që prindërit e bëjnë në emër të tyre, sigurisht se është një gjë e natyrshme, ose së paku pritet të jetë e tillë. Ata mund të mos thonë asgjë as për miratimin as për mosmiratimin e zgjedhjes së babait. Mirëpo, sipas juristëve islamë, heshtja merret si shenjë miratimi, e jo detyrimi apo zemrate. Megjithatë, në realitet me ka pasur shpërdorime, edhe pse

²³⁴ Abdulati Hamude, Struktura familjare në Islam, Shkup, 1995, fq. 94

²³⁵ Po aty, fq. 82

një i mbrojtur që nuk pajtohet me ujdite e tutorit ka mekanizma të ndryshëm për ta bërë të ditur dëshirën e tij (apo të saj) dhe t'i revokojë ujdite e tilla. Disa juristë kanë teoretizuar se në raste të caktuara baballarët apo tutorët mund t'ua imponojnë statusin e martesës të mbrojturve të tyre.²³⁶ Nëse babai i saj e jep atë për martesë, pa pëlqimin e saj, për një burrë i cili nuk është i barabartë me të, qëndrimi i përgjithshëm është se ajo martesë nuk është e vlefshme. Arsyeja për këtë është se babai ka bërë diçka që është në kundërshtim me interesat e saj dhe e ka përdhunuar besimin e saj. Si tutor legjitim, ai është i autorizuar ta bëjë vetëm atë që është e dobishme për të mbrojturën e tij. Martesa e saj me një kërkues të pabarabartë nuk është as në interes e as në dobi të saj. Sidoqoftë, ka edhe zgjedhje të tjera të përkrahura nga një numër i vogël juristësh. Këto janë: a) martesa është e vlefshme për shkak se barabarësia në martesë nuk është kusht i domosdoshëm, dhe se "e meta" e pabarazisë nuk e zhvleftëson martesën, b) martesa është e pavlefshme vetëm në rastin kur babai, para lidhjes së kontratës, ka qenë i vetëdijshëm për statusin e pabarabartë të burrit, dhe c) martesa është e pavlefshme po qe se vajza është nën moshë; përndryshe, kontrata formalisht është e ligjshme, mirëpo ajo ka të drejtë që, nëse ashtu dëshiron, ta revokojë atë përmes mënyrave tjera.²³⁷

- Gjinia e gjakut, krushqisë dhe qumështit: Shkallët e ndaluara në Islam përbëjnë tri kategori të përgjithshme:

- 1) të një gjaku (farefisi i gjakut),
- 2) krushqisë (përmes martesës),
- 3) të qumështit (farefisi nga gjidhënia).

Detajet e këtyre aspekteve mund të gjenden qartë në cilindo burim standard të Ligjit islam (Fikh). Për shembull, motra përnga qumështi, është njësoj e ndaluar për një mashkull siç është edhe vetë motra e vet e natyrshme. Ky parim mund të ndihmojë në shpjegimin e disa nga shkallët e ndaluara në Islam, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ato të gjirit. Kur'ani shumë shkurt pohon se për meshkujt janë të ndaluara nënat dhe motrat e tyre të qumështit, ashtu siç janë të ndaluara në gjini gjaku. Mirëpo, siç kemi shënuar, ndalesa shtrihet edhe mbi kushërinjtë

²³⁶ Abdulati Hamude, *Struktura familjare në Islam*, Shkup, 1995, fq. 94

²³⁷ Po aty, fq. 92

e tjerë të qumështit.²³⁸ Përsa i përket ndalimit të martesës së atyre që janë të afërt me lidhje atërore dhe farefisnore, qëndrojnë dy shkaqe të rëndësishme. I pari, është shkaku gjenetik: Te fëmija që do të lindë nga prindër me afërsi gjaku, (me rrugë trashëgimie, me kromozome dhe gene kalojnë cilësi të ndryshme dhe veçori shpirtërore), për shkak të ngjasimit të madh të tyre tek të dy prindërit, fëmija i lindur do të jetë i mangët nga ana mendore ose i marrë. Shkaku i dytë është shpirtëror dhe moral. Nga pikëpamja e qënies të afërt, personat që duhet të tregojnë respekt ndaj njëri-tjetrit, pas martesës, ky respekt zhduket. Gjithashtu, kjo është në kundërshtim me konceptet njerëzore, natyrën e moralin njerëzor. Kurse tek pengesat moralo-etike, si pengesa në martesën midis farefisit, futet edhe qumështi. Një grua që merr fëmijën në prehër dhe i jep gji, që i përcjell ushqim mishit, eshtrave dhe gjakut të tij, gjithsesi bëhet e denjë për t'u respektuar si nënë.²³⁹

²³⁸ Abdulati Hamude, Struktura familjare në Islam, Shkup, 1995, fq.152

²³⁹ Topallogllu Beqir, GRUAJA NË ISLAM, Universiteti Marmara Fakulteti Teologjik, publikim, Përktheu : Mithat Hoxha

Përfundimet dhe rekomandimet

Vetë koncepti mbi martesën logjikisht do të thotë: bashkim i një vullneti të lirë (jo në mënyrë të dhunshme) në mes të një burri dhe gruaje (gjinive të kundërta) që lidhet para organeve kompetente, shprehet pëlqimi në mënyrë të lirë sipas procedurës së parashikuar me dispozita ligjore, një akt solemn i mbështetur në barazinë morale dhe juridike, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit. Ndërsa sipas parimeve Islame përcaktimi për martesë do të thotë përcaktim për të plotësuar gjysmën e fesë së mbetur. Martesa në Islam konsiderohet akt i shenjtë dhe i moralshëm e human që njeriu me të, të plotësojë nevojat biopsikologjike, fizike, shpirtërore dhe materiale. Pyetja se çfarë është martesë, për shumë njerëz, në shumë kultura rezulton një pyetje e thjeshtë, i referuar, pra një institucioni universal, një ndër më të vjetrit që ka njohur njerëzimi. Megjithatë, nëse kërkohet për detaje të tjera se çfarë e krijon një martesë dhe cili është qëllimi i saj, përgjigjia për këtë do të variojë në mënyrë të pashmangshme. Historikisht martesë është përkufizuar si një marrëdhënie e njohur ligjërisht dhe shoqërisht ndërmjet një burri dhe një gruaje, qëllimi kryesor i së cilës është rritja e fëmijëve. Edhe pse ky është përkufizimi më i zakonshëm në shumë vende të botës gjithsesi ka edhe variacione të tjera. Në përcaktimin e qëllimit të martesës po ashtu ka ndryshime. Ndërkohë që rritja e fëmijëve përbën një pjesë kryesore të martesës, ka po ashtu çifte të martuara që zgjedhin që të mos kenë fëmijë, çifte të pamartuara që lindin e rrisin fëmijë si dhe çifte që bashkëjetojnë.

Për të qenë martesë e vlefshme duhet që të jenë plotësuar kushtet për lidhjen e martesës apo të mos ekzistojnë pengesat martesore. Nëse këtë çështje e kundrojmë nga aspekti i traditës dhe këtë problematikë e studijojmë nga aspekti historik i saj, me lehtësi do të konstatojmë se kjo çështje kryesisht ka të bëjë me traditën e një populli, apo vendi, dhe çdo herë populli ka zbatuar zakonet dhe rregullat ku kanë jetuar. Shikuar historikisht rrethi i pengesave martesore gjithnjë ka shkuar duke u ngushtuar. Ky ngushtim është rrjedhojë e interesimit të shoqërisë së gjerë që martesë të jetë e qëndrueshme, stabile dhe e shëndoshë. Mirëpo në zonat rurale dhe në familjet patriakale hasim ende probleme të pazgjidhura. Në vendin tonë ka ende praktika mbi bazën e zakoneve e traditave diskriminuese e patriarkale në

lidhjen e martesës ku nuk ka vend për ‘pëlqim të lirë’ të bashkëshortëve ose së paku të bashkëshortes në lidhjen e martesës, zakonisht vajzat janë ato që u mohohet e drejta e shprehjes së vullnetit të lirë, ato mund të jenë të detyruara, të kërcënuara, të lajthitura dhe të mashtruar për martesë. E drejta për të lidhur martesë me vullnetin e lirë, ka hasur ndryshime nga koha në kohë, dikur femra skishte të drejtë në fjalë, më vonë lejohet e drejta në fjalë, ndërsa sot garantohet kjo e drejtë në fjalë. Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë përcakton se martesë duhet të jetë një bashkim i vullnetshëm i një burri dhe një gruaje prandaj e quan të pavlefshme atë martesë që lidhet pa vullnetin e lirë të burrit ose të gruas, gjithashtu edhe e drejta islame si kusht të domosdoshëm parasheh lirinë e plotë të palëve që të lidhin martesë me vetë dëshirën e tyre, gjithmonë është respektuar mendimi i vajzës që do të lidhë martesë.

Martesa paraqet lidhjen e dy personave me gjini (seks) të ndryshme, konkretisht midis mashkullit dhe femrës, dhe nuk lejohet midis personave të të njëjtës gjini. Ligji i familjes i Republikës së Maqedonisë ka paraparë që “martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes”. Mirëpo, kohëve të fundit duke u mbështetur në parimin e mos diskriminimit gjinorë (seksual) ka filluar të lejohet edhe lidhja e martesës midis personave të të njëjtit seks për shembull rasti i Holandës ku parashihet se “martesa mund të lidhet nga dy persona me seks të ndryshme, ose të të njëjtit seks”, përveç kësaj, edhe Danimarka, Norvegjia, Suedia, Belgjika, Franca, Gjermania etj. Kanë ligje për lejimin e martesave me gjini të njëjtë. Këtu duhet përmendur se lidhja e martesës midis personave me të njëjtën gjini në shumicën e shteteve paraqet një temë të ndjeshme, e posaçërisht në vendet myslimane kjo as që mund të diskutohet për faktin se feja Islame e ndalon rreptësisht një lidhje të tillë. Ashtu siç e ndaloi amoralitetin dhe atë që shpie në kurvëri (prostitucion), Islami ndaloi edhe perversionin seksual që njihet me emrin homoseksualizëm. Ky akt pervers kundërshton rendin natyror, korrupton seksualitetin e njeriut dhe konsiderohet krim kundër të drejtave të femrave.

Do të ndalem në disa pika krahasimore që janë identike apo të përafërta, por edhe të kundërta. Sipas të drejtës Islame mosha e përcaktuar për lidhjen e kontratës martesore është nga mosha madhore, pra të jetë në bylyg (nga 15 vjet), sipas drejtës pozitive në Republikën e

Maqedonisë mosha e përcaktuar është 18 vjet. Për shkaqe të arsyeshme dhe sipas kërkesës, gjykata kompetente mund t'i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet, nëse konstaton se personi ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore. Aryeja pse ndalohet martesa e hershme apo thënë më mirë martesa e fëmijëve është se ajo konsiderohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, pasi kjo martesë shpeshherë rezulton e imponuar. Kemi raste kur të miturit lidhin martesë, jetojnë së bashku, ndodh që edhe të lindin fëmijë, por pas mbushjes së moshës 18 vjeçare bëjnë kurorëzimin. Ky fenomen ende vazhdon të jetë prezent në shoqërinë tonë dhe si i tillë paraqet jo vetëm një diskriminim të femrës, por edhe një hermetizëm social, pengim të të rinjve për të zgjedhur fatin e tyre, si dhe në aspektin juridik është i kundërligjshëm, gjë që sanksionohet edhe me ligj. Prandaj sistemi i mbrojtjes së fëmijëve ka nevojë të reflektojë fenomenin e martesave të hershme. Ka akoma një mungesë të sistemit të referimit për identifikimin e rasteve të fëmijëve të martuar, kështu që institucionet duhet të punojnë akoma për të ndërtuar një sistem referimi për martesat e hershme, konsulltim me vendet rurale dhe me familjet tradicionale që zbatojnë martesat e hershme, posaçërisht me popullin rom, mosimponimi ndaj fëmijëve, lejimi i tyre në arsim dhe socializim, komunikim i shëndosh në relacion prindër-fëmij.

Si kusht mjaft i rëndësishëm është forma e lidhjes së martesës, ku sipas Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë pas plotësimit të kushteve themelore, martesa lidhet para organit kompetent dhe në formën e paraparë me ligj, ku duhet të jenë të pranishëm dy bashkëshortët, dy dëshmitar me vullnet të lirë dhe ofiqari, për të lidhur një martesë në formë solemne, ndërsa sa i përket të drejtës Islame, bashkëshortët nuk është e domosdoshme të jenë të pranishëm, mjafton të kenë prindërin si përfaqësues, por preferohet që të jenë prezent bashkëshortët e ardhshëm që të shprehin vullnetin e tyre të lirë për martesë, të kenë dy dëshmitarë madhorë dhe të kontaktohet lartësia e dhuratës (mehrit), që është një obligim material që burri ia dhuron gruas si shenjë sigurimi për të ardhmen, nëse bashkëshortes i ndodh diçka, apo burri kërkon shkurrëzim ajo atë e ka si garancion për të ardhmen. Mirëpo ky lloj i dhuratës nuk ekziston në Legjislacionin e Republikës së Maqedonisë, pasi pas martesës bashkëshortët e krijojnë pasurinë e përbashkët të tyre si garancion për të ardhmen, edhe pse sipas zakoneve

tradicionale kemi unazën, stolitë e arit dhe dhuratat si shenjë të lidhjes së martesës, të cilat i takojnë bashkëshortes që në të drejtën Islame njihet si mehri muaxhel.

Pengesat e martesës sipas legjislacionin tonë janë rregulluar pothuajse në mënyrë identike si në të drejtën Islame, duke marrë parasysh gjininë e gjakut dhe gjininë e krushqisë, i vetmi dallim është pengesat martesore sipas gjinisë së qumështit e cila fare nuk përmendet në Legjislacionin familjar të Republikës së Maqedonisë. Duke qenë se sistemi imunitar i fëmijës është i ngjashëm me atë të nënës së tij, për shkak të qumështit, ai është i ngjashëm edhe me të afërmit e nënës. Nuk mund të lidhin martesë personat në gjini të gjakut në vijë të drejtë, ose në vijë të tërthortë siç janë vëllau dhe motra prej një babai dhe një nëne, motra dhe vëllau prej babait ose nënës, xhaxhai dhe mbesa, daja dhe mbesa, teza dhe nipi, as fëmijët e e vëllezërve dhe motrave të një babai dhe nëna dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave prej babait ose nënës, gjithashtu vlen edhe për fëmijët nga martesa e jashtëligjshme me fëmijët e ligjshëm pasi edhe ato janë motër apo vëlla nga babai apo nëna.

Një pengesë tjetër martesore është edhe adoptimi, në Ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë kjo barazohet si pengesë martesore me gjininë e gjakut, por sa i përket drejtës Islame, adoptimi nuk lejohet, sipas Islamit, adoptimi falsifikon natyrën dhe realitetin bën që individ i huaj të hyjë në familje e të jetojë në mesin e grave të cilat janë të ndaluara dhe të huaja për të. Gruaja e burrit që adopton nuk është as nënë, as motër e as hallë e tij, dhe kryesisht fëmija i adoptuar është i huaj për të gjithë. Nuk mund të lidhin martesë personat në gjini krushqie; vjehri dhe e reja, dhëndri dhe vjehrra, njerka dhe thjeshtëri, njerku dhe thjeshtira, pa marrë parasysh faktin se a ka pushuar martesa lidhja e së cilës ka sjellë këtë marrëdhënie. Edhe muslimanit nuk i lejohet të martohet me paraardhësit e tij (gjyshërit) sado të largët qofshin, por as edhe me pasardhësit (nipër dhe mbesa) sado të largët qofshin. Kjo, për shkak se ngjashmëritë e kodeve gjenetike tek secili, shkaktojnë sëmundje të trashëgueshme, fëmijët nga një martesë e tillë mund të lind me aftësi të kufizuara apo prapambetje mendore. Prandaj duhet që fëmijët të njihen me familjarrët e tyre, të respektojnë mendimin e prindërit, dhe të merren parasysh doket e zakonet e rrethit konkret. Gjithashtu e drejta Islame ka edhe një pengesë të cilën nuk e hasim në Ligjin për familjen në Republikën e Maqedonisë, ajo është ndalimi i lidhjes së martesës me një kategori femrash të cilat njihen si të pamoralshme,

idhujtare, kurrorëshkelëse, jo muslimane dhe pengohet një martesë me to. Mirëpo, sipas legjislacionit tonë ky ndalim ndaj gjinisë femërore është shkelje e të drejtave të njeriut apo parimit të barazisë gjinore, pasi gjinia mashkullore nuk ndalohet për asnjë vepër të lartpërmendur, por vetëm femra. Arsyeja pse ekziston kjo lloj pengese është se e drejta Islame ruan moralin dhe nuk lejon që në një martesë të ketë, kurvëri apo ndonjë akt amoral që do të shkaktojë një martesë të pavlefshme dhe do krijontë një zinxhir degjenerimesh në shoqëri.

Dallimi esencial në mes së drejtës Islame dhe Ligjit për familjen në Republikën e Maqedonisë konsiston në atë se e ndalon bigaminë (poligaminë fare nuk e përmend), askush nuk mund të lidhë martesë të re, përderisa martesa e parë nuk pushon juridikisht, ndërsa e drejta Islame lejon martesën me katër gra, një pretekst që është i lejuar po jo i lehtë për ta zbatuar për gjininë mashkullore, prandaj edhe pse e drejta Islame nuk e ndalon poligaminë në praktikë preferohet martesa vetëm me një grua. Pasi kërkohet barabartësia, pra plotësimi i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve në mënyrë të barabartë, gjë që vështirë të zbatohet, nga instinkti i tij biologjik është e pamundur që edhe ndaj katër grave të shfaq dashuri të njëjtë.

Një kategori tjetër që është mjaftë i rëndësishme sipas Legjislacionit familjar i Republikës së Maqedonisë është sëmundja psikike dhe pazotësia për të vepruar. Shkaku se pse është paraqitur si pengese për martesë është fakti se është menduar dhe analizuar më shumë ardhmëria, duke paraparë se një martesë me një të sëmurë psikik nuk ka efekt, nuk mund të ketë pritje në jetë, nuk mund të ketë jetesë të qetë dhe të harmonishme ashtu siç parasheh martesa e vlefshme. Duke menduar se fëmijët e ardhshëm mund të kenë simptoma të prindit, personi me sëmundje psikike do të krijonte mjaft shqetësime brenda në martesë dhe nuk do të mund ti plotësonte detyrimet ndaj bashkëshortit apo bashkëshortes, as edhe të kujdeset për familjen. Një fakt që aspak nuk ceket si pengese martesore në të drejtën Islame është lajthimi, mashtrimi dhe kanosja pasi këto fakte në Islam janë të ndaluara në çdo sferë të jetës dhe në çdo moment të jetës, prandaj si element të vullnetit cekin vetën dëshirën për të lidhur martesë.

Pra, nëse vërtetohet se gjatë lidhjes së saj ka ekzistuar ndonjëra nga pengesat martesore të lartpërmendura apo nuk janë plotësuar kushtet e theksuara në ligj për lidhje të martesës atëherë anulohet martesa. Disa anulime mund të riparohen nga ana e gjykatës ndërsa disa nga ana e bashkëshortëve, pengesat martesore të përhershme nuk mund të riparohen si

gjinia e gjakut, krushqisë, adoptimit, si të riparueshme mund të përmendim martesën e lidhur me kanosje apo lajthim, martesën ekzistuese, sëmundjet psikike. Secili bashkëshort ka të drejtën në padi për pavlefshmëri të martesës nëse vëren se ndonjë shkak ka cënuar interesat e tij apo asaj personale, por të drejtë padie kanë edhe prindërit, prokurori apo kushdo tjetër që ka interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm. Zyra e gjendjes civile kur krijon bindje për pavlefshmëri të aktit të martesës ose ka vend për përmisimin e gabimeve materiale e të shkeljeve të ligjit, mund t'i kërkojë prokurorit të vendit, të paraqesë padi në gjykatë. Si martesë absolutisht edhe ajo relativisht e pavlefshme, emërohet si një martesë e paqenë, joekzistuese. E drejta Islame parasheh të mënyrën e njëjtë të anulimit, nga ekzistenca e pengesave martesore dhe nga mos përmbushja e kushteve themelore për lidhjen e martesës.

Mirëpo shoqëria çdo herë ka vuajtur nga rrethi ku jeton, çdo herë ka pasur ndikim mentaliteti i shoqërisë, kjo që shpesh herë e ka dërguar shoqërinë drejtë një pësimi të rëndë. Pra, çdo herë në shoqëri duke pasur kujdes për të mos u kuptuar se çka ndodh mbrenda një familje apo martese, ato çdoherë sajojnë diçka duke ruajtur pasqyrën e tyre të pastër. Dua të theksoj arsyen pse pengesat martesore janë kaq fakte të rëndësishme në jetën tonë, pasi çdo here duhet të mendohet për një martesë të vlefshme dhe mirsjellëse. Pasi po të mos ishte martesë me siguri që do të ndodhte zhdukja e njerëzimit ose ekzistenca e disa njerëzve të ardhur në jetë si pasojë e imoralitetit dhe shthurjes, njerëz të cilëve nuk u dihet origjina dhe që nuk e njohin moralin.

Sa i përket parandalimit të këtij fenomeni, konsiderojmë do të duhej që të ketë një vetëdijesim të përgjithshëm mbi këtë fenomen, të ketë programe adekuate nëpër shkolla, të ketë seminare apo konferenca për këtë fenomen, të ketë një komunikim më të shëndoshë në familje, të ketë një bashkëpunim më të theksuar në mes të prindërve dhe institucioneve tjera, dhe t'i kushtohet një rëndësi e veçantë këtij fenomeni, të konsultohen psikologët, sociologët etj.

Ligji për familje të Republikës së Maqedonisë nuk parasheh rregullim juridik të mjaftueshëm për pengesat martesore, një numër të vogël taksativ të neneve, iniciativa e parë e cila duhet të ndërmerret nga legjislacioni jonë, duhet të shënohen në mënyrë më të zgjeruar

pengesat martesore, klasifikimet e pengesave martesore, duhet të ceken pasojat e tyre, duhet të ceket mënyra e riparimit të tyre. Gjithashtu, edhe organet kompetente kanë shumë pak informacione rreth kësaj çështje apo janë tepër rigoroze me informatat e disponuara.

Gjatë hulumtimit tim u drejtova në Gjykatën themelore të Tetovës, duke kërkuar një numër të martesave të anuluar, si përgjigje mora që ska asnjë padi për anulim dhe të gjitha zgjidhjet e martesave janë bërë me shkurorëzim, gjithashtu iu drejtova Zyrës për mbajtjen e librit të amzës të të kurorëzuarve, si përgjigje mora se ndalohet të jepen ato lloje të informatave shkak i cënimit të drejtave të njeriut. Mendoj se organet tona kompetente janë shumë pak të informuara me problemin e pengesave martesore, dhe se këto organe gjegjëse duhet ti përkushtohen më shumë këtyre rasteve . Duhet të përcaktohet qendër e posaçme për informimin e pengesave martesore, të kemi ku të drejtohemi për më shumë informata, nevoiten persona të avancuar përkatës që do të ndihmojnë në zgjedhjen e këtij problemi, si jurist, psikolog, mjek, edukator. Krijimi i organizatave ndihmëse do të ishte një zgjedhje tjetër e mirë, posaçërisht për popullin rom dhe viset rurale, që praktikojn martesat e hershme, largojnë fëmijët e tyre nga bankat shkollore, për inspirim të tyre që të vazhdojnë me shkollim dhe edukim duke shpjeguar rëndësinë e arsimimit dhe jetës, pasi të miturit janë të papjekur psikofizikisht, ka më shumë shkurorëzime, shtatzani të padëshirueshme dhe të rezikshme, dhunë dhe shumë pasoja tjera.

Kohëve të fundit, jeta është bërë mjaft dinamike dhe kanë lindur shumë veti negative mbrenda në shoqëri, ku shoqëria është duke u shkatruar nga këto veti si droga, alkoholi, interneti. Unë këto veti nuk i shoh vetëm negative dhe shkatëruese por i shoh edhe si pengesa martesore, drogën dhe alkoholin e shoh si një pengesë martesore ashtu siç është sëmundja psikike, pra ashtu siç nuk lejohet të lidhë martesë i sëmuri, nuk duhet të lidhë martesë edhe konsumuesi, pasi nga asnjëri skemi rezultat pozitiv, nënpunësi i gjendjes civile duhet t'i këshilloj personat të cilët dëshirojnë të lidhin martesë për tu informuar për gjendjen shëndetsore të bashkëshortëve, veprim të cilin nënpunësit tanë nuk e praktikojnë është shumë me rëndësi pasi depresionet, sëmundjet psikike arrin kulminacionin kohëve të fundit. Ndërsa internetin e ceka si pengesë martesore pasi shumë martesa janë duke u lidhur nëpërmjet interneti nga personat

që aspak nuk njihen dhe hasen në lajthime, mashtrime, si ndaj të dhënave personale ashtu edhe ndaj pamjes fizike duke përdorur fotoshopin, fotografi të ndryshme, inciale të ndryshme.

Shpresoj se ky hulumtim do të jetë inspirim për vetëdijësimin adekuat për këtë fenomen, që në të ardhmen të kemi një shoqëri me familje dhe martesë më të shëndosha dhe të vlefshme.

Bibliografia

Tekste, monografi, artikuj:

- Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2007
- Podvorica Hamdi , *E drejta familjare* , Prishtinë, 2005
- Ebu Aminah Bilal Filips, *Petku i dashurisë dhe mëshirës*
- Selmani Bashkim, Rexhepi Bekim, *E drejta romake ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore*, Ferizaj, 2014
- Miftari Faik, *Martesa sipas të drejtës Islame*, Publikim, 2014
- Spiroviq Trpenovski Lilana, *Semejno pravo*, Skopje, 1997
- Es Sadij Abdurrahman b. Nasir, *Martesa Islame*, publikim, 2016
- Luarasi Aleks, *Marrëdhënie familjare*, Botimi II, Tiranë, 2001
- Zimeri Jusuf, *Martesa me të afërmen-min, nxitje e panevojshme*, publikim, 2017
- Janevski Arsen, Zoroska- Kamiloska Tatjana, *E drejta e procedurës civile*, Shkup, 2009
- Jezdiq Mihailo, *E drejta ndërkombëtare private III*, Prishtinë
- Valentini(Zef) At Giussepe, *Ligji i maleve Shqipëtare*(nga relacionet e misionit shëtitës Jezuit në Shqipëri 1880-1832), Plejad, 2007
- Mickoviq Dejan, Ristov Angel, *E drejta familjare*, Skopje, 2015
- Mickoviq Dejan, Ristov Angel, *Ligji për familjen*, Skopje, 2015
- Mickoviq Dejan, Ristov Angel, Spiroviq Trpenovski Lilana, *E drejta familjare*, Shkup, 2013
- Spiroviq Trpenovski Lilana, *Semejno pravo*, Skopje, 2004
- Kamberi Ferdi, *Martesa dhe shoqëria kosovare*, publikim, 2010
- Halili Fatmir, *Çështjet martesore sipas shariatit dhe sistemit laik*, publikim, 2014
- Nahi I. Hasan, *“Kur’ani i madhërisëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe”* ISHMQI, Tiranë, 2010
- Elezi Ismet, *Kanuni i Labërisë*, Tiranë, 2006
- Gecovi Shtjefën, *Kanuni i Lekë Dukagjinit, me parathënie të Gjergj Fishtës*, Shkodër, 1993
- Bonilini Giovanni, *Manual i së drejtës familjare*, Tiranë, 2005

- Mandro-Balili Arta, *E drejta familjare*, Tiranë, 2007
- Dzananovic Ibrahim, *Islamsko bracno pravo*, Sarajevo, 1985
- Vërbani Musli, *Shkurorëzimi ian dhe anulimi i kurorës*, publikim, 2017
- Ismaili Hilmi, Sejdiu Fatmir, *Historia e shtetit dhe e së drejtës I*, Prishtinë, 2002
- Mandro-Balili Arta, *Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore*, Tiranë, 2014
- El-Kardavi Jusuf, *Hallalli dhe harami*, Prishtinë, 2002
- Haliti Burim, Hyseni Flamur, *Natyra juridike e lidhjes së martesës, pro et contra lidhjes së martesës mes sekseve të njëjta*, publikim, 2012
- Hajreddin Karaman, *Historia e të drejtës islame*, Ankara, 1975, Përktheu Izeti Metin
- Halil Cin, *Martesa në të drejtën islame dhe osmane*, Ankara, 1974
- Shejh Muhamed ibn Salih el-Uthejmin, *Martesa*, publikim
- El-Kadavi Jusuf, *Gruaja në islam*, Shkup, 2000
- Georgiev Aleksand, *Bracni prečki*, Shkup, 2013
- Gashi Drilon, *Martesa me vajzën e xhaxhait, hallës, dajës dhe tezes*, publikim
- Gjellaj Besim, *Martesa (Nikah)*, publikim
- Vehbetu Zubejli, *Usuli fikhu islam, Ligjet e sheriatit*, Kaçanik, 2013
- Abdulat Hamude, *Struktura familjare në islam*, Shkup, 1995
- Vërbani Musli, *Iddeti*, publikim
- Topallogllu Beqir, *Gruaja në islam*, Marmara, Përktheu Mithat Hoxha
- Frano Ilia, *Kanuni i Skëndërbegut*, Shkodër, 1993
- Belegu Majlinda, *Bashkësia faktike sipas legjislacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor*, Akademia diplomatike shqipëtare, Tiranë, 2016

Ligje:

- Ligji për familjen (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 80/1992)
- Ligji për familjen (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, teksti i spastruar , 2016)
- Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna familjare (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,nr. 138/2014)
- Ligji për procedurë jashtëkontestimore (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,nr. 9/2008)
- Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli më 10 dhjetor të vitit 1948.

Web faqe:

- www.ferdikamberi.weebly.com
- www.davetiislam.com
- www.mediaelire.net
- www.islamgjakova.net
- www.jusufzimeri.com
- www.academia.edu
- www.stat.gov.mk
- www.telegrafi.com
- www.landlaeknir.is
- www.zwangsheirat-nrw.de

